



EKOJUST
European Union/Kosovo
Justice Sector Programme

Përmbledhje e standardeve kryesore ndërkombëtare për të drejtat e njeriut e fokusuar në praktikën gjyqësore për personat e cenueshëm dhe grupet e marginalizuara

Nëntor 2023



REPUBLIC OF CROATIA
Ministry of Justice and
Public Administration

Tabela e Përmbajtjes

- 1. Hyrje**
- 2. Kuadri konceptual**
 - 2.1 Parimi i mosdiskriminimit
 - 2.2 Parimi dhe komponentët e qasjes në drejtësi
 - 2.3 Terminologjia
 - 2.3.1 Fjalorth i terminologjisë për aftësi të kufizuar
 - 2.3.2 Fjalorth i terminologjisë LGBTIQ+
 - 2.3.3 Fjalorth i terminologjisë që ka të bëjë me racën, përkatësinë etnike dhe fenë
 - 2.4 Barrierat për qasje në drejtësi
 - 2.4.1 Mungesa e informacionit, infrastrukturës dhe garancive ligjore për personat me aftësi të kufizuara
 - 2.4.2 Diskriminimi, ngacmimi, dhuna dhe përjashtimi social i LGBTIQ
 - 2.4.3 Paragjykimi, marginalizimi dhe përjashtimi social i romëve, ashkalive dhe egjiptianëve
- 3. Standardet e të Drejtave të Njeriut**
 - 3.1 Kuadri ndërkombëtar
 - 3.1.1 Të drejtat e njeriut dhe personat me aftësi të kufizuara
 - 3.1.2 Të drejtat e njeriut dhe personat LGBTIQ+
 - 3.1.3 Antigijspizmi dhe mosdiskriminimi i komuniteteve rom, ashkali dhe egjiptian
 - 3.2 Kuadri kombëtar
 - 3.2.1 Kushtetuta e Kosovës
 - 3.2.2 Legjislacioni Kundër Diskriminimit
 - 3.2.3 Kodit Penal
- 4. Gjykata Evropiane e të Drejtave të Njeriut (GJEDNJ)**
 - 4.1 Historiku
 - 4.2 Juridiksioni
 - 4.3 Struktura
 - 4.4 Paraqitja e ankesës
 - 4.5 Procedura para Gjykatës
 - 4.6 Pranueshmëria
 - 4.7 Themeli i çështjes
 - 4.8 Zgjidhje miqësore
 - 4.9 Masat e Përkohshme
- 5. Jurisprudenca dhe praktika gjyqësore e GJEDNJ-së**
 - 5.1 Të drejtat e njeriut dhe personat me aftësi të kufizuara
 - 5.1.1 Praktika gjyqësore
 - 5.2 Të drejtat e njeriut për LGBTIQ+
 - 5.2.1 Jurisprudenca e GJEDNJ-së
 - 5.2.2 Kodi Penal i Kosovës – Praktika gjyqësore
 - 5.3 Të drejtat e njeriut për romët, ashkalitë dhe udhëtarët
 - 5.3.1 Praktika gjyqësore

I publikuar nga: Akademia e Drejtësisë së Kosovës

Autorët: Edona Ahmetaj / Ina Xhepa / Fjolla Hoxha Tërpkolli / Marije Vuksan

Kontribues: Alina Laura Matache

© 2023 Edona Ahmetaj, Ina Xhepa, Fjolla Hoxha Tërpkolli, Marije Vuksan dhe Akademia e Drejtësisë së Kosovës

Të gjitha të drejtat rezervohen. Akademia e Drejtësisë së Kosovës dhe Programi i Bashkimit Evropian për Sektorin e Drejtësisë në Kosovë – Projekti EUKOJUST nuk pranojnë kurrfarë përgjegjësie për përmbajtjen e pasqyruar dhe nuk janë përgjegjës për aktualitetet, korrektesinë, tërësinë apo cilësinë e informacioneve të paraqitura. Prandaj do të refuzohen të gjitha pretendimet rreth dëmit të shkaktuar nga shfrytëzimi i informatave të dhëna, përfshirë edhe informatat të cilat janë të pakompletuara apo të pasakta.

Të drejtat e autorit për materialet e krijuara nga autorët dhe Akademia e Drejtësisë së Kosovës janë të rezervuara. Nuk lejohet kopjimi / shumëzimi i materialit apo shfrytëzimi i objekteve, siç janë imazhet etj. në publikimet e tjera pa pëlqimin shprehimor nga Akademia e Drejtësisë së Kosovës dhe autorët. Nëse ndonjë pjesë apo shprehje individuale në tekst nuk është e ligjshme apo korrekte, përmbajtja apo vlefshmëria e pjesëve të tjera mbetet e paprekur nga ky fakt.

Hartimi dhe botimi i kësaj Përmbledhje është mundësuar nga Programi i Bashkimit Evropian për Sektorin e Drejtësisë në Kosovë – Projekti EUKOJUST, që zbatohet nga një konsorcium i përbërë nga Fondacioni Gjerman për Bashkëpunim Ligjor Ndërkombëtar (IRZ) si Partner Udhëheqës, dhe partnerët e tij Qendra Holandeze për Bashkëpunim Ligjor Ndërkombëtar (CILC), dhe Ministria e Drejtësisë së Kroacisë (MD Kroaci) dhe Akademia e Drejtësisë së Kosovës.

Kjo përmbledhje është prodhuar me mbështetjen financiare të Bashkimit Evropian. Përmbajtja e saj është përgjegjësi e vetme e EUKOJUST dhe Akademisë së Drejtësisë së Kosovës dhe nuk pasqyron domosdoshmërisht pikëpamjet e Bashkimit Evropian.

1. Hyrje

Programi i Bashkimit Evropian për Sektorin e Drejtësisë në Kosovë – Projekti EUKOJUST, është projekt i financuar nga BE, që zbatohet nga një konsorcium i përbërë nga Fondacioni Gjerman për Bashkëpunim Ligjor Ndërkombëtar (IRZ) si Partner Udhëheqës, dhe partnerët e tij Qendra Holandeze për Bashkëpunim Ligjor Ndërkombëtar (CILC), dhe Ministria e Drejtësisë së Kroacisë (MD Kroaci). Objektivi i përgjithshëm i Projektit EUKOJUST është reformimi i sistemit të drejtësisë në përputhshmëri me standardet evropiane dhe ndërkombëtare me një qasje të orientuar nga nevojat. Projekti bazohet në rezultatet e projekteve të mëparshme dhe pritet të ketë ndikim pozitiv në sektorin e drejtësisë në Kosovë. Me legjislacion gjithëpërfshirës, të konsoliduar, në përputhshmëri me standardet evropiane, dhe kapacitete të përforcuara, me infrastrukturë plotësisht funksionale, të orientuar drejt qytetarëve, projekti punon në drejtim të përmirësimit të cilësisë së drejtësisë, duke ofruar mbrojtje më të mirë të të drejtave dhe interesave publike. Kjo do të kontribuojë në besimin e publikut dhe rritjen e besimit në sistem. Projekti ka katër objektiva:

- Përforcimi i kapaciteteve dhe bashkërendimit ndërinstucional në sektorin e drejtësisë në përputhshmëri me Rishikimin Funksional të Sektorit të Sundimit të Ligjit dhe Strategjisë që është në zhvillim e sipër.
- Përforcimi i pavarësisë, paanshmërisë, llogaridhënies, profesionalizmit, cilësisë, efikasitetit dhe transparencës së gjyqësorit.
- Konsolidimi i mëtejme dhe përputhshmëria e kornizës ligjore dhe institucionale me legjislacionin, standardet dhe praktikatat evropiane dhe përmirësimi i zbatimit të ligjeve.
- Përmirësimi i qasjes në drejtësi, posaçërisht për gratë dhe grupet e cënueshme ose të marginalizuara.

Në kuadër të objektivit të katërt, lidhur me përforcimin e qasjes në drejtësi për personat e cënueshëm dhe grupet e marginalizuara, në vitet 2021 dhe 2022 u zhvilluan disa vizita në terren, vlerësime, takime të rregullta me shoqërinë civile dhe aktivitete për ngritjen e kapaciteteve. Këto aktivitete ishin të orientuara drejt fuqizimit të kapaciteteve ligjore të profesionistëve ligjorë, përfshirë gjyqtarët dhe prokurorët në fushën e të drejtave të njeriut dhe personave të cënueshëm. Rezultati i këtij angazhimi është kjo Përmbledhje aktuale mbi standardet kryesore ndërkombëtare të të drejtave të njeriut dhe praktikatat gjyqësore, të hartuara falë përkushtimit të disa ekspertëve si Edona Ahmetaj, Ina Xhepa, Fjolla Hoxha Tërpkolli dhe Marije Vuksan dhe nën bashkërendimin e Ekspertes afatgjatë të EUKOJUST-it për qasje në drejtësi, Alina Laura Matache.

2. Kuadri konceptual

2.1 Parimi i mosdiskriminimit

Në nivel ndërkombëtar, e drejta në barazi dhe mosdiskriminim janë parimet themelore për të drejtat e njeriut, të përfshira në Kartën e Kombeve të Bashkuara, Deklaratën Universale mbi të Drejtat e Njeriut (DUDNJ) dhe traktatet për të drejtat e njeriut. Fjalët hyrëse të Deklaratës Universale mbi të Drejtat e Njeriut janë të qarta: "Të gjithë njerëzit lindin të lirë dhe të barabartë në dinjitet dhe në të drejta".

Garancia e barazisë dhe mosdiskriminimit, të parapara me ligjin ndërkombëtar për të drejtat e njeriut, zbatohet për të gjithë njerëzit, pavarësisht nga gjinia, orientimi seksual dhe identiteti gjinor ose ndonjë "status tjetër".

Në nivel evropian, parimi i mosdiskriminimit përmendet në Konventën Evropiane për të Drejtat e Njeriut dhe Kartën e të Drejtave Themelore të BE-së.

Traktati për Funkionimin e Bashkimit Evropian (TFEU) ndalon diskriminimin në bazë të kombësisë. Gjithashtu, i mundëson Këshillit të Bashkimit Evropian të ndërmer veprime të duhura për luftimin e diskriminimit për shkak të gjinisë, racës ose origjinës etnike, fesë ose besimit, aftësive të kufizuara, moshës ose orientimit seksual.

Për më tepër, në vitin 2000, dy direktiva u miratuan:

- Direktiva për Barazinë në Punësim (Direktiva 2000/78/KE), e cila ndalon diskriminimin në bazë të orientimit seksual, besimit fetar, moshës dhe aftësisë së kufizuar në punësim.
- Direktiva për Barazinë Racore (Direktiva 2000/43/KE), e cila ndalon diskriminimin në bazë të racës ose përkatësisë etnike, në fushën e punësimit, por edhe në fusha të tilla si arsimi, mbrojtja sociale, duke përfshirë sigurimin social dhe kujdesin shëndetësor, përfitimet sociale, si dhe qasjen dhe furnizimin e mallrave dhe shërbimeve, përfshirë strehimin.

Në vitin 2009, Traktati i Lisbonës prezantoi një klauzolë horizontale me synim të integritetit të luftës kundër diskriminimit në të gjitha politikat dhe masat e BE-së (neni 10 TFEU).

Këto standarde ndërkombëtare dhe rajonale janë përfshirë në nivelin kombëtar të mbrojtjes ligjore përmes Kushtetutës së Kosovës dhe Ligjit për Mbrojtjen nga Diskriminimi.

Është me rëndësi të theksohet edhe ekzistenca e diskriminimit të shumëfishtë, ku ndodh në bazë të më shumë se një karakteristike të perceptuar. Si i tillë, një person mund të diskriminohet jo

vetëm për shkak të përkatësisë së tij etnike, por gjithashtu mund të përfshin elemente të diskriminimit në bazë të gjinisë, orientimit seksual, kombësisë, statusit social, fesë, aftësisë së kufizuar etj. Megjithëse ky lloj diskriminimi mund të krijojë disavantazhe kumulative, ligji kundër diskriminimit tradicionalisht ka marrë një perspektivë njëaksale, duke identifikuar dhe trajtuar një bazë të vetme në rastet e diskriminimit. Për më tepër, sipas Këshillit të Evropës, studimet kanë treguar mungesë të të dhënave dhe mekanizmave ligjorë që mund të trajtojnë diskriminimin ndërsektorial në nivel evropian, pavarësisht nga ekzistenca e fenomeneve të tilla.¹

Megjithatë, sipas ligjit të BE-së, diskriminimi i shumëfishtë përmendet ende në përmbledhjet e Direktivës për Barazinë Racore (2000/43/KE) dhe Direktivës për Barazinë në Punësim (2000/78/KE) siç u përmend më lart, duke deklaruar se “gratë janë shpesh viktima të diskriminimit të shumëfishtë”.

Prandaj, ndërsa diskriminimi vërtet mund të bazohet në disa baza të mbrojtura, në përputhje me ligjin e BE-së, megjithatë Gjykata e Drejtësisë e Bashkimit Evropian (GJED) konsideron se nuk mund të ketë një kategori të re diskriminimi që përbëhet nga kombinimi i më shumë se një prej këtyre bazave.²

2.2. Parimi dhe komponentët e qasjes në drejtësi

Konceptualizimi i qasjes në drejtësi ka evoluar me kalimin e kohës. Qasjet e vjetra përqendroheshin në mjetet me të cilat individët mund të mbronin të drejtat e tyre sipas ligjit nëpërmjet gjykatave dhe tribunaleve, dhe iniciativat e përqendruara në zhvillimin e ndihmës juridike dhe procedurave ligjore të specializuara dhe shpesh të thjeshtuara. Me kalimin e kohës, qasja në drejtësi filloi të nënkuptojë një qasje që ka të bëjë me sigurimin "që rezultatet ligjore dhe gjyqësore janë vetvetiu të drejta dhe të barabarta"³, me një theks më të madh në reformimin e vetë institucioneve të drejtësisë "me qëllim të thjeshtësimit të tyre dhe të lehtësimit të qasjes në to".⁴ Koncepti i 'qasjes në drejtësi' nuk kufizohet vetëm në efikasitetin e sistemit të drejtësisë. Ai përfshin procese që sigurojnë që i tërë sistemi të jetë i ndjeshëm dhe i përgjegjshëm ndaj nevojave dhe realiteteve të qytetarëve, dhe i fuqizon ato në tërë zinxhirin e drejtësisë.

¹Informatat janë në dispozicion në faqen e internetit të Këshillit të Evropës në <https://coe.int/en/web/gender-matters/intersectionality-and-multiple-discrimination>


²Çështja CJEU C-94/20 / Aktgjykimi Land Oberösterreich kundër KV në <https://fra.europa.eu/en/caselaw-reference/cjeu-case-c-9420-judgment>

³Jeremy McBride për Komitetin Evropian për Bashkëpunimin Ligjor të Këshillit të Evropës. 2009. Qasja në drejtësi për migrantët dhe azilkërkuesit në Evropë. para. 9.

⁴Komisioni i Këshillit të Evropës për Barazinë Gjinore. 2013. Studimi i Fizibilitetit: Qasja e Barabartë në Drejtësi për Gratë. par. 6.

Sigurimi i qasjes në drejtësi kërkon bashkëpunim ndërmjet autoriteteve gjyqësore dhe organeve të zbatimit të ligjit, dhe përfshin institucionet administrative dhe të shoqërisë civile.⁵

E drejta për barazi para ligjit është e drejtë universale e njeriut e përfshirë në konventat ndërkombëtare. Elementët e mëposhtëm duhet të jenë të përcaktuara për të garantuar qasjen jodiskriminuese në drejtësi.



2.3 Terminologjia

Kur u referohemi personave të cenusshëm dhe grupeve të marginalizuara, përdorimi i termave mund të jetë shumë i ndjeshëm dhe kontekstual, veçanërisht në sistemin gjyqësor. Prandaj, në këtë Përmbledhje, kemi përdorur Konventat Ndërkombëtare si referencë, për shembull, në rastin

⁵Asambleja Parlamentare e Këshillit të Evropës. 2015. Rezoluta 2054 për barazi dhe mosdiskriminim në qasjen në drejtësi.

e personave me aftësi të kufizuara, ose Fjalorthin e gjuhës së ndjeshme për komunikim të brendshëm dhe të jashtëm, të miratuar nga Parlamenti Evropian.⁶

2.3.1 Fjalorth i terminologjisë për aftësi të kufizuar

Sa i përket personave me aftësi të kufizuara, duhet të përdoret gjuha e Konventës së OKB-së për të Drejtat e Personave me Aftësi të Kufizuara (UN CRPD), siç u përmend më lart. Një pjesë e lëvizjes së personave me aftësi të kufizuar preferon strukturat 'njerëzit në radhë të parë', të tilla si "personat e shurdhër", ndërsa të tjerët preferojnë të përdorin 'terminologjinë- identiteti në rradhë të parë, të tilla si 'të shurdhrit'.

KDPAK-ja e OKB-së, e ratifikuar nga BE-ja dhe të gjitha Shtetet Anëtare, përfshin kalimin nga perspektiva bamirësie/mjekësore drejt perspektivës së të drejtave të njeriut. Përkufizimi i saj për personat me aftësi të kufizuara është: 'Persona me aftësi të kufizuara që kanë dëmtime afatgjata fizike, mendore, intelektuale ose shqisore, të cilat, në ndërveprim me pengesa të ndryshme mund të pengojnë pjesëmarrjen e tyre të plotë dhe efektive në shoqëri në baza të barabarta me të tjerët.'

Ekziston një dallim midis aftësisë së kufizuar, që i referohet ndërveprimit midis dëmtimit të dikujt dhe mjedisit të tij/saj (qasje e bazuar në të drejtat e njeriut) dhe vetë dëmtimit (praktika mjekësore).

'Aftësia e kufizuar' në formën e saj njëjës i referohet konceptit të aftësisë së kufizuar. Përndryshe, duhet të përdoret në shumës: 'persona me aftësi të kufizuara', 'persona me aftësi të kufizuara fizike, e kështu me radhë. Nëse përdorni formën njëjës, ju i referoheni vetëm dëmtimit të personit dhe, si rrjedhojë, kjo nuk është në përputhje me qasjen e të drejtave të njeriut ndaj aftësisë së kufizuar.

⁶Fjalorth i gjuhës së ndjeshme për komunikimet e brendshme dhe të jashtme, i miratuar nga Parlamenti Evropian, në dispozicion në https://www.europarl.europa.eu/trad/etu/pdf/glossary_sensitive_language_2020_en.pdf

2.3.2 Fjalorth i terminologjisë së komuniteteve LGBTIQ+⁷

Preferohet	Kuptimi/Komentet	Të shmangen
Agjinor Pa gjini Gender-free (pa percaktim gjinor) Jo-gjinor Nëngjinor	Terma që përshkruajnë ndonjërin i/e cili/a identifikohet se nuk ka gjini ose të qenurit pa identitet gjinor (nuk përdoren nga persona jo-LGBTI+).	
Aseksual	Një person që nuk ndjen tërheqje seksuale ndaj të tjerëve.	
Seksi i caktuar në lindje	Seksi që i caktohet një personi në lindje, duke qenë kështu kriteri kryesor i gjenitaleve të foshnjës.	Seksi biologjik
Homofobia Bifobia Transfobia dhe Interfobia	Frika, urrejtja, sikleti ose mosbesimi kundrejt personave të cilët perceptohen si homoseksual, biseksual, transgjinor ose interseks	
Biseksual Panseksual	Një person që potencialisht ka më shumë tërheqje seksuale ndaj më shumë gjinive apo të gjitha gjinive.	
Bashkësi Civile/partneritet i regjistruar	Terma që tregojnë se lidhja e një çifti është njohur ligjërisht - jo gjithmonë me të njëjtat të drejta dhe/ose përfitime që ekzistojnë për martesën.	
Gej	Një burrë që ka tërheqje seksuale dhe/ose emocionale ndaj një burri tjetër.	Nuk këshillohet të përdoret 'gej' si term që përshkruan gjithashtu lezbiket.
Shprehje gjinore	Kjo i referohet manifestimit të personave për identitetin e tyre gjinor. Në mënyre tipike, personat kërkojnë të krijojnë shprehjet e tyre ose prezantimin që i përshtatet identitetit/identiteteve të tyre gjinore, pa marrë parasysh seksin e tyre të caktuar në lindje.	Nuk duhet të ngatërrohet me: orientimin seksual, seksin apo identitetin gjinor.

⁷Burime të tjera që mund të përdoren janë: [An Ally's Guide to Terminology](#); [Talking About LGBT People and Equality](#); [United Nations High Commissioner for Refugees 'Terminology Guidance'](#); [Council of Europe: Gender Equality Glossary](#) [IGLA-Europe Glossary](#); [The genderbread person' \(website\)](#).

Identiteti gjinor	Kjo i referohet secilit person që ka përjetuar përvojë të thellë të brendshme dhe individuale të gjinisë, që edhe mundet edhe nuk mundet të korrespondojë me seksin të cilit iu është caktuar në lindje.	Nuk duhet të ngatërrohet me: orientimin seksual ose seksin.
Tranzicioni gjinor/tranzicioni	Procesi që kalon një person për të jetuar në gjininë me të cilën identifikohet, që është ndryshe nga gjinia e caktuar në lindje. Ky tranzicion mund të ndahet në tre shtylla kryesore: <ul style="list-style-type: none"> • Tranzicion social: kur persona trans vendosin të dalin publikisht si trans; • Tranzicion mjekësor: nëse persona trans vendosin t'i nënshtrohen trajtimit mjekësor; • Tranzicion ligjor: kur persona trans përshtatin dokumentet ligjore sipas identitetit të zgjedhur të gjinisë dhe/ose shprehjes gjinore. 	Ndërrim i seksit, ndryshim i gjinisë, Ndërhyrje kirurgjikale për ripërcaktimin e seksit
Interseks	Individë të lindur me cilëndo nga disa variacione të karakteristikave të seksit duke përfshirë kromozomet, gonadat, hormone seksi apo gjenitale që nuk i përshtaten përkufizimeve tipike të trupave mashkullor apo femëror.	Hermafroditët
Lezbike Gej Biseksual	Përdorni gjuhë të përqendruar në një person, të tillë si person 'lezbike', 'gej' ose 'biseksual' dhe jo 'lezbiket', 'gejët' ose 'biseksualët'. Kundërshtarët e barazisë LGBTI+ shpesh përdorin fjalë si 'homoseksual' për të stigmatizuar personat gej duke e degraduar jetën e tyre në vetëm terma seksual.	Lezbiket Gejët Biseksualët Homoseksualët
LGBTI LGBTI+	Akronim për Lezbike/Gej/Biseksual/Transgjinor/Interseks. Kur shtohet shenja '+', përfshihen realitete/identitete të tilla si (por jo të kufizuara në) aseksual, panseksual, gjini jo-përputhëse, etj.	

Barazia martesë në	Ku legjislacioni kombëtar për martesën gjithashtu përfshinë çiftet e seksit të njëjtë – p.sh. referencat neutrale gjinore të bashkëshortëve.	Martesa gej
Queer	Edhe pse historikisht është përdorë si term negativ, 'queer' tani përdorët më shumë nga "Komuniteti i Ylberit" si një term gjithëpërfshirës për t'iu referuar personave lezbike, gej, biseksual, panseksual dhe transgjinor.	
Marrëdhëniet/çiftet e seksit të njëjtë	Këto terme mbulojnë lidhjet apo çiftet që përbejnë dy persona të seksit të njëjte.	Çifte homoseksuale
Karakteristikat e Seksit	Gjenitalët, kromozomet, hormonet, qimet e trupit dhe karakteristika të trupit të personave që i kanë të gjithë njerëzit.	Nuk duhet të përzihet me: seksin/gjininë.
Orientimi seksual	Si e gjen njëri veten të ndihet i tërhequr (ose jo i tërhequr) nga një person tjetër në një mënyrë seksuale dhe/ose romantike.	Preferenca seksuale Zgjedhja e stilit të jetesës Tërheqja e të njëjtit seks Identiteti seksual Mënyrë jetese homoseksuale/lezbike/biseksuale.
Trans/Transgjinor	Një term gjithëpërfshirës për individët, identiteti ose shprehja gjinore e të cilëve ndryshon nga pritshmëritë shoqërore për seksin që u është caktuar në lindje.	Transgjinore Një transgjinor 'Transgjinorët' Transvestitë Çiko-djalë Djalë-zojë Drag queen (DragKuin)
Një person trans/transgjinor	'Trans' është shkurtesë për 'transgjinor' dhe përdorët si term mbulesë për të përfshirë personat transgjinor/transeksual.	
Një burrë trans/transgjinor	Termi për një individ transgjinor që identifikohet si burrë (ose identiteti	

Një grua trans/transgjimore	gjinator i të cilit është ai i një burri) dhe i është caktuar femër në lindje. Termi për një individ transgjinator që identifikohet si grua (ose identiteti gjinator i të cilit është ai i një gruaje) dhe i është caktuar mashkull në lindje.	
-----------------------------	---	--

2.3.3. Fjalorth i terminologjisë që ka të bëjë me racën, përkatësinë etnike dhe fenë

"Antigjipsizmi" u përdor për herë të parë në vitet 1920 dhe 1930 nga aktivistët romë në Bashkimin Sovjetik, dhe u rishfaq gjatë viteve 1980 në diskursin shkencor dhe analitik. Që atëherë, përdorimi i tij është zgjeruar në mesin e aktivistëve dhe studiuesve, megjithëse mbetet i diskutueshëm. Antigjipsizmi shpesh përdoret në kuptim të ngushtë, për të shprehur qëndrime anti-rome ose stereotipe negative në sferën publike ose gjuhën e urrejtjes. Megjithatë, termi është gjerësisht i panjohur në diskutet më të gjera publike.

Antigjipsizmi përfshin një spektër më të gjerë të shprehjeve dhe praktikave diskriminuese, duke përfshirë shumë manifestime të nënkuptuara ose të fshehura. Antigjipsizmi nuk ka të bëjë vetëm me atë që thuhet, por edhe me atë që bëhet dhe çfarë nuk bëhet.

Tekstet kryesore që pasqyrojnë këtë proces përfshijnë rezolutën e Parlamentit Evropian të vitit 2005, e cila përdori termin "antigjipsizëm" për herë të parë në një dokument zyrtar të BE-së. OSBE, FRA dhe Këshilli i Evropës (KE) kanë qenë pionierë në hulumtimin e implikimeve të antigjipsizmit dhe vendosjen e termit në agjendat e politikëbërësve.

Preferohet	Të shmangët
Antigjipsizmi (Antigjipsizmi është një formë specifike e racizmit ndaj romëve, sintëve, udhëtarëve dhe të tjerëve që stigmatizohen si 'ciganë' në imagjinatën publike.)	
Popull aziatik	Popull oriental
Azilkërkues/refugjat/migrant (Në varësi të statusit ligjor specifik)	Emigrant
Bi-racorë Shumëracorë	Racë e përzier

Europianë me ngjyrë/njerëz me origjinë afrikane/ Popull me ngjyrë	Zezakë
Francezë me origjinë algjeriane/francez algjerian Indian britanik (për njerëzit me më shumë se një grup rrënjësh).	
Njerëzit me ngjyrë Pakicat racore/etnike/fetare Njerëzit me prejardhje migrantë (Përdoret zakonisht në kontekstin gjerman dhe suedez; nuk zbatohet gjerësisht).	Të ngjyrosur Jo të bardhë
Anëtarët e grupeve pakicë ("Pakicat" nuk është një term i kontestuar.)	
Romë/Sinti/ Udhëtarë Komuniteti Rom Komuniteti Sinti	Arixhi Kallajxhi Gabel
Popull romë Komuniteti i udhëtarëve Udhëtarët	Ciganët (i papranueshëm kur përdoren nga njerëzit jashtë komunitetit të maxhupëve
Emigrant pa dokumente/të parregullt	Emigrant ilegal
Njerëz të bardhë	Kaukazanët

2.4 Barrierat për qasje në drejtësi

2.4.1 Mungesa e informacionit, infrastrukturës dhe garancive ligjore për personat me aftësi të kufizuara

Për sa i përket personave me aftësi të kufizuara, një sfidë e zakonshme për qasje efektive në drejtësi është mungesa e informacionit. Për më tepër, ky grup i cënueshëm ka edhe pengesa në infrastrukturë dhe komunikim për ushtrimin e të drejtave të tyre ligjore, të garantuara me Kushtetutë dhe akte ligjore ndërkombëtare. Për më tepër, mungojnë garancitë ligjore për njohjen

e barabartë para ligjit apo përshtatshmërinë procedurale, si parime themelore të garantuara me Konventën për të Drejtat e Personave me Aftësi të Kufizuara (KDPAK) dhe Protokollin Opsional.⁸

Korniza ligjore e Kosovës, e cila i referohet ligjeve procedurale, penale, civile dhe administrative, nuk e përcakton shprehimisht garantimin e të drejtës për "përshtatshmërinë procedurale" për sa i përket aftësisë së kufizuar. Për shembull, dispozitat e Kodit të Procedurës Penale, Ligjit për Procedurën Kontestimore, Ligjit për Procedurën Jashtë Kontestimore, Ligjit për Procedurën e Përgjithshme Administrative, Ligjit për Procedurën Përmbartimore dhe Ligjit për Noterinë, nuk parashikojnë shprehimisht mënyrën e dorëzimit të akteve dhe provave, në forma apo formate të përshtatura për kategorinë e personave me shikim të dëmtuar.⁹

2.4.2 Diskriminimi, ngacmimi, dhuna dhe përjashtimi social i komunitetit LGBTIQ

Diskriminimi, ngacmimi, dhuna dhe përjashtimi social i personave LGBTIQ+ përjetojnë një nivel të konsiderueshëm të diskriminimit në jetën e tyre të përditshme. Për më tepër, ata janë sulmuar (dhunë verbale dhe fizike), janë bullizuar ose ngacmuar, janë izoluar dhe traumat e tyre kanë mbetur në heshtje. Diskriminimi dhe abuzimi heteroseksist i personave LGTIBQ+ përfshin dhunën fizike dhe seksuale, por është gjithashtu e rëndësishme të theksohet dëmi i shkaktuar nga heteroseksizmi dhe ciseksizmi i përditshëm më pak i dukshëm.

Trans gratë kanë më shumë gjasa të përjetojnë raste të shumta të ngacmimeve dhe sulmeve seksuale.

Diskriminimi ndikon gjithashtu në komunitetin ndërseksual në mënyra unike, nga praktikat mjekësore shtrënguese dhe detyruese ndaj foshnjave, te keqkuptimet e dëmshme rreth gjinisë dhe identitetit seksual, keqinterpretimit të komunitetit transgjinnor, si dhe stigma dhe diskriminimi i vazhdueshëm në kujdesin shëndetësor, arsim, punësim dhe qasje në shërbime . .

Komunitetet LGBTIQ+ raportojnë gjithashtu nivele të larta të diskriminimit në vendin e punës, duke përfshirë të qenit subjekt i komenteve dhe pyetjeve të papërshtatshme dhe ndërhyrëse nga menaxherët dhe kolegët, duke u detyruar të përdorin tualete që nuk ndihen rehat ti përdorin, ose thjeshtë nuk pranohen në punë fare.

⁸EUKOJUST Raporti për Qasje në Drejtësi për personat e cenueshëm dhe grupet e marginalizuara (2021).

⁹Idem.

Anëtarët e komuniteteve LGBTIQ+ që u përkasin gjithashtu grupeve të tjera etnike shpesh përballen me shumë forma të marginalizimit dhe diskriminimit që ndërthuren dhe mund të shumëfishojnë pabarazinë.

Diskriminimi dhe ngacmimi zvogëlojnë aftësinë e komuniteteve LGBTIQ+ për të marrë pjesë plotësisht dhe për të kontribuar në shoqëri. Kjo ndikon në rezultatet e tyre sociale, pasi përvojat e diskriminimit dhe ngacmimit në mjedise të tilla si objektet e kujdesit shëndetësor, shkolla dhe strehimoret kontribuojnë në rezultate të dobëta shëndetësore dhe socio-ekonomike, dhe në përjashtimin e përgjithshëm social.

2.4.3 Paragjykimi, marginalizimi dhe përjashtimi social i romëve dhe udhëtarëve

Në gjithë Evropën, veçanërisht në vendet e Evropës Lindore dhe Qendrore, në këtë rast në Kosovë, romët, ashkalitë dhe egjiptianët ishin dhe janë ende cak i paragjykimeve dhe marginalizimit. Si një grup i larmishëm kulturor dhe gjuhësor, romët, ashkalitë dhe egjiptianët portretizohen si lypës, kriminelë, përfitues dhe dembelë, si cak i marginalizimit dhe përjashtimit social, si dhe të praktikave të përhershme diskriminuese dhe të dhunshme në aspektin ndërpersonal, institucional dhe kombëtar, duke përfshirë ndarjen (segregacionin) në shkolla, cak të gjuhës së urrejtjes dhe krimeve të urrejtjes, viktime të dëbimeve me forcë dhe sterilizimin e detyruar të grave.

Hulumtimet empirike tregojnë se stereotipet anti-rome sillen rreth krimit, dembelizmit dhe përfitimeve të pamerituara nga shteti. Për më tepër, hulumtimi tregon se romët perceptohen si të rrezikshëm dhe të deroguar, gjë që në mënyrë indirekte nënkupton gjithashtu se ata të dy refuzohen nga këndvështrimi i normave kërcënuese konvencionale dhe shihen me përçmim si një grup me status të ulët - duke qenë të ulët në të dy dimensionet e modelit. .

Diskriminimi, dhuna dhe përjashtimi social i komunitetit rome, ashkali dhe egjiptiane përjetojnë diskriminim të madh çdo ditë. Për më tepër, ata janë sulmuar (dhunë verbale dhe fizike), bullizuar ose ngacmuar, izoluar dhe heshtur me traumat e tyre.

Është e domosdoshme të pranohet se një lloj shtypjeje mund të diskutohet pa pranuar se diskriminimet e tjera janë të lidhura - ndërsektorialiteti. Si rezultat, këto çështje dhe përvoja të njerëzve më të marginalizuar nga shoqëria shpesh errësohen, përjashtohen ose fshihen.

Gratë rome, ashkali dhe egjiptiane kanë më shumë gjasa të përjetojnë raste të shumta të diskriminimit, përjashtimit dhe ngacmimit.

Ndërsektorialiteti¹⁰ na tregon se identitetet sociale funksionojnë në nivele të shumëfishta, duke rezultuar në përvoja, mundësi dhe barrierë unike për çdo person. Kështu, opresioni nuk mund të reduktohet vetëm në një pjesë të një identiteti; çdo opresion varet dhe i jep formë tjetrës.

3. Standardet e të Drejtave të Njeriut

3.1 Kuadri ndërkombëtar

3.1.1 Të drejtat e njeriut dhe personat me aftësi të kufizuara

Konventa për të Drejtat e Personave me Aftësi të Kufizuara dhe Protokollin e saj Opsional

Konventa për të Drejtat e Personave me Aftësi të Kufizuara (KDPAK) dhe Protokollin e saj Opsional është një nga traktatet themelore për të drejtat e njeriut, një marrëveshje ndërkombëtare ndërmjet shteteve, e cila përcakton të drejtat e njeriut dhe detyrimet përkatëse të shteteve në lidhje me personat me aftësi të kufizuara.

Të dyja u miratuan në selinë e Kombeve të Bashkuara më 13 dhjetor 2006 dhe hynë në fuqi në 2008.

Kjo Konventë u vendos shteteve anëtare detyrimin që të sigurojnë qasje adekuate në drejtësi për personat me aftësi të kufizuara. Nënshkrimi i saj tregon synimin e një shteti për të ndërmarrë hapa për shprehjen e pajtimit të zbatimit të detyrueshëm të Konventës dhe të Protokollit Opsional, në një datë të mëvonshme. Nënshkrimi krijon gjithashtu detyrim, për tu përmbajtur nga veprimet që do të cenonin objektin dhe qëllimin e traktatit gjatë periudhës ndërmjet nënshkrimit dhe pranimit të detyrimit.¹¹ Synimi kryesor i kësaj Konvente është kalimi nga qasja mjekësore për aftësinë e kufizuar në qasjen sociale-të drejtave të njeriut, ose siç njihet ndryshe qasja bio-psiko-sociale.

¹⁰ Termi "ndërsektorialitet" është përdorur për herë të parë në vitin 1989 nga Kimberlé Crenshaw (aktiviste dhe avokate feministe me origjinë afro-amerikane) për të ndihmuar të kuptohet më mirë pabarazia klasore në botë. Ndërsektorialiteti që atëherë është bërë një mjet analitik për të parë se si strukturat e ndryshme të pushtetit ndërliken, funksionojnë dhe ndikojnë në përvojat e njerëzve në feminizëm dhe lëvizje të tjera çlirimtare.

¹¹ Manual për parlamentarët mbi Konventën për të drejtat e personave me aftësi të kufizuara <https://www.un.org/development/desa/disabilities/resources/handbook-for-parliamentarians-on-the-convention-on-the-rights-of-persons-with-disabilities/kapitulli-kater-behen-party-te-the-convention-and-the-optional-protocol.html>

✓ Çfarë parashikon Konventa?

Konventa njeh të drejtat e personave me aftësi të kufizuara, të cilat janë të njëjta me të drejtat e të gjithë personave të tjerë, por ripohon se personat me aftësi të kufizuara duhet të gëzojnë të drejtat e tyre në praktikë. Kjo është e rëndësishme, pasi personave me aftësi të kufizuara shpesh u mohohen të drejtat e tyre, ose ata vetë thjesht nuk janë të vetëdijshëm se i gëzojnë këto të drejta. Traktati parasheh se personat me aftësi të kufizuara duhet t'i gëzojnë këto të drejta pa diskriminim dhe në baza të barabarta me të tjerët.

Traktati përcakton detyrimet e shteteve për promovimin dhe mbrojtjen e të drejtave të personave me aftësi të kufizuara. Ndërsa personat me aftësi të kufizuara kanë të drejta të njëjta si personat pa aftësi të kufizuara, ndonjëherë shtetet duhet të ndërmarrin hapa të mëtejme për të siguruar realizimin e tyre. Konventa i përcakton këto detyrime në mënyrë shumë të detajuar. Traktati përcakton institucionet kombëtare dhe ndërkombëtare të nevojshme për zbatimin dhe monitorimin e Konventës. Në nivel kombëtar, këto mund të jenë organet qeveritare dhe mekanizmat koordinues, ata që monitorojnë zbatimin e tij, dhe gjykatat. Në nivel ndërkombëtar, Konventa themelon Komitetin për të Drejtat e Personave me Aftësi të Kufizuara për të ndihmuar shtetet në zbatimin e Konventës dhe konferencën e shteteve palë për të shqyrtuar çdo aspekt të zbatimit të saj.

✓ Cili është qëllimi i Konventës?

Qëllimi i Konventës përcaktohet në nenin 1 të saj: të promovojë, të mbrojë dhe të sigurohet që të gjithë personat me aftësi të kufizuara të gëzojnë plotësisht dhe në mënyrë të barabartë të gjitha të drejtat dhe liritë themelore të njeriut, si dhe të nxisë respektin për dinjitetin e tyre.

✓ Koncepti i "aftësisë së kufizuar" dhe "personave me aftësi të kufizuara"

Konventa nuk ofron një përkufizim përfundimtar të aftësisë së kufizuar. Parathënia/Pjesa hyrëse e saj parashikon se aftësia e kufizuar është një koncept që evoluon. Megjithatë, Konventa pasqyron modelin bio-psiko-social të aftësisë së kufizuar dhe sqaron se aftësia e kufizuar rezulton nga ndërveprimi ndërmjet personave me aftësi të kufizuara dhe barrierave të jashtme që pengojnë pjesëmarrjen e tyre në shoqëri.

Për shkak të kësaj qasjeje, nocioni "aftësi e kufizuar" nuk mund të jetë i ngurtë, por varet nga mjedisi mbizotërues dhe ndryshon nga një shoqëri në tjetrën. Konventa sqaron se mbrojtja e saj përfshin individët me dëmtime fizike, mendore, intelektuale apo shqisore afatgjata, të cilat, në

ndërveprim me barriera të ndryshme, mund të pengojnë pjesëmarrjen e tyre të plotë dhe efektive në shoqëri në baza të barabarta me të tjerët (neni 1, qëllimi).

Konventa nuk përjashton përdorimin e përkufizimeve më strikte në legjislacionet kombëtare; Përkufizimet mund të jenë veçanërisht të nevojshme në disa sektorë, siç janë punësimi ose sigurimi social. Ajo që është me rëndësi është që përkufizimet që shërbejnë si bazë për politikat dhe legjislacionin të pasqyrojnë modelin social të aftësisë së kufizuar, ku sfida me të cilën përballet një person me aftësi të kufizuar matet në terma të barrierave ekzistuese dhe jo në bazë të kategorisë ose përqindjes së dëmtimit.

Konventa përmban një sërë parimesh të përgjithshme për të ndihmuar shtetet në zbatimin efektiv të dispozitave të saj. Përveç kësaj, Konventa përmban të drejta specifike.

✓ Parimet e përgjithshme të Konventës

Parimi	Diskutim
Respekti për dinjitetin dhe autonominë individuale, përfshirë lirinë për të bërë zgjedhjet personale, dhe për të qenë i pavarur	<p>Dinjiteti ka të bëjë me vlerat individuale. Kur respektohet dinjiteti i personave me aftësi të kufizuara, përvojat dhe opinionet e tyre vlerësohen dhe formohen pa ndikimin e dëmtimit fizik, psikologjik apo emocional.</p> <p>Autonomia individuale do të thotë që personat me aftësi të kufizuara marrin kontrollin e jetës së tyre dhe gëzojnë lirinë e zgjedhjeve personale. Respektimi i autonomisë individuale do të thotë që personat me aftësi të kufizuara janë në gjendje të bëjnë zgjedhje të pavarura për jetën e tyre, të jenë subjekt i ndërhyrjeve minimale në jetën e tyre private dhe të marrin vendimet e tyre me mbështetjen e duhur, nëse është e nevojshme.</p>
Mosdiskriminimi	<p>Mosdiskriminimi është një parim themelor i të gjitha traktateve për të drejtat e njeriut. KDPAK ndalon diskriminimin në bazë të aftësisë së kufizuar, duke qenë se diskriminimi i pengon njerëzit të gëzojnë të drejtat e tyre në baza të barabarta me të tjerët. Megjithatë, sot, mosdiskriminimi kuptohet si një parim shumë më i gjerë, i cili përfshin jo vetëm ndalimin e veprimeve diskriminuese, por edhe ndërmarrjen e masave mbrojtëse ndaj diskriminimit në të ardhmen, si dhe ndalimin e diskriminimit <i>de facto</i>.</p>

<p>Pjesëmarrja dhe përfshirja e plotë dhe efektive në shoqëri</p>	<p>Parimi i pjesëmarrjes dhe përfshirjes së plotë dhe efektive nënkupton që shoqëria, si në aspektin e saj publik ashtu edhe në atë privat, duhet të organizohet në atë mënyrë që t'u mundësojë të gjithë personave të marrin pjesë plotësisht në të. Kjo do të thotë që shoqëria dhe aktorët përkatës vlerësojnë personat me aftësi të kufizuara dhe i njohin ata si pjesëmarrës të barabartë në të gjitha proceset, dhe veçanërisht në ato që lidhen me vendimet që ndikojnë në jetën e tyre ose lirinë për të kandiduar për poste publike. Pjesëmarrja shkon përtej konsultimit dhe përfshin pjesëmarrje të konsiderueshme në aktivitete dhe procese vendimmarrëse, mundësinë për të shprehur mendime, për të ndikuar dhe të drejtën në ankesë kur pjesëmarrja mohohet. Përfshirja kërkon një mjedis të qasshëm, pa barriera fizike dhe sociale. Është një proces i dyanshëm që promovon pranimin e personave me aftësi të kufizuara dhe pjesëmarrjen e tyre, dhe inkurajon shoqërinë të jetë e hapur ndaj personave me aftësi të kufizuara.</p>
<p>Respekti për dallimin dhe pranimi i personave me aftësi të kufizuara si pjesë e diversitetit njerëzor.</p>	<p>Pavarësisht disa dallimeve të dukshme midis njerëzve, të gjithë kanë të njëjtat të drejta dhe dinjitet. Përsa i përket aftësisë së kufizuara, respektimi i dallimeve përfshin pranimin e personave me aftësi të kufizuara ashtu siç janë, pa shprehur keqardhje, apo pa i parë si një problem që duhet zgjidhur.</p>
<p>Mundësi të barabarta</p>	<p>Parimi i mundësive të barabarta është i lidhur ngushtë me atë të mosdiskriminimit. Barazia e mundësive nuk do të thotë që mundësitë e njëjta njëjtat mundësi janë të njëjta për të gjithë në të gjitha rrethanat. Përkundrazi, ai pranon dallimin midis njerëzve dhe siguron që, pavarësisht nga ky ndryshim, të gjithë të kenë të njëjtën mundësi për të gëzuar të drejta.</p>
<p>Qasshmëria</p>	<p>E drejta e qasjes nënkupton eliminimin e barrierave që pengojnë gëzimin efektiv të të drejtave të njeriut nga personat me aftësi të kufizuara. Qasja u mundëson personave me aftësi të kufizuara të jetojnë në mënyrë të pavarur dhe të marrin pjesë plotësisht në të gjitha aspektet e jetës. Qasja është e rëndësishme në të gjitha fushat e jetës, por veçanërisht në ambientet fizike, siç janë ndërtesat, rrugët, banesat e kështu me radhë, qasja në transport, informacion dhe komunikim, si dhe lehtësira dhe shërbime të tjera të hapura ose të ofruara për publikun e gjerë.</p>

Barazia ndërmjet burrave dhe grave	Parimi i barazisë midis burrave dhe grave kërkon që të njëjtat të drejta të njihen shprehimisht për burrat dhe gratë në mënyrë të barabartë , dhe që të merren masa të duhura për të siguruar që gratë të kenë mundësinë për të ushtruar të drejtat e tyre.
Respekti për kapacitetet në zhvillim të fëmijëve me aftësi të kufizuar, si dhe respektimi i të drejtave të fëmijëve me aftësi të kufizuar për të ruajtur identitetin e tyre	Respekti për kapacitetet në zhvillim të fëmijëve është një parim i përcaktuar edhe në Konventën mbi të Drejtat e Fëmijës ¹² . Nëpërmjet këtij procesi, fëmijët gradualisht fitojnë njohuritë, aftësitë dhe botëkuptimin e tyre, duke përfshirë edhe njohjen e të drejtave të tyre . Pjesëmarrja e fëmijëve në proceset vendimmarrëse që i prekin ata, duke përfshirë të drejtën për të ruajtur identitetin e tyre, duhet të zgjerohet me kalimin e kohës.

✓ **Të drejtat e njeriut në Konventë**

Neni 10 – E drejta për jetën

Neni 12 – Njohje e barabartë para ligjit

Neni 14 – Liria dhe siguria e personit

Neni 15 – Liria nga tortura apo, trajtimi ose ndëshkimi mizor, çnjerëzor apo degradues

Neni 16 – Liria nga shfrytëzimi, dhuna dhe abuzimi

Neni 17 – Integriteti i personit

Neni 18 – Liria e lëvizjes dhe kombësia

Neni 19 – Jetesa e pavarur dhe përfshirja në komunitet

Neni 21 – Liria e shprehjes dhe e mendimit dhe qasja ndaj informacionit

Neni 22 – Respektimi për jetën private

Neni 23 – Shtëpia dhe familja

Neni 24 – Arsimi

Neni 25 – Shëndeti

Neni 27 – Puna dhe punësimi

Neni 28 – Standardet e duhura të jetesës dhe mbrojtjes sociale

Neni 29 – Pjesëmarrja në jetën politike dhe publike

Neni 30 – Pjesëmarrja në jetën kulturore dhe aktivitetet argëtuese dhe sportive.

✓ **Cilat janë detyrimet kryesore të shteteve, që dalin nga kjo Konventë?**

¹² <https://www.ohchr.org/en/instruments-mechanisms/instruments/convention-rights-child>

Rishikimi i ligjeve dhe politikave ekzistuese për të siguruar që ato respektojnë Konventën dhe nuk janë në kundërshtim me të. Ligje të tilla mund të jenë ligjet për mbrojtjen nga diskriminimi dhe ligjet për aftësinë e kufizuar, por edhe ligjet për kujdestari, ligjet për arsim, ligjet për shëndetin mendor etj. Në Kosovë është një pjesë e madhe e legjislacionit që ende ka nevojë për rishikim dhe ndryshim, veçanërisht në fushën e drejtësisë.

Sigurimi i financimit: Miratimi i legjislacionit në përputhje me KDPAK nuk mjafton. Shumë nga masat që synojnë eliminimin e diskriminimit ndaj personave me aftësi të kufizuara kanë implikime financiare dhe kërkojnë burime financiare (p.sh. sigurimi i qasjes për persona me aftësi të kufizuar në hapësira publike). Ligjet dhe politikat që nuk financohen, vështirë se do të zbatohen plotësisht.

Sigurimi i qasjes në mallra dhe shërbime, siç janë teknologjitë ndihmëse, kujdesi shëndetësor, arsimi etj. Personat me aftësi të kufizuara duhet të kenë qasje në shërbime të tilla, në mënyrë që këta persona të mund t'i gëzojnë të drejtat e tyre në baza të barabarta me të tjerët.

Ngritja e ndërgjegjësimit. Shumë nga pengesat me të cilat përballen personat me aftësi të kufizuara lidhen me qëndrimet negative të shoqërisë. Ngritja e ndërgjegjësimit për të drejtat e personave me aftësi të kufizuara është e rëndësishme për reduktimin e qëndrimeve negative.

Trajnimet për Konventën për profesionistët, siç janë mësuesit, profesionistët shëndetësor dhe profesionistët e Drejtësisë, janë të rëndësishme për realizimin e të drejtave të shumta të personave me aftësi të kufizuara, veçanërisht të atyre të drejtave që kanë të bëjnë me qasjen në shërbime.

Mbledhja e të dhënave është e nevojshme për hartimin e ligjeve dhe politikave të mira për zbatim të Konventës. Si rrjedhojë, shtetet duhet të bëjnë hulumtime dhe të mbledhin të dhëna, në mënyrë që gjendja e personave me aftësi të kufizuara, si dhe pengesat që ata hasin në ushtrimin e të drejtave të tyre të kuptohet mirë.

Ngritja e kapaciteteve të institucioneve që merren me çështjet e personave me aftësi të kufizuara.

Komiteti për të Drejtat e Personave me Aftësi të Kufizuara

Konventa parasheh gjithashtu krijimin e një **organi të pavarur** për monitorimin e zbatimit të saj (**Komiteti për të Drejtat e Personave me Aftësi të Kufizuara**) në përbërje prej 18 anëtarësh, funksioni kryesor i të cilit është shqyrtimi i raporteve të zbatimit nga shtetet, së bashku me raportet e shoqërisë civile, si dhe lehtësimi i dialogut konstruktiv me shtetet palë për fuqizimin e zbatimit të Konventës. Komiteti miraton gjithashtu komente të përgjithshme, duke interpretuar dispozitat e Konventës.

Për më tepër, në kuadër të Protokollit Opsional të KDPAK-së, Komisioni mund:

- të pranojë komunikime individuale (ankesa) dhe t'u bëjë rekomandime Shteteve Palë që i nënshtrohen ankesës për këto komunikime.
- të ndërmarrë hetime në vendet ku ka informacione të besueshme që tregojnë shkelje serioze ose sistematike të Konventës.

Kuadri i Këshillit të Evropës

Në kuadër të Këshillit të Evropës, nuk ka një konventë specifike për të drejtat e personave me aftësi të kufizuara. Por të drejtat e tyre garantohen dhe mbrohen me Konventën Evropiane për të Drejtat e Njeriut dhe protokollet e saj shtesë. Standardet e zhvilluara nga Gjykata Evropiane për të Drejtat e Njeriut në zbatim të Konventës, dhe çështjet më të rëndësishme janë objekt diskutimi në sesionin e radhës të këtij trajnimi.

Nga viti 2006 deri në vitin 2015, Këshilli i Evropës zbatoi Planin e Veprimit për Aftësitë e Kufizuara¹³, i cili i parapriu miratimit dhe hyrjes në fuqi të KDPAK-së. Ky plan veprimi kontribuoi në një debat të gjerë social dhe një kuptim të ri mbi aftësinë e kufizuar në Evropë. Aktualisht, Këshilli i Evropës po zbaton Strategjinë për Personat me Aftësi të Kufizuara, e cila mbulon periudhën 2017-2023. Sipas kësaj Strategjie, personat me aftësi të kufizuara kanë të drejtë të kenë qasje dhe të gëzojnë gamën e plotë të të drejtave të njeriut. Strategjia synon të përfshijë të gjitha të drejtat civile, politike, ekonomike, sociale dhe kulturore¹⁴. Qëllimi i saj i përgjithshëm është të arrijë barazi, dinjitet dhe mundësi të barabarta për personat me aftësi të kufizuara.

Strategjia fokusohet në pesë fusha prioritare, të parashikuara si më poshtë:

- 1) Barazia dhe mosdiskriminimi.
- 2) Rritja e ndërgjegjësimit.
- 3) Qasja.
- 4) Njohje e barabartë para ligjit.
- 5) Liri nga shfrytëzimi, dhuna dhe abuzimi.

¹³ Rekomandimi Rec (2006)5 "Plani i Veprimit të Këshillit të Evropës për promovimin e të drejtave dhe pjesëmarrjen e plotë të personave me aftësi të kufizuara në shoqëri: përmirësimi i cilësisë së jetës së personave me aftësi të kufizuara në Evropë 2006-2015.

¹⁴Këshilli i Evropës. (2017). Të drejtat e njeriut: një realitet për të gjithë, f. 7.

Kuadri i Bashkimit Evropian

Së bashku me shtetet anëtare të Bashkimit Evropian, nënshkruese të Konventës së OKB-së për të Drejtat e Personave me Aftësi të Kufizuara, vetë BE-ja është pale e saj. Në fakt, KDPAK është traktati i parë për të drejtat e njeriut në të cilin BE-ja është bërë palë si një entitet rajonal. Në këtë kuptim, që nga viti 2013, BE-ja ka krijuar një kuadër që promovon, mbron dhe monitoron zbatimin e Konventës në çështjet e kompetencave të BE-së, veçanërisht në drejtim të:

- Legjislacioni dhe politikat e BE-së: si integrimi i parimit të mosdiskriminimit, të drejtat e udhëtarëve, financimi i BE-së, etj.
- Administrata publike e BE-së: përzgjedhja e personelit; qasja në dokumente, etj.

Anëtarë të kuadrit të BE-së janë Parlamenti Evropian, Ombudsmeni Evropian, Komisioni Evropian, Agjencia e BE-së për të Drejtat Themelore dhe Forumi Evropian i Aftësisë së Kufizuar (EDF).

Në përputhje me kompetencat dhe mandatet e tyre, anëtarët bashkërisht kontribuojnë në promovimin, mbrojtjen dhe monitorimin e Konventës së OKB-së. Kuadri plotëson mekanizmat kombëtarë të monitorimit në vendet anëtare të BE-së dhe punon për të përmirësuar bashkërendimin me ta. Këta mekanizma janë përgjegjës për promovimin, mbrojtjen dhe monitorimin e zbatimit të Konventës së OKB-së në nivel kombëtar në vendet të cilat e kanë ratifikuar Konventën. Ato mund të marrin forma të ndryshme si organet kombëtare të barazisë; përfaqësuesit e popullit; institucionet kombëtare për të drejtat e njeriut; si dhe organizatat që merren me të drejtat e personave me aftësi të kufizuara.

Për më tepër, Komisioni Evropian miratoi Strategjinë e dytë Evropiane për të Drejtat e Personave me Aftësi të Kufizuara 2021-2030¹⁵, e cila, bazuar në parimet e KDPAK-së, siguron pjesëmarrjen e këtyre personave në shoqëri në baza të barabarta si qytetarët e tjerë evropianë. Strategjia Evropiane për Aftësi të Kufizuara¹⁶ 2010-2020 hapi rrugën për një Evropë pa barriera, duke inkurajuar veprime të mbështetura edhe nga fondet e BE-së për të bërë një ndryshim në jetën e rreth 87 milionë personave që kanë një formë të aftësisë së kufizuar në BE¹⁷.

¹⁵ Bashkimi Evropian. Strategjia për të Drejtat e Personave me Aftësi të Kufizuara 2021-2030 <https://ec.europa.eu/social/main.jsp?catId=738&langId=en&pubId=8376&furtherPubs=yes>

¹⁶ Komunikimi i Komisionit (COM (2010) 636 final): [Strategjia Evropiane e Aftësisë së Kufizuar 2010-2020](#).

¹⁷ Të dhënat: SAKJ BE (Statistikat mbi të Ardhurat dhe Kushtet e Jetesës) dhe AFP-në e BE-së (Anketa e Fuqisë Punëtore). 24.7% e popullsisë së BE-së > 16 vjeç janë të kufizuar në aktivitetet e tyre, 17.7% kanë kufizime të moderuara, 7% kanë kufizime të rënda; S. Grammenos /M. Priestley, 2020: [Të dhënat e Evropës 2020 dhe personat](#)

Objektivat e strategjisë ndiqen nga iniciativa në tetë fusha prioritare:

- 1. Qasja:** në mjediset e ndërtuara dhe virtuale, në teknologjitë e informacionit dhe komunikimit (TIK), mallra dhe shërbime, përfshirë transportin dhe infrastrukturën, mundëson ushtrimin e të drejtave dhe është një parakusht për pjesëmarrje të plotë të personave me aftësi të kufizuara në baza të barabarta me të tjerët.
- 2. Gëzimi i të drejtave të BE-së:** Personat me aftësi të kufizuara duhet të gëzojnë të gjitha të drejtat në baza të barabarta me të tjerët, veçanërisht kur ata lëvizin në një shtet tjetër anëtar, ose marrin pjesë në jetën politike.
- 3. Cilësi e denjë e jetës dhe jetesa në mënyrë të pavarur:** Jetesa e pavarur, shërbimet cilësore sociale dhe të punësimit, strehimi i qasshëm dhe përfshirës, marrja pjesë në mësimin e vazhdueshëm, mbrojtje adekuate sociale dhe një ekonomi sociale e fuqizuar janë të domosdoshme për një jetë të denjë për të gjithë personat me aftësi të kufizuara.
- 4. Qasje e barabartë dhe mosdiskriminimi:** Personat me aftësi të kufizuara kanë të drejtën e mbrojtjes nga çdo formë diskriminimi dhe dhune, mundësi të barabarta dhe qasje në drejtësi, arsim, kulturë, strehim, rekreacion, kohë të lirë, sport dhe turizëm, dhe qasje të barabartë në të gjitha shërbimet shëndetësore.
- 5. Promovimi i të drejtave të personave me aftësi të kufizuara në nivel global:** BE-ja do të vazhdojë të mbrojë të drejtat e njeriut të personave me aftësi të kufizuara dhe të mbështesë përfshirjen e tyre sociale në të gjitha marrëdhëniet ndërkombëtare, dhe si pjesë e të gjitha veprimeve të jashtme, planifikimit të politikave, programeve dhe aktiviteteve të financimit.
- 6. Zbatimi efikas i strategjisë:** Komisioni u bën thirrje Shteteve Anëtare dhe të gjitha institucioneve dhe agjencive të BE-së që të marrin në konsideratë nevojat e personave me aftësi të kufizuara gjatë hartimit, zbatimit dhe monitorimit të politikave, legjislacionit dhe programeve të financimit përmes veprimeve të synuara dhe integritimit.
- 7. Udhëheqja me shembull:** Komisioni synon të udhëheqë me shembull dhe u bën thirrje institucioneve, organeve dhe agjencive të tjera të BE-së të bëjnë të njëjtën gjë.
- 8. Ndërgjegjësimi, qeverisja dhe progresi:** Komisioni do të punojë me Shtetet Anëtare për të plotësuar dhe për të mbështetur fushatat kombëtare, për ngritjen e ndërgjegjësimit dhe për luftimin e stereotipeve për aftësitë e kufizuara.

3.2 Të drejtat e njeriut dhe personat LGBTIQ+

Kuadri i Kombeve të Bashkuara

Parimet e barazisë në dinjitet dhe në të drejta dhe mosdiskriminimi janë elemente themelore të ligjit ndërkombëtar për të drejtat e njeriut. Këto parime janë të përfshira në Deklaratën Universale mbi të Drejtat e Njeriut dhe përsëriten si obligime ligjërish të detyrueshme në Paktet Ndërkombëtare të OKB-së. Kështu, neni 2(1) i Paktit Ndërkombëtar për të Drejtat Civile dhe Politike (PNDKP) dhe neni 2(2) i Paktit Ndërkombëtar për të Drejtat Ekonomike, Sociale dhe Kulturore (PNDESK) i detyrojnë shtetet të sigurojnë gëzimin e të drejtave të njeriut pa asnjë diskriminim të bazuar në racë, ngjyrë, gjini, gjuhë, fe, opinion politik ose çdo opinion tjetër, origjinë kombëtare apo shoqërore, pasuri, lindje ose çdo status tjetër. Parimi i mosdiskriminimit para ligjit është përcaktuar në nenin 26 të PNDKP-së dhe ndalon diskriminimin mbi bazat e njëjta të cekura në nenin 2(1) të PNDKP-së.

Megjithëse orientimi seksual dhe identiteti gjinor nuk përmenden shprehimisht si baza mbi të cilat ndalohet diskriminimi, organet përkatëse të traktatit i kanë interpretuar paktet në praktikën e tyre gjyqësore ¹⁸ose në komentet e përgjithshme për të përfshirë orientimin seksual dhe identitetin gjinor brenda listave të hapura për bazat e diskriminimit. Në të vërtetë, në komentin e tij të përgjithshëm nr. 20, Komiteti i OKB-së për të Drejtat Ekonomike, Sociale dhe Kulturore shpjegon se “Shtetet Palë duhet të zotohen që orientimi seksual i një personi të mos përbëjë pengesë për ushtrimin e të drejtave të Paktit, për shembull, për qasje në të drejtën për pension familjar.

Gjithashtu, identiteti gjinor njihet si një ndër bazat mbi të cilat ndalohet diskriminimi; për shembull, personat që janë transgjinor, transeksual ose interseksor shpesh përballen me shkelje serioze të të drejtave të njeriut, të tilla si ngacmime në shkolla apo në vendin e punës.”¹⁹ Parimi i mosdiskriminimit është gjithashtu pjesë e konventave të specializuara të OKB-së për të drejtat e njeriut. Konventa e OKB-së për eliminimin e të gjitha formave të diskriminimit kundër grave (CEDAW) përmban një klauzolë për ndalimin e diskriminimit²⁰ dhe Komiteti për Eliminimin e

¹⁸Komiteti i OKB-së për të Drejtat e Njeriut, Toonen kundër Australisë, Komunikimi nr. 488/1992 30, mars 1994, CCPR/ C/50/D/488/1992, paragrafi 8.7; Komiteti i OKB-së për të Drejtat e Njeriut, Young kundër Australisë, Komunikimi nr. 941/2000, 6 gusht 2003, CCPR/C/78/D/941/2000; Komiteti i OKB-së për të Drejtat e Njeriut, X kundër Kolumbisë, Komunikimi nr. 1361/2005, 14 maj 2007, CCPR/C/89/D/1361/2005.

¹⁹Komiteti i OKB-së për të Drejtat Ekonomike, Sociale dhe Kulturore, Komenti i Përgjithshëm Nr. 20 mbi Mosdiskriminimin në lidhje me të Drejtat Ekonomike, Sociale dhe Kulturore, 2009, paragrafi 32.

²⁰Konventa për Eliminimin e të Gjitha Formave të Diskriminimit kundër Grave, 1979, Neni 2.

Diskriminimit Kundër Grave sqaroi në rekomandimin e tij të përgjithshëm se “diskriminimi i grave i bazuar në seks dhe gjini është i lidhur në mënyrë të pazgjidhshme me faktorë të tjerë që ndikojnë tek gratë, si raca, përkatësia etnike, feja ose besimi, shëndeti, statusi, mosha, klasa, kasta dhe orientimi seksual dhe identiteti gjinor. ... Shtetet Palë duhet të njohin dhe të ndalojnë ligjërisht forma të tilla të ndërthurura të diskriminimit dhe ndikimin e tyre negativ mbi gratë në fjalë.”²¹ Në mënyrë të ngjashme, neni 2 i Konventës së OKB-së për të Drejtat e Fëmijës (KDF) përbën një dispozitë të përgjithshme të mosdiskriminimit për gëzimin e të drejtave të mbrojtura me këtë Konventë. Në komentin e tij të përgjithshëm, Komiteti për të Drejtat e Fëmijës i referohet në mënyrë specifike orientimit seksual si një bazë mbi të cilën ndalohet diskriminimi, por jo edhe identitetit gjinor.²²

Disa raportues specialë të OKB-së kanë zbatuar standardet ndërkombëtare në ngritjen e shqetësimeve serioze për të drejtat e njeriut në lidhje me trajtimin e personave LGBT. Këta përfshijnë Raportuesin Special për të drejtën e lirisë së mendimit dhe shprehjes,²³ Raportuesin Special për të drejtën e secilit për të gëzuar standardin më të lartë të arritshëm të shëndetit fizik dhe mendor,²⁴ Raportuesin Special për të drejtën për arsimim,²⁵ Raportuesin Special për strehimin e përshtatshëm, si një komponent i së drejtës për standarde të përshtatshme të jetesës²⁶ dhe Raportuesi Special për çështjet e torturës dhe trajtimeve ose ndëshkimeve të tjera mizore, çnjerëzore ose poshtëruese.²⁷

²¹Rekomandimi i përgjithshëm nr. 28 mbi detyrimet themelore të shteteve palë sipas nenit 2 të Konventës mbi Eliminimin e të gjitha formave të diskriminimit kundër grave, CEDAW/C/2010/47/GC.2, paragrafi 18.

²²Komiteti i OKB-së për të Drejtat e Fëmijëve, Komenti i Përgjithshëm nr. 4, 2003, paragrafi 6.

²³Kombet e Bashkuara, “Raporti i Raportuesit Special për të Drejtën për Lirinë e Mendimit dhe Shprehjes, Ambeyi Ligabo, Shtojca: Misioni në Kolumbi”, E/CN.4/2005/64/Add.3 e 26 nëntorit 2004, paragrafi 75.

²⁴Kombet e Bashkuara, “E drejta e secilit për të gëzuar standardin më të lartë të arritshëm të shëndetit fizik dhe mendor – Raporti i Raportuesit Special, Paul Hunt”, E/CN.4/2004/49, paragrafi 24; Këshilli i të Drejtave të Njeriut, “Raporti i Raportuesit Special për të Drejtën e Secilit për të Gëzuar Standardin më të Lartë të Arritshëm të Shëndetit Fizik dhe Mendor, Anand Grover”, A/HRC/14/20, paragrafi 9, 27 prill 2010.

²⁵Kombet e Bashkuara, Komisioni për të Drejtat e Njeriut, “Të drejtat ekonomike, sociale dhe kulturore, e drejta e vajzave për arsim, Raporti i dorëzuar nga Raportuesi Special për të Drejtën në Arsim, Z. V. Muñoz Villalobos”, 8 shkurt 2006, paragrafi 113; Kombet e Bashkuara, “Raporti i Raportuesit Special të Kombeve të Bashkuara për të Drejtën për Arsimim”, A/65/162, 23 korrik 2010, paragrafi 23.

²⁶Këshilli Ekonomik dhe Social i OKB-së, “Raporti i Raportuesit Special për Strehimin adekuat si një komponent i të drejtës për një standard adekuat të jetesës, Miloon Kothari”, E/CN.4/2004/48, 8 mars 2004, paragrafi 49.

²⁷Raporti i Raportuesit Special të Kombeve të Bashkuara për Çështjen e Torturës dhe Trajtimeve ose Ndëshkimeve të tjera Mizore, Çnjerëzore ose Degraduese”, OKB Doc. A/56/156, 3 korrik 2001, paragrafi 22; Asambleja e Përgjithshme e KB, Doc. A/59/324, 1 shtator 2004, paragrafi 39.

Kuadri i Këshillit të Evropës

Konventa Evropiane për të Drejtat e Njeriut në nenin 14 ofron një listë të hapur të bazave të ndaluara të diskriminimit, të cilat janë përsëritur në Protokollin nr. 12 të Konventës për ndalimin e përgjithshëm të diskriminimit. Protokollin ka një fushë zbatimi më të gjerë se neni 14, pasi fusha e zbatimit të tij nuk kufizohet në të drejtat dhe liritë e përcaktuara në vetë Konventën. As neni 14 dhe as Protokollin nuk përmendin në mënyrë specifike orientimin seksual ose identitetin gjinor si baza mbi të cilat ndalohet diskriminimi, por komentari i dispozitave të Protokollit në fjalë përcakton se lista e bazave të ndaluara të diskriminimit nuk është shteruese.²⁸

Në vitin 1999, Gjykata Evropiane e të Drejtave të Njeriut konfirmoi se orientimi seksual është një bazë diskriminimi e përfshirë në nenin 14 të Konventës.²⁹ Në mënyrë të ngjashme, në vitin 2010, Gjykata përmendi në mënyrë eksplicite transeksualitetin³⁰ – edhe pse jo identitetin gjinor – si një bazë e ndaluar diskriminimi sipas nenit 14 të Konventës, megjithëse kjo mund të ishte cekur edhe në vendimet e saj të mëparshme.³¹ Gjykata ka nxjerrë disa aktgjykime të rëndësishme mbi diskriminimin e pretenduar të bazuar në orientimin seksual, në të cilat iu është referuar nenit 14 në lidhje me nenet përmbajtjesore të Konventës, veçanërisht nenin 8 mbi të drejtën për respektimin e jetës private dhe familjare. Në këto raste, Gjykata ka kufizuar rreptësisht shkallën e vlerësimit të shteteve duke theksuar se dallimet në trajtim mbi këtë bazë kërkojnë arsye veçanërisht bindëse për të qenë legjitime sipas Konventës.³²

Parimi i mosdiskriminimit mund të gjendet edhe në konventat më të specializuara të Këshillit të Evropës. Më 7 prill 2011, Komiteti i Ministrave miratoi Konventën për parandalimin dhe luftimin e dhunës ndaj grave dhe dhunës në familje.³³ Kjo konventë është instrumenti i parë ligjërish i detyrueshëm në botë, që krijon një kuadër ligjor gjithëpërfshirës për parandalimin e dhunës dhe

²⁸Raport shpjegues për Protokollin nr. 12 të Konventës së 1950 për Mbrojtjen e të Drejtave të Njeriut dhe Lirive Themelore, e cila hyri në fuqi më 1 prill 2005, ETS nr. 177.

²⁹Shih Gjykata Evropiane e të Drejtave të Njeriut, Mouta kundër Portugalisë, Kërkesa nr. 33290/96, aktgjykimi i datës 21 dhjetor 1999. Megjithatë, qysh në vitin 1981, Gjykata, në çështjen Dudgeon kundër Mbretërisë së Bashkuar, Kërkesa nr. 7525/76, kishte gjetur diskriminimin në ligjin penal në lidhje me marrëdhëniet e pëlqimit ndërmjet të rriturve të të njëjtit seks në mënyrë private, ishte në kundërshtim me të drejtën për respektimin e jetës private në nenin 8 të KEDNJ.

³⁰Gjykata Evropiane e të Drejtave të Njeriut, PV kundër Spanjës, Kërkesa nr. 35159/09, aktgjykimi i datës 30 nëntor 2010, paragrafi 30. Në rastin konkret nuk u konstatua shkelje e dispozitës.

³¹Shih për shembull Gjykata Evropiane e të Drejtave të Njeriut, Christine Goodwin kundër Mbretërisë së Bashkuar, Kërkesa nr. 28957/95, aktgjykimi i datës 11 korrik 2002.

³²Gjykata Evropiane e të Drejtave të Njeriut, Karner kundër Austrisë, Kërkesa nr. 40016/98, aktgjykimi i datës 24 korrik 2003, paragrafi 37, EB kundër Francës, Kërkesa nr. 43546/02, aktgjykimi i datës 22 janar 2008, paragrafi 91 dhe Schalk dhe Kopf kundër Austrisë, Kërkesa nr. 30141/04, aktgjykimi i datës 24 qershor 2010, paragrafi 97.

³³Konventa u hap për nënshkrim në Stamboll më 11 maj 2011 (CETS Nr. 210).

për mbrojtjen e viktimave. Neni për mosdiskriminimin i Konventës përfshin bazat e orientimit seksual dhe identitetit gjinor, duke e bërë kështu traktatin e parë ndërkombëtar që përfshin shprehimisht orientimin seksual dhe identitetin gjinor si baza të ndaluara diskriminimi.

Një instrument tjetër i detyrueshëm i Këshillit të Evropës, Karta Sociale Evropiane e rishikuar, përfshin një dispozitë të hapur për mosdiskriminimin në Nenin E në lidhje me gëzimin e të drejtave të përcaktuara në Kartë. Edhe pse orientimi seksual dhe identiteti gjinor nuk përmenden drejtpërdrejt në mesin e bazave të ndaluara të diskriminimit, në vitin 2009, Komiteti Evropian i të Drejtave Sociale pohoi se “materialet edukative [nuk duhet] të përforcojnë stereotipet poshtëruese dhe të përjetësojnë forma të paragjyqimit të cilat kontribuojnë në përjashtimin social, diskriminimin e rrënjosur dhe mohimin e dinjitetit njerëzor, të cilat shpesh përjetohej nga grupe historikisht të marginalizuara, siç janë si personat me orientim joheteroseksual”.³⁴

Në vitin 2010, Komiteti i Ministrave të Këshillit të Evropës miratoi një Rekomandim për masat për luftën kundër diskriminimin për shkak të orientimit seksual ose identitetit gjinor.³⁵ Rekomandimi fton shtetet anëtare të sigurojnë që parimet dhe masat e përcaktuara të zbatohen në legjislacionin kombëtar, politikat dhe praktikat që lidhen me mbrojtjen e të drejtave të njeriut të personave LGBT. Rekomandimi mbulon një gamë të gjerë fushash duke përfshirë krimi e urrejtjes, lirinë e organizimit, lirinë e shprehjes dhe tubimin paqësor, respektimin e jetës familjare dhe jetës private, punësimin, arsimin, shëndetin, strehimin, sportet, azilin, strukturat kombëtare të të drejtave të njeriut dhe diskriminimin për shkaqe të shumëfishta. Megjithëse nuk është një instrument ligjërishëm, të gjitha vendet anëtare të Këshillit të Evropës duhet ta zbatojnë këtë rekomandim. Asambleja Parlamentare e Këshillit të Evropës gjithashtu miratoi rezoluta dhe rekomandime për këtë temë.³⁶

³⁴Shih Komiteti Evropian i të Drejtave Sociale, Qendra Ndërkombëtare për Mbrojtjen Ligjore të të Drejtave të Njeriut (Interights) kundër Kroacisë – Ankesa Kolektive nr. 45/2007, aktgjykim i datës 30 mars 2009, paragrafët 60-61.

³⁵Shih Rekomandimin e Komitetit të Ministrave CM/ Rec(2010)5 mbi masat për të luftuar diskriminimin në bazë të orientimit seksual ose identitetit gjinor – Memorandumi shpjegues për Rekomandimin, CM(2010)4 add3 rev2E, 29 mars 2010

³⁶Rekomandimi 1915 (2010) i Asamblesë Parlamentare për Diskriminimin në bazë të orientimit seksual dhe identitetit gjinor; Rezoluta 1728 (2010) e Kuvendit Parlamentar për Diskriminimin në bazë të orientimit seksual dhe identitetit gjinor; Rekomandimi 1635 (2003) i Asamblesë Parlamentare për lezbiket dhe homoseksualët në sport; Rekomandimi 1474 (2000) i Asamblesë Parlamentare për situatën e lezbikeve dhe homoseksualëve në shtetet anëtare të Këshillit të Evropës; Rekomandimi 1470 (2000) i Asamblesë Parlamentare mbi situatën e homoseksualëve dhe lezbikeve dhe partnerëve të tyre në lidhje me azilin dhe imigracionin në shtetet anëtare të Këshillit të Evropës; Rekomandimi 1117 (1989) i Asamblesë Parlamentare për gjendjen e transeksualëve; Rekomandimi 924 (1981) i Asamblesë Parlamentare për Diskriminimin ndaj homoseksualëve; Rezoluta 756 (1981) e Asamblesë Parlamentare për diskriminimin ndaj homoseksualëve.

Kuadri i Bashkimit Evropian

Aktualisht, 27 shtete anëtare të Këshillit të Evropës janë gjithashtu anëtarë të Bashkimit Evropian. Parimi i përgjithshëm i trajtimit të barabartë ndërmjet burrave dhe grave u fut në të drejtën për Bashkimin Evropian në vitin 1957, me Traktatin themelues të Komunitetit Ekonomik Evropian (Traktati i Romës). Traktati i Amsterdimit (1997) dhe Traktati i Lisbonës (2007) fuqizuan më tej parimin e trajtimit të barabartë, duke lejuar që masat e Bashkimit Evropian të luftojnë diskriminimin mbi disa baza, duke përfshirë orientimin seksual, por jo identitetin gjinor. Traktati për Bashkimin Evropian (TEU) i ndryshuar nga Traktati i Lisbonës pohon rolin qendror të "respektimit të dinjitetit njerëzor, lirisë, demokracisë, barazisë, shtetit të së drejtës dhe respektimit të të drejtave të njeriut, duke përfshirë të drejtat e personave që u përkasin pakicave"³⁷ si parim themelor i Unionit. Këto vlera konsiderohen gjithashtu thelbësore për një shoqëri ku mbizotëron mosdiskriminimi. Prandaj, Traktati i Lisbonës e kthen parimin e mosdiskriminimit në një klauzolë horizontale, e cila duhet të aplikohet në zbatimin e tërë tekstit të traktatit.

Karta e të Drejtave Themelore të Bashkimit Evropian përfshin një dispozitë të përgjithshme kundër diskriminimit në nenin 21.1 të kartës, e cila gjithashtu përmend orientimin seksual në mesin e bazave të ndaluara të diskriminimit.³⁸ Identiteti gjinor nuk përmendet shprehimisht, por meqenëse lista e arsyeve nuk është shteruese, është e hapur për përfshirjen e arsyeve të tjera që shkaktojnë trajtim të ndryshëm. Për më tepër, fushëveprimi i bazës së "seksit" në Kartën e të Drejtave Themelore duhet të zbatohet në përputhje me jurisprudencën e Gjykatës së Drejtësisë së Bashkimit Evropian për këtë bazë.

Bashkimi Evropian ka prezantuar gjithashtu direktiva specifike për trajtimin e barabartë. Aktualisht, luftimi i diskriminimit për shkak të orientimit seksual sipas ligjit të Bashkimit Evropian është i kufizuar vetëm në fushën e punësimit.³⁹ Çështja e zgjerimit të fushëveprimit material të parimit të trajtimit të barabartë ndërmjet personave, pavarësisht nga orientimi seksual përtej

³⁷Bashkimi Evropian, Versioni i Konsoliduar i Traktatit për Bashkimin Evropian, OJ C115/13, Neni 2, 9 maj 2008.

³⁸Karta e të Drejtave Themelore e Bashkimit Evropian, miratuar në vitin 2000, OJ C 83/02, 30 mars 2010.

³⁹Bashkimi Evropian, Direktiva e Këshillit 2000/78/KE e 27 nëntorit 2000, që vendos një kornizë të përgjithshme për trajtim të barabartë në punësim dhe profesion, 2000, OJ 2000 L 303. Shih gjithashtu, Gjykata e Drejtësisë së Bashkimit Evropian, C-267/06, Tadao Maruko kundër Versorgungsanstalt der deutschen Bühnen VdB, aktgjykimi i datës 1 prill 2008, paragrafi 65, ECR I-1757.

punësimi, po shqyrtohet nga Këshilli i Bashkimit Evropian duke iu referuar propozimit të Komisionit për direktivën e ashtuquajtur "horizontale" për trajtim të barabartë.⁴⁰

Identiteti gjinor nuk njihet shprehimisht si një bazë e ndaluar diskriminimi në direktivat e Bashkimit Evropian. Megjithatë, Gjykata e Drejtësisë e Bashkimit Evropian ka aplikuar bazën e seksit për të zgjeruar garancitë e trajtimit të barabartë, në mënyrë që të mbuloj, të paktën pjesërisht, diskriminimin e përjetuar nga personat transgjinorë. Në rastin e P. kundër S. dhe Këshillit të Qarkut Cornwall, e vitit 1996, Gjykata e Drejtësisë deklaroi se parimi i trajtimit të barabartë "duhet të përfshijë diskriminimin që rrjedh nga ndryshimi i gjinisë, i cili, në thelb, bazohet nëse jo ekskluzivisht, në gjininë e personit në fjalë, pasi që shkarkimi nga puna e një personi me arsyetimin se ai ose ajo synon t'i nënshtrohet, ose i është nënshtruar ndryshimit të gjinisë, do të thotë se ajo ose ai trajtohet në mënyrë të pafavorshme në krahasim me personat e gjinisë së cilës ai ose ajo mendohej se i përkiste para operacionit".⁴¹ Këtë e konfirmojnë edhe dy vendime të tjera të Gjykatës së Drejtësisë.⁴² Në përputhje me këtë jurisprudencë, Këshilli i Bashkimit Evropian deklaroi se diskriminimi që rezulton nga ndryshimi i gjinisë mbrohet gjithashtu në kuadër të Direktivës së Bashkimit Evropian me të cilën zbatohet parimi i trajtimit të barabartë të burrave dhe grave në qasjen dhe furnizimin me mallra dhe shërbimet.⁴³ Direktiva për ndryshimin e gjinisë e vitit 2006 u bë Direktiva e parë e Bashkimit Evropian e cila gjithashtu u referohet personave që synojnë t'i nënshtrohen ose i janë nënshtruar ndryshimit të gjinisë.⁴⁴ Fusha materiale e zbatimit të Direktivës për ndryshimin e gjinisë përfshin: a) qasjen në punësim, vetëpunësim dhe profesion, duke përfshirë ngritjen në detyrë; trajnimin dhe rikualifikimin profesional; punësimin, duke përfshirë ngritjen në detyrë dhe shkarkimin; anëtarësimin dhe përfshirjen në organizatë punëtorësh ose punëdhënësish, ose organizata të tjera profesionale; b) kushtet e punës, përfshirë pagën; c) skemat e sigurimeve sociale në punë, duke përfshirë pensionet, pushimin mjekësor, invaliditetin, aksidentet industriale dhe sëmundjet profesionale, si dhe benefitet për të papunësuarit.

⁴⁰Bashkimi Evropian, Propozimi për një Direktivë të Këshillit për zbatimin e parimit të trajtimit të barabartë ndërmjet personave, pavarësisht nga feja ose besimi, aftësia e kufizuar, mosha ose orientimi seksual COM/2008/0426 përfundimtar – 2008/0140 (CNS), 2 korrik 2008.

⁴¹Gjykata e Drejtësisë e Bashkimit Evropian, C-13/94, P. kundër S. dhe Këshilli i Qarkut Cornwall, aktgjykim i datës 30 prill 1996, paragrafët 21-22.

⁴²Gjykata e Drejtësisë e Bashkimit Evropian, C-117/01, KB kundër Agjencisë Kombëtare të Pensioneve të Shërbimit Shëndetësor, Sekretari i Shtetit për Shëndetësinë, aktgjykim i datës 7 janar 2004, C-423/04, Sarah Margaret Richards kundër Sekretarit të Shtetit për Puna dhe Pensionet, aktgjykim i datës 27 prill 2006.

⁴³Takimi i 2606 i Këshillit të Bashkimit Evropian (Punësimi, Politika Sociale, Shëndetësia dhe Çështjet e Konsumatorëve), mbajtur në Luksemburg më 4 tetor 2004, Procesverbal, Doc. Nr 13369/04 i 27 tetorit 2004, f. 7.

⁴⁴Bashkimi Evropian, Direktiva 2006/54/KE e Parlamentit Evropian dhe e Këshillit e 5 korrikut 2006 mbi zbatimin e parimit të mundësive të barabarta dhe trajtimit të barabartë të burrave dhe grave në çështjet e punësimi dhe profesionit (i spastruar) OJ L 204, 26 qershor 2006 f. 23-36. Lista nr. 3.

Ndërsa e drejta e Bashkimit Evropian mbron në këtë mënyrë këtë segment të komunitetit transgjinnor mbi bazën e "gjinisë", e drejta e Bashkimit Evropian nuk mbulon shprehimisht të drejtën për trajtim të barabartë të personave transgjinnorë që nuk i janë nënshtruar dhe nuk synojnë t'i nënshtrohen një operacioni të ndryshimit të gjinisë. Në qershor të vitit 2010, Parlamenti Evropian i bëri thirrje Komisionit Evropian që të sigurojë që ky hendek të adresohet në nismat e ardhshme të Bashkimit Evropian për barazinë gjinore.⁴⁵ Komisioni Evropian vendosi të shqyrtojë “çështje specifike që kanë të bëjnë me diskriminimin gjinnor në lidhje me identitetin gjinnor” në kuadër të Strategjisë së Bashkimit Evropian për barazinë midis grave dhe burrave 2010-2015.⁴⁶

Parimet e Yogyakartaës

Parimet e Yogyakartaës mbi zbatimin e të Drejtës Ndërkombëtare për të Drejtat e Njeriut në lidhje me Orientimin Seksual dhe Identitetin Gjinnor, u miratuan në vitin 2006 nga një grup ekspertësh të të drejtave të njeriut, me qëllim që të promovohet zbatimi i detyrimeve tashmë ekzistuese sipas të drejtës ndërkombëtare për të drejtat e njeriut në lidhje me personat LGBT. Si të tilla, ato propozojnë standarde bazë për mbrojtjen dhe promovimin e gëzimit të plotë të të gjitha të drejtave të njeriut, pavarësisht nga orientimi seksual dhe identiteti gjinnor. Disa shtete, duke përfshirë Republikën Çeke, Danimarkën, Finlandën, Islandën, Norvegjinë, Suedinë dhe Zvicrën, i kanë miratuar parimet ose u janë referuar atyre në deklaratat e tyre në Këshillin e Kombeve të Bashkuara për të Drejtat e Njeriut. Vende të tjera miratuan parimet në nivelin ekzekutiv (Gjermania, Holanda, Spanja dhe Mbretëria e Bashkuar) ose në nivelin legjislativ (Belgjikë).⁴⁷

3.3 Antigjipsizmi dhe mosdiskriminimi i komuniteteve rom, ashkali dhe egjiptian

Kuadri i Kombeve të Bashkuara

Parimet e barazisë në dinjitet dhe në të drejta dhe mosdiskriminimi janë elemente themelore të së drejtës ndërkombëtare për të drejtat e njeriut. Këto parime janë të përfshira në Deklaratën Universale për të Drejtat e Njeriut, dhe përsëriten si parime ligjërish të detyrueshme në Paktet

⁴⁵Rezoluta e Parlamentit Evropian e datës 17 qershor 2010 mbi vlerësimin e rezultateve të Udhërrëfyesit 2006-2010 për Barazinë ndërmjet grave dhe burrave, dhe rekomandime largpamëse.

⁴⁶Komunikim nga Komisioni për Këshillin, Parlamentin Evropian, Komitetin Ekonomik dhe Social Evropian dhe Komitetin e Rajoneve: Strategjia për barazi ndërmjet grave dhe burrave 2010-2015, paragrafi 6.2.

⁴⁷Ettelbrick PL dhe Zerán AT, Ndikimi i Parimeve të Yogyakartaës në zhvillimin e të Drejtës Ndërkombëtare për të Drejtat e Njeriut. Një studim i nëntorit 2007 – qershor 2010, Raporti përfundimtar, 2010, f. 12.

Ndërkombëtare të OKB-së. Kështu, neni 2(1) i Paktit Ndërkombëtar për të Drejtat Civile dhe Politike (PNDKP) dhe neni 2(2) i Paktit Ndërkombëtar për të Drejtat Ekonomike, Sociale dhe Kulturore (PNDESK) i detyrojnë shtetet të sigurojnë gëzimin e të drejtave të njeriut pa asnjë diskriminim të bazuar në racë, ngjyrë, gjini, gjuhë, fe, opinion politik ose çdo opinion tjetër, origjinë kombëtare apo shoqërore, pasuri, lindje ose çdo status tjetër. Parimi i mosdiskriminimit para ligjit është përcaktuar në nenin 26 të PNDKP dhe ndalon diskriminimin mbi të njëjtat baza të cekura në nenin 2(1) të PNDKP-së.

Asambleja e Përgjithshme e Kombeve të Bashkuara miratoi Konventën Ndërkombëtare për Eliminimin e të Gjitha Formave të Diskriminimit Racor (KNEDR),⁴⁸ e cila thekson qartë se Kombet e Bashkuara konsiderojnë se ekzistenca e barrierave racore është e papajtueshme me parimet e dinjitetit dhe barazisë njerëzore. Konventa gjithashtu e përkufizon shprehjen diskriminim racor si "çdo dallim, përjashtim, kufizim ose preferencë që bazohet në racën, ngjyrën, prejardhjen ose origjinën kombëtare e etnike, që ka për qëllim apo për efekt të shkatërrojë ose të komprometojë njohjen, gëzimin ose ushtrimin, në kushte barazie, të të drejtave dhe të lirive themelore të njeriut në fushat politike, ekonomike, shoqërore dhe kulturore ose në çdo fushë tjetër të jetës publike.

Përveç kësaj, Konventa Ndërkombëtare për të Drejtat Civile dhe Politike⁴⁹, nenet 19 dhe 20, parasheh lirinë e mendimit dhe të shprehjes – KDNJ dhe mund të kufizohet nëse kjo përcaktohet me ligj dhe është e domosdoshme për respektimin e të drejtave ose të reputacionit të të tjerëve, ose për mbrojtjen e sigurisë kombëtare, të rendit publik ose të shëndetit ose moralit publik (p.sh. fjalimet antisemitike), dhe se çdo thirrje për urrejtje kombëtare, racore ose fetare që përbën nxitjen për diskriminim, armiqësi ose dhunë ndalohet me ligj.

Duke pasur parasysh se disa vende kanë përfshirë rezerva ndaj nenit 20(2) mbi bazat e lirisë së shprehjes, të përcaktuar në nenet 18, 19 dhe 20 të Deklaratës Universale për të Drejtat e Njeriut, dhe të konfirmuar në nenet 18, 19, 21 dhe 22 të Paktit, Komenti i Përgjithshëm Nr. 34, Komiteti për të Drejtat e Njeriut mbi nenet 19 dhe 20, PNDKP (2012), është se nenet 19 dhe 20 janë në përputhje dhe plotësojnë njëri-tjetrin. Të gjitha aktet e renditura në nenin 20 i nënshtrohen kufizimeve në përputhje me nenin 19, paragrafi 3.

Konventa Ndërkombëtare për Eliminimin e Diskriminimit Racor, 1965 – thotë se ndalimi i diskriminimit racor është fundamental dhe i rrënjosur thellë në të drejtën ndërkombëtare. Është

⁴⁸Konventa Ndërkombëtare për Eliminimin e të Gjitha Formave të Diskriminimit Racor në dispozicion në <https://www.ohchr.org/EN/ProfessionalInterest/Pages/CERD.aspx>

⁴⁹Po aty

e njohur se ka karakterin e jashtëzakonshëm të *jus cogens*⁵⁰ që krijon detyrime *erga omnes*⁵¹, detyrim nga i cili nuk pranohet asnjë shmangie. Gjithashtu ndalon manifestimin e racizmit, urrejtjes racore të manifestuar me fjalë, veprime dhe grupe të organizuara dhe fjalime raciste nga zyrtarët publikë. Neni 4 i kësaj konvente përcakton që shtetet "do të deklarojnë si vepër penale të dënueshme me ligj çdo përhapje të ideve të bazuara në epërsi ose urrejtje racore, nxitje për diskriminim racor, si dhe të gjitha aktet e dhunës ose nxitjen për akte të tilla ndaj çdo race ose grupi personash me ngjyrë të ndryshme lëkure ose origjine të ndryshme etnike, si dhe ofrimin e çdo ndihme për aktivitetet raciste, përfshirë financimin e tyre".

Shumë Shtete Palë kanë përfshirë rezerva ndaj nenit 4 në bazë të lirisë së shprehjes; Komiteti KEDR paralajmëron se liria e fjalës "mbart detyra dhe përgjegjësi të veçanta, ndër të cilat është detyrimi për mospërhapjen e ideve raciste".

Parimi i mosdiskriminimit është gjithashtu pjesë e konventave më të specializuara të OKB-së për të drejtat e njeriut. Për sa i përket niveleve të shumëfishta të diskriminimit, ndërsektorialiteti njihet zyrtarisht nga Komiteti për Eliminimin e Diskriminimit ndaj Grave (KEDNG) si një koncept përkatës për të kuptuar qëllimin e detyrimit të shteteve palë për eliminimin e diskriminimit. Komiteti deklaroi se: "Shtetet palë duhet ligjërisht të njohin dhe të ndalojnë forma të tilla të mbivendosura të diskriminimit dhe ndikimin e tyre negativ dhe të përkeqësuar tek gratë në fjalë."⁵²

Në mënyrë të ngjashme, neni 2 i Konventës së KB-së për të Drejtat e Fëmijës (KDF) përbën një dispozitë të përgjithshme të mosdiskriminimit për gezimin e të drejtave të mbrojtura me konventë. Në një koment të përgjithshëm, Komiteti për të Drejtat e Fëmijës i referohet në mënyrë specifike orientimit seksual si një bazë mbi të cilën ndalohej diskriminimi, por jo edhe identitetit gjinor.⁵³

- Neni 19, Pakti Ndërkombëtar për të Drejtat Civile dhe Politike, 1966 parasheh lirinë e mendimit dhe të shprehjes – KDNJ dhe ato mund të kufizohen kur një gjë e tillë parashihet me ligj, dhe në qoftë se është e nevojshme për respektimin e të drejtave ose reputacionit të të tjerëve, ose për mbrojtjen e sigurisë kombëtare, rendit publik ose shëndetit apo moralit publik (p.sh. fjalimet antisemitike)

⁵⁰Ligj i detyrueshëm

⁵¹Ndaj të gjithëve

⁵²Rekomandimi i përgjithshëm nr. 28 mbi detyrimet themelore të shteteve palë sipas nenit 2 të Konventës për Eliminimin e të Gjitha Formave të Diskriminimit ndaj Grave, CEDAW/C/2010/47/GC.2 në dispozicion në <https://www.ohchr.org/en/treaty-bodies/cedaw>

⁵³Komiteti i OKB-së për të Drejtat e Fëmijëve, Komenti i Përgjithshëm nr. 4, 2003, paragrafi 6.

- Neni 20, Pakti Ndërkombëtar për të Drejtat Civile dhe Politike: "Çdo thirrje për urrejtje kombëtare, racore ose fetare që përbën nxitje për diskriminim, armiqësi ose dhunë ndalohet me ligj" - Disa vende kanë përfshirë rezerva për nenin 20(2) për bazat e lirisë së shprehjes, të përcaktuara në nenet 18, 19 dhe 20 të Deklaratës Universale për të Drejtat e Njeriut, dhe të konfirmuara në nenet 18, 19, 21 dhe 22 të Paktit
- Komenti i Përgjithshëm Nr. 34, Komiteti i të Drejtave të Njeriut mbi nenin 19 dhe 20, ICCPR (2012) Komiteti për të Drejtat e Njeriut u shpreh se: "Nenet 19 dhe 20 janë në përputhje dhe plotësojnë njëri-tjetrin. Veprimet që trajtohen në nenin 20 i nënshtrohen të gjitha kufizimeve në përputhje me nenin 19, paragrafi 3.
- Neni 4, Konventa Ndërkombëtare për Eliminimin e Diskriminimit Racor, 1965 – ndalon manifestimin e racizmit, urrejtjes racore që manifestohet si me fjalë, veprime dhe grupe të organizuara, si dhe fjalimet raciste të zyrtarëve publik. Shtetet "zotohen të shpallin vepra të dënueshme me ligj çdo përhapje të ideve të bazuara në epërsinë ose urrejtjen racore, çdo nxitje për diskriminim racor, si dhe çdo akt dhune, ose nxitje për kryerjen e akteve të kësaj natyre kundër çdo race apo grupi personash të një ngjyrë ose origjinë tjetër etnike , si dhe ndihmën e veprimtarive raciste, duke përfshirë edhe financimin e tyre"
- Shumë Shtete Palë kanë përfshirë rezervime ndaj nenit 4 për arsye të lirisë së shprehjes; Komiteti KEDR paralajmëron se liria e shprehjes "mbart detyra dhe përgjegjësi të veçanta, ndër të cilat edhe detyrimi i mospërhapjes së ideve raciste".
- Plani i Veprimit i Rabatit për ndalimin e avokimit të urrejtjes kombëtare, racore ose fetare që përbën nxitje për diskriminim, armiqësi ose dhunë (2012) synon të lehtësojë dhe përforcojë zbatimin dhe mbrojtjen e të drejtave të njeriut. Ai është rezultat i një procesi konsultativ nga poshtë-lart, me shumë palë të interesuara.

Kuadri i Këshillit të Evropës

GJEDNJ sqaroi se raca dhe përkatësia etnike janë koncepte të lidhura dhe të mbivendosura. Ndërsa nocioni i racës i ka rrënjët në idenë e klasifikimit biologjik të qenieve njerëzore në nënspecie sipas veçorive morfologjike, si ngjyra e lëkurës ose tiparet e fytyrës, etnia e ka origjinën në idenë e grupeve shoqërore, të shënuar nga kombësia e përbashkët, përkatësia fisnore, besimi fetar, gjuha e përbashkët, ose origjina apo prejardhja kulturore dhe tradicionale. Megjithëse "raca" dhe 'etnia' janë konstruksione sociale që i referohen 'origjinës' së individit, ato mbeten koncepte të dallueshme në kuptimin e ligjit kundër diskriminimit, të paktën në Evropë. 'Raca' përdoret kryesisht për t'iu referuar situatave në të cilat personat diskriminohen në bazë të karakteristikave fizike të dukshme nga jashtë. 'Përkatësia etnike' nga ana tjetër, më tepër i

referohet anëtarësimit në në grup që ndan disa karakteristika të përbashkëta, të tilla si gjuha, historia ose tradita e përbashkët, si dhe prejardhja e përbashkët ose origjina gjeografike.

Rekomandimet e Politikës së Përgjithshme të KERI, të Këshillit të Evropës Nr.13 për luftën kundër antigjipsizmit dhe diskriminimit ndaj romëve, 2011: antigjipsizmi si formë specifike e racizmit, ideologji e bazuar në superioritetin racor, një formë dehumanizimi dhe racizmi institucional i ushqyer nga diskriminimi historik, i cili shprehet, ndërmjet të tjerash, nëpërmjet dhunës, gjuhës së urrejtjes, shfrytëzimit, stigmatizimit dhe formave më flagrante të diskriminimit; është një formë veçanërisht e vazhdueshme, e dhunshme, e përsëritur dhe e zakonshme e racizmit.

Raporti i Komisionerit për të Drejtat e Njeriut të Këshillit të Evropës për të drejtat e njeriut të romëve dhe udhëtarëve në Evropë”, 2012, e përkufizon “antigjipsizmin” si “shprehje specifike e anësisë, paragjytimeve dhe stereotipeve që motivojnë sjelljen e përditshme të shumë anëtarëve të grupeve të shumicës ndaj anëtarëve të komunitetit rom dhe udhëtar”.

Përkufizimi i punës i Aleancës kundër antigjipsizmit, 2016: Anticiganizmi është një kompleks i ndërtuar historikisht, i vazhdueshëm i racizmit zakonor kundër grupeve shoqërore të identifikuar nën stigmën 'cigan' ose terma të tjerë të ngjashëm dhe përfshin: 1. një perceptim dhe përshkrim homogjenizues dhe thelbësor të këtyre grupeve; 2. Një atribuim i karakteristikave specifike për to; 3. struktura shoqërore diskriminuese dhe praktikat e dhunshme që shfaqen në këtë sfond, të cilat kanë një efekt degradues dhe izolues dhe që riprodhojnë disavantazhe strukturore.

Kuadri i Bashkimit Evropian

Karta e të Drejtave Fundamentale e Bashkimit Evropian, në nenin 21.1 përfshin parimin e mosdiskriminimit, ku në mesin e bazave mbi të cilat ndalohet diskriminimi, përmenden raca, origjina etnike apo sociale, anëtarësia e një pakice nacionale.⁵⁴

Anticiganizmi si sinonim i 'diskriminimit rom' apo si referencë ndaj ndonjë shprehjeje specifike si gjuha e urrejtjes ose stereotipet negative. OSBE, FRA dhe, në veçanti, Këshilli i Evropës (KE) kanë qenë pionierë në hulumtimin e implikimeve të antigjipsizmit dhe vendosjen e këtij termi në agjendat e politikëbërësve. Rekomandimi i Komisionit Evropian kundër Racizmit dhe Intolerancës (KERI) i Këshillit të Evropës nr. 13 (2011), mbetet pikë referimi për trajtimin e antigjipsizmit në një mënyrë koherente dhe gjithëpërfshirëse.

Në vitin 2015, Parlamenti Evropian përsëriti thirrjen e tij të vitit 2005 për trajtimin e antigjipsizmit, dhe Komisioni Evropian e përdori termin në mënyrë kuptimplotë, për herë të parë në raportin e tij mbi Zbatimin e Kornizës së BE-së për Strategjitë e Integritimit Kombëtar të Romëve. Rritja e

⁵⁴Karta e të Drejtave Fundamentale e Bashkimit Evropian, miratuar në vitin 2000, OJ C 83/02, 30 mars 2010.

përdorimit institucional të termit është një zhvillim domethënës. Testi i madh për vendimmarrësit tani është të përkthej njohjen e antigjipsizmin në veprim efektiv – bazuar në një kuptim të thellë të asaj që përfshin ky fenomen. Dhe, për formulimin e një përkufizimi funksional të antigjipsizmit që pranohet gjerësisht dhe e bën konceptin të përshtatshëm për një grup më të gjerë vendimmarrësish, në mënyrë që të ndihmojë në krijimin e veprimeve efektive për luftimin e këtij fenomeni negativ.

Vitet e fundit, nocioni "antigjipsizëm" ka fituar gjithnjë e më shumë vëmendje në tërë Evropën, si në fushën politike ashtu edhe në atë shkencore.

Janë krijuar përkufizime të ndryshme (dhe plotësuese):

a) "antigjipsizmi është formë specifike e racizmit, ideologji e themeluar në superioritetin racor, një formë dehumanizimi dhe racizmi institucional i ushqyer nga diskriminimi historik, i cili shprehet ndërmjet të tjerash, nëpërmjet dhunës, gjuhës së urrejtjes, shfrytëzimit, stigmatizimit, dhe formave më flagrante të diskriminimit" (Komisioni Evropian kundër Racizmit dhe Intolerancës, 2011);

b) Këshilli i Evropës (2012) përkufizoi "antigjipsizmin" si formë specifike të racizmit, në të njëjtin nivel me antisemitizmin (...). Në vitin 2005, Komisioni Evropian kundër Racizmit dhe Intolerancës (KERI) njohu natyrën specifike të racizmit të drejtuar ndaj romëve:

1. është i vazhdueshëm, si në aspektin historik, ashtu edhe në atë gjeografik (i përhershëm dhe jo në rënie);
2. është sistematik (i pranuar nga pothuajse i gjithë komuniteti);
3. shoqërohet shpesh me akte dhune”;

c) Anticiganizmi është një kompleks i ndërtuar historikisht, racizëm i vazhdueshëm i zakonshëm kundër grupeve shoqërore të identifikuara nën stigmën 'cigan'⁵⁵ ose terma të tjerë të ngjashëm dhe përfshin:

1. perceptimin dhe përshkrimin homogjenizues dhe thelbësor të këtyre grupeve;
2. atribuirimin e karakteristikave specifike për to;
3. struktura shoqërore diskriminuese dhe praktika të e dhunshme që shfaqen në këtë sfond, të cilat kanë efekt degradues dhe izolues dhe që riprodhojnë disavantazhe strukturore (Aleanca kundër Antigjipsizmit, 2016).

Standardet kryesore ose dokumentet e politikave që i referohen antigjipsizmit në Evropë:

⁵⁵Kushtetuta e Republikës së Kosovës i njeh komunitetet rom, ashkali dhe egjiptian si kategori kushtetuese.

- Rezoluta e Parlamentit Evropian 2005 mbi situatën e romëve në Bashkimin Evropian ((2005)0151), që kërkon nga Këshilli, Komisioni, Shtetet Anëtare dhe vendet kandidatë publikisht të ndërmarrin hapa për luftimin e antigjipsizmit/romafobisë në të gjitha format, qofshin ato në nivel lokal, kombëtar, rajonal apo të BE-së.
- 2011 KERI i Këshillit të Evropës Rekomandime të Përgjithshme të Politikës Nr.13 për luftimin e antigjipsizmit dhe diskriminimit ndaj romëve
- 2013 Rekomandimi i Këshillit të BE-së për masat efektive të integritit të romëve në shtetet anëtare, dhjetor 2013 (2013/C 378/01), duke u bërë thirrje shteteve anëtare të zbatojnë masa për luftimin e diskriminimit dhe paragjykitimit ndaj romëve dhe antigjipsizmit, në të gjitha fushat e shoqërisë.
- 2015 Rezoluta e Parlamentit Evropian e 15 Prillit 2015 me rastin e Ditës Ndërkombëtare të Romëve – Antigjipsizmi në Evropë dhe njohja nga BE-ja e Ditës përkujtimore të gjenocidit ndaj romëve gjatë Luftës së Dytë Botërore (2015/2615(RSP))
- Komisioni i Parlamentit Evropian për Liritë Civile, Drejtësinë dhe Çështjet e Brendshme (raportuesja Soraya Post) raport mbi "Aspektet e të drejtave fundamentale në integrimin e romëve në BE: luftimi i antigjipsizmit" (2017/2038(INI)), duke i bërë thirrje Komisionit Evropian dhe Shteteve Anëtare të BE-së të vënë luftën kundër antigjipsizmit në krye të përpjekjeve për përfshirjen sociale dhe ekonomike të romëve.
- Dokumenti i Grupit të Nivelit të Lartë të BE-së për luftën kundër racizmit, ksenofobisë dhe formave të tjera të intolerancës me temë "Antigjipsizmi: Rritja e njohjes së tij për të kuptuar dhe adresuar më mirë manifestimet e tij" (Komisioni Evropian, 2018).
- 2018 Raporti i Agjencisë për të Drejtat Fundamentale të BE-së 2018 për shqetësimin e vazhdueshëm: antigjipsizmi si një pengesë për përfshirjen e romëve.
- 2019 Rezoluta e Parlamentit Evropian mbi nevojën për një Kornizë Strategjike të BE-së të fuqizuar pas vitit 2020 për Strategjitë Kombëtare të Integritit të Romëve dhe rritjen e luftës kundër antigjipsizmit(2019/2509(RSP)).

Direktiva e BE-së për Barazinë Racore nuk e përcakton "racën", por ia lë në dorë shteteve anëtare. Neni 1, paragrafi 1, i Konventës Ndërkombëtare për Eliminimin e të Gjitha Formave të Diskriminimit Racor (ICERD) përkufizon 'diskriminimin racor' si 'çdo dallim, përjashtim, kufizim ose preferencë që bazohet në racën, ngjyrën, prejardhjen ose origjinën kombëtare e etnike, që ka për qëllim apo për efekt të shkatërrojë ose të komprometojë njohjen, gëzimin ose ushtrimin, në kushte barazie, të të drejtave dhe të lirive të njeriut në fushat politike, ekonomike, shoqërore dhe kulturore ose në çdo fushë tjetër të jetës publike".

Komisioni Evropian kundër Racizmit dhe Intolerancës (KERI), përveç që njih "antigjipsizmin" si një formë specifike të racizmit në të njëjtin nivel me antisemitizmin, po ashtu ka nxjerrë Rekomandimin nr. 13⁵⁶ e politikave të përgjithshme të KERI për luftën kundër antigjipsizmit dhe diskriminimit kundër Romëve, të miratuar më 24 qershor 2011, që përfshin:

1. Ratifikimin e Protokollit nr. 12 të Konventës Evropiane për të Drejtat e Njeriut, si dhe të Konventës Kuadër për Mbrojtjen e Pakicave Kombëtare, nëse nuk i kanë ratifikuar ende ato;
2. Përdorimin, sipas planit kombëtar, e një qasje gjithëpërfshirëse multidisiplinare ndaj çështjeve që kanë të bëjnë me romët, duke përfshirë përfaqësuesit e tyre në konceptimin, hartimin, zbatimin dhe vlerësimin e politikave përkatëse;
3. Nxitjen e besimit të ndërsjellë ndërmjet romëve dhe organeve publike, në veçanti nëpërmjet trajnimit të ndërmjetësuesve, ndërmjet të tjerash, edhe nga komuniteti rom;
4. Luftimin e antigjipsizmit në fushën e arsimit;
5. Luftimin e antigjipsizmit në punësim;
6. Luftimin e antigjipsizmit në lidhje me strehimin dhe të drejtën për respektimin e shtëpisë së tyre
7. Luftimin e antigjipsizmit në kujdesin shëndetësor
8. Luftimin e dhunës racore dhe krimeve kundër romëve
9. Luftimin e manifestimeve anticigane që mund të shkaktohen nga policia
10. Luftimin e antigjipsizmit të shprehur në media, duke njohur parimin e pavarësisë së tyre editoriale
11. Luftimin e antigjipsizmit në lidhje me qasjen në vendet e hapura për publikun
12. Luftimin e antigjipsizmit në lidhje me qasjen në shërbimet publike
13. Luftimin e antigjipsizmit gjatë marrjes së mallrave dhe shërbimeve, veçanërisht në sektorët bankar ose të sigurisë;
14. Për matjen më të mire të problemeve, me qëllim të luftimit të tyre në mënyrë më efektive dhe për miratimin e politikave që duhet të ndërmerren, të mbledhen të dhëna statistikore për romët, veçanërisht në fushën e arsimit, punësimit, strehimit dhe shëndetësisë, duke siguruar respektimin e parimeve të konfidencialitetit, vetë-identifikimit vullnetar dhe pëlqimit të informuar;
15. Dënimi i çdo diskutim publik, i cili publikisht nxit diskriminim, urrejtje ose dhunë të drejtpërdrejtë ose të tërthortë ndaj romëve;

⁵⁶Rekomandimi i Politikës së Përgjithshme të KERI-së N°13, në dispozicion në <https://www.coe.int/en/web/european-commission-against-racism-and-intolerance/recommendation-no.13>

16. Inkurajimi i një sistemi të monitorimit të shprehjeve për antigjipsizmin në internet dhe sigurimi i ndjekjes efektive penale, në bazë të parimeve të përcaktuara në Protokollin Shtesë të Konventës për krimin kibernetik, në lidhje me penalizimin e akteve të natyrës racore dhe ksenofobike, të kryera nëpërmjet sistemeve kompjuterike dhe zbatimit e tyre;
17. në përgjithësi, për luftimin e antigjipsizmit dhe diskriminimit ndaj romëve.

3.2 Kuadri Kombëtar

3.2.1 Kushtetuta e Kosovës

Barazia⁵⁷dhe mosdiskriminimi⁵⁸ janë parimet bazë të Kushtetutës. Liria e shprehjes është e garantuar me Kushtetutë. Neni 24 i Kushtetutës përcakton se “askush nuk mund të diskriminohet në bazë të racës, ngjyrës, gjinisë, gjuhës, fesë, mendimeve politike ose të tjera, prejardhjes kombëtare a shoqërore, lidhjes me ndonjë komunitet, pronës, gjendjes ekonomike dhe sociale, orientimit seksual, lindjes, aftësisë së kufizuar ose ndonjë statusi tjetër personal.” Edhe pse identiteti gjinor nuk përmendet shprehimisht si bazë mbi të cilën ndalohet diskriminimi, ky nen përmban një listë të pafundme të bazave të diskriminimit. Për më tepër, jurisprudenca e Gjykatës Evropiane për të Drejtat e Njeriut ofron udhëzime për aplikimin e identitetit gjinor si bazë për diskriminim.

Neni 22 i Kushtetutës përcakton zbatimin e drejtpërdrejtë të një sërë konventash ndërkombëtare për të drejtat e njeriut, duke përfshirë përparësinë e dispozitave të tilla ndaj ligjeve kombëtare në rast konflikti. Kjo përfshin: (i) Konventën Evropiane për Mbrojtjen e të Drejtave dhe Lirive Themelore të Njeriut dhe Protokollet e saj (KEDNJ); (ii) Paktin Ndërkombëtar për të Drejtat Civile dhe Politike dhe Protokollet e tij (PNDCP); (iii) Konventën për Eliminimin e të Gjitha Formave të Diskriminimit Racor (KEDR), në mesin e të tjerave. Gjithashtu, neni 53 i Kushtetutës parasheh që të drejtat e dhe liritë themelore të njeriut, të garantuara me Kushtetutë duhet të jenë në përputhje me vendimet gjyqësore të Gjykatës Evropiane për të Drejtat e Njeriut. Në këtë drejtim, mbrojtjet e përcaktuara në PNDCP, KEDR, KEDNJ dhe praktikën gjyqësore të GJEDNJ-së janë të rëndësishme dhe relevante për Kosovën në kontekstin e të drejtave të grupeve të pakicave etnike.

⁵⁷Neni 3 (Barazia para ligjit) dhe neni 7 (Vlerat, i referohen barazisë), të Kushtetutës së Kosovës.

⁵⁸Neni 24 i Kushtetutës së Kosovës.

3.2.2 Legjislacioni Kundër Diskriminimit

Ligji për Mbrojtjen nga Diskriminimi⁵⁹ parasheh mbrojtje për karakteristikat e mëposhtme të mbrojtura: kombësinë, ose lidhjen me ndonjë komunitet, origjinën sociale, racën, etninë, ngjyrën, lindjen, origjinën, seksin, gjininë, identitetin gjinor, orientimin seksual, gjuhën, shtetësinë, besimin fetar dhe besimin, përkatësinë politike, mendimin politik apo mendime të tjera, gjendjen sociale ose personale, moshën, gjendjen familjare ose martesore, shtatzëninë, lehoninë, gjendjen pasurore, gjendjen shëndetësore, aftësinë e kufizuar dhe trashëgiminë gjenetike⁶⁰.

Ky ligj zbatohet për të gjitha veprimet ose mosveprimet, të të gjitha institucioneve shtetërore, të personave fizik e juridik, të sektorit publik dhe privat, të cilët shkelin, kanë shkelur ose mund të shkelin të drejtat e çdo personi apo personave fizik e juridik, në të gjitha fushat e jetës⁶¹. Llojet e trajtimit të pabarabartë specifikohen si diskriminim i drejtpërdrejtë dhe i tërthortë, diskriminim i bazuar në perceptim, diskriminim i shumëfishtë, ngacmimi, nxitja për të diskriminuar, viktimizimi, segregacioni, diskriminim në bazë të asociimit, dhe mosdhënia e një përshtatjeje/akomodimi të arsyeshëm për personat me aftësi të kufizuar⁶².

Ligji është në përputhje me Direktivën e Këshillit 2000/43/KE, të datës 29 qershor 2000, për zbatimin e parimit të trajtimit të barabartë ndërmjet personave pavarësisht prejardhjes racore apo etnike të Këshillit të Bashkimit Evropian, Direktivën e Këshillit 2000/78/KE, të datës 27 nëntor 2000 që krijon një kuadër të përgjithshëm për trajtimin e barabartë në punësim dhe profesion të Këshillit të Bashkimit Evropian, Direktivën e Këshillit 2004/113/KE, të datës 13 dhjetor 2004 Zbatimi i parimit të trajtimit të barabartë ndërmjet burrave dhe grave në qasjen dhe furnizimin e mallrave dhe shërbimeve të Këshillit të Bashkimit Evropian, si dhe Direktivën 2006/54/KE të Parlamentit Evropian dhe Këshillit, të datës 5 korrik 2006, mbi zbatimin e parimit të mundësive të barabarta dhe trajtimit të barabartë të burrave dhe grave në fushën e punësimit dhe të profesionit (e amendamentuar) të Parlamentit Evropian dhe Këshillit të Bashkimit Evropian.

⁵⁹Ligji Nr 05/L-021

⁶⁰Neni 1, Ligji për Mbrojtjen nga Diskriminimi

⁶¹Po aty

⁶²Neni 4(1), Ligji për Mbrojtjen nga Diskriminimi

Shembull rasti

Në vitin 2012 është raportuar një rast i segregacionit të fëmijëve romë, ashkali dhe egjiptianë në shkollën fillore "Mustafa Bakija" në komunën e Gjakovës. Në këtë drejtim, Qendra Evropiane për Çështje të Pakicave (ECMI) në bashkëpunim me Qendrën për Ndihmë Juridike dhe Zhvillim Rajonal (CLARD), në kuadër të projektit "Rritja e ndikimit pozitiv të ligjit për grupet e cenueshme dhe të marginalizuara (VMG) në Kosovë" (mbështetur nga BE), më 16 janar 2013, ka paraqitur padi në Gjykatën Themelore të Gjakovës kundër Drejtorisë Komunale të Arsimit në Komunën e Gjakovës, në emër të tetë prindërve të prekur të fëmijëve romë, ashkali dhe egjiptianë. Padia përfshinte një rekomandim për shpërbërjen e klasës së segreguar, për transferimin e nxënësve të prekur në klasa multietnike dhe për ofrimin e kompensimit për dëme jomateriale, për shkak të shkeljes së të drejtave të njeriut.

3.2.3 Kodi Penal

Kodi penal i Kosovës sanksionon përdorimin e gjuhës për nxitje të urrejtjes. Kodi Penal i cili mbulon periudhën deri më 14 prill 2019⁶³ në nenin 147 parasheh se kushdo që nxit ose përhap urrejtje, përçarje ose mosdurim midis grupeve kombëtare, racore, fetare, etnike apo grupeve të tjera të tilla që jetojnë në Republikën e Kosovës, në mënyrë e cila mund të prishë rendin publik, dënohet me gjobë ose me burgim deri në 5 vjet. Pesha e dënimit për një vepër penale të tillë rritet në rastet kur vepra kryhet:

- në mënyrë sistematike ose nga personi duke keqpërdoruri pozitën apo autorizimet e tij (dënohet me burgim prej 1 deri në 8 vjet);
- përmes shtrëngimit, rrezikimit të sigurisë, përqeshjes së simboleve kombëtare, racore, etnike apo fetare, duke dëmtuar pasurinë e personit tjetër ose duke përdhosur monumentet (dënohet me burgim prej 1 deri në 8 vjet); dhe
- në mënyrë sistematike ose duke keqpërdorur pozitën apo autorizimet e tij, ose shkakton trazira, dhunë ose pasoja të tjera të rënda (dënohet me burgim prej 2-10 vjet).

Kodi Penal parashihte rrethana rënduese për t'u marrë parasysh nga gjykatat. Ato përfshinin përkatësinë etnike ose kombëtare, kombësinë, gjuhën, besimin fetar ose mungesën e besimit fetar, ngjyrën, gjininë, orientimin seksual ose afërsinë me personat me karakteristikat e lartpërmendura⁶⁴. Të njëjtat rrethana rënduese përfshihen edhe në lidhje me shkatërrimin ose dëmtimin e pasurisë⁶⁵.

⁶³Kodi Nr. 04/L-082

⁶⁴Neni 74 (2), Kodi Penal i Kosovës

⁶⁵Neni 333(4), Po aty

Kodi Penal i Kosovës i ndryshuar (prill 2019) ⁶⁶ofron mbrojtje më të madhe në lidhje me gjuhën e urrejtjes dhe krimet e urrejtjes. Neni 141 për nxitje të përçarjes dhe mosdurimit përfshin orientimin seksual dhe identitetin gjinor si baza të qarta të mbrojtura, ndërkohë që përcakton karakteristika të tjera personale si mundësi ose baza të tjera të paspecifikuara. Shkalla e dënimit për vepra penale të tilla mbetet e njëjtë si në Kodin Penal të mëparshëm - deri në 5 vjet burgim. Dënimi në varësi të peshës së veprave penale sipas këtij neni mbetet i njëjtë si në Kodin Penal të mëparshëm.

Rrethanat rënduese, të ngjashme me Kodin Penal të mëparshëm, me shtimin e identitetit gjinor, janë përshkruar në një sërë nene që korrespondojnë me vepra penale të ndryshme si vrasje e rëndë⁶⁷, sulm⁶⁸, lëndim i lehtë trupor⁶⁹, lëndim i rëndë trupor⁷⁰, shkatërrim ose dëmtim i pasurisë⁷¹.

Shkelja e statusit të barabartë të shtetasve dhe banorëve është penalizuar edhe me Kodin Penal aktual⁷². Mohimi ose kufizimi i të drejtave të përcaktuara me Kushtetutë, ose me marrëveshje të ratifikuara ndërkombëtare, dënohet me burgim deri në 3 vjet. Kufizimi i të drejtës së shprehjes së lirë të pjesëtarit të një bashkësie etnike, fetare ose gjuhësore, dhe mohimi i përdorimit të gjuhës dhe shkrimit të tij, dënohet me burgim deri në 1 vit. Pësha e dënimit rritet kur veprat penale kryhen nga persona zyrtar me keqpërdorim të pozitës ose autorizimeve të tij.

4. Gjykata Evropiane e të Drejtave të Njeriut (GJEDNJ)

4.1 Historiku

Gjykata Evropiane e të Drejtave të Njeriut (GJEDNJ) është organ gjyqësor rajonal për të drejtat e njeriut, me seli në Strasburg, Francë, i themeluar nën kujdesin e Këshillit të Evropës.⁷³ Gjykata filloi punën e saj në vitin 1959 dhe ka nxjerrë më shumë se 10,000 aktgjykime në lidhje me shkeljet e pretenduara të Konventës Evropiane për të Drejtat e Njeriut.

⁶⁶Kodi Nr. 06/L-074

⁶⁷Neni 173 (1.10) Kodi Penal i Kosovës, Nr. 06/L-074.

⁶⁸Neni 184 (3), Po aty.

⁶⁹Neni 185 (3), Po aty.

⁷⁰Neni 186 (4), Po aty.

⁷¹Neni 321 (4), Po aty.

⁷²Neni 190, Po aty.

⁷³ Këshilli i Evropës është një organizatë ndërkombëtare e themeluar në vazhden e Luftës së Dytë Botërore për mbështetjen e të drejtave të njeriut, demokracisë dhe sundimin e ligjit në Evropë. E themeluar në vitin 1949, ajo ka 46 shtete anëtare, 27 prej të cilave janë anëtarë të Bashkimit Evropian. Siç thuhet në Statut, "qëllimi i Këshillit të Evropës është të arrijë një unitet më të madh ndërmjet anëtarëve të tij me qëllim të ruajtjes dhe realizimit të idealeve dhe parimeve që janë trashëgimia e tyre e përbashkët, si dhe lehtësimi i përparimit të tyre ekonomik dhe social.

Në vitin 1998, sistemi evropian i të drejtave të njeriut u reformua për të eliminuar Komisionin Evropian për të Drejtat e Njeriut, i cili më kishte vendosur për pranueshmërinë e ankesave, kishte mbikëqyrur zgjidhjet miqësore dhe kishte referuar disa raste në gjykatë - në një mënyrë të ngjashme me sistemin aktual ndër-amerikan.⁷⁴ Tani, viktimat individuale mund t'i paraqesin ankesat e tyre drejtpërdrejt në Gjykatën Evropiane të të Drejtave të Njeriut.

Gjykata Evropiane, ose "Gjykata e Strasburgut" siç quhet shpesh, shërben një rol plotësues me atë të Komitetit Evropian të të Drejtave Sociale⁷⁵, i cili mbikëqyr respektimin e të drejtave sociale dhe ekonomike nga shtetet evropiane.

4.2 Juridiksioni

Gjykata ka juridiksion për të vendosur për ankesat ("kërkesat") të paraqitura nga individë dhe shtete në lidhje me shkeljet e Konventës për Mbrojtjen e të Drejtave dhe Lirive Themelore të Njeriut (e quajtur zakonisht "Konventa Evropiane për të Drejtat e Njeriut"⁷⁶), të cilat kryesisht kanë të bëjnë me të drejtat civile dhe politike. Ajo nuk mund të marrë një çështje me iniciativën e saj. Në veçanti, personi, grupi ose organizata joqeveritare që paraqet ankesën ("parashtruesi i kërkesës") nuk duhet të jetë shtetas i një Shteti Anëtar.

Megjithatë, ankesat e paraqitura në Gjykatë duhet të kenë të bëjnë me shkeljet e Konventës që pretendohet se janë kryer nga një shtet palë⁷⁷ i Konventës që kanë prekur drejtpërdrejt dhe në mënyrë të konsiderueshme kërkuesen. Që nga nëntori 2018, janë 47 shtete palë të Konventës; këtu përfshihen shtetet anëtare të Këshillit të Evropës dhe të Bashkimit Evropian. Disa nga këto shtete kanë ratifikuar gjithashtu një ose më shumë nga Protokollat Shtesë të Konventës, të cilat mbrojnë të drejta shtesë.

Nga 1 gushti 2018, Gjykata ka edhe juridiksion këshillimor. Sipas Protokollit 16⁷⁸ të Konventës Evropiane, e cila ka hyrë në fuqi më 1 gusht, gjykatat më të larta vendase në shtetet nënshkruese të Protokollit mund të kërkojnë mendime këshillimore nga Gjykata Evropiane për çështjet e interpretimit të Konventës Evropiane dhe protokolleve të saj. Pyetjet duhet të dalin nga çështjet që janë në pritje përpara gjykatës vendase. [IJRC]⁷⁹

⁷⁴ Sistemi Ndër-Amerikan për mbrojtjen e të drejtave të njeriut është një sistem rajonal i të drejtave të njeriut dhe është përgjegjës për monitorimin, promovimin dhe mbrojtjen e të drejtave të njeriut në 35 vendet e pavarura të Amerikës që janë anëtarë të Organizatës së Shteteve Amerikane (OAS). <https://ijrcenter.org/regional/inter-american-system/>

⁷⁵ Komiteti Evropian i të Drejtave Sociale (më parë, Komiteti i Ekspertëve të Pavarur për Kartën Sociale Evropiane) është një organ rajonal i të drejtave të njeriut që mbikëqyr mbrojtjen e të drejtave të caktuara ekonomike dhe sociale në pjesën më të madhe të Evropës. Komiteti Evropian i të Drejtave Sociale u krijua nën kujdesin e Këshillit të Evropës, në përputhje me nenet 24 dhe 25 të Kartës Sociale Evropiane të vitit 1961. Komiteti monitoron zbatimin e Kartës së vitit 1961, Protokollit Shtesë të 1988-ës dhe Kartës Sociale Evropiane të Rishikuar të vitit 1996. Ai është unik midis mekanizmave rajonalë të të drejtave të njeriut për mekanizmin e tij të ankesave kolektive (në krahasim me ato individuale) dhe fleksibilitetin që u lejon shteteve të vendosin se cilat dispozita të Kartës të pranojnë. <https://ijrcenter.org/european-committee-of-social-rights-3/>

⁷⁶ https://www.echr.coe.int/Pages/home.aspx?p=basictexts&c=#n1359128122487_pointer

⁷⁷ <https://www.coe.int/en/web/conventions/full-list?module=signatures-by-treaty&treatynum=005>

⁷⁸ https://www.echr.coe.int/Documents/Protocol_16_ENG.pdf

⁷⁹ <https://ijrcenter.org/2018/04/24/european-court-of-human-rights-to-implement-advisory-jurisdiction/#gsc.tab=0>

4.3 Struktura

Për trajtimin e shumë çështjeve në të njëjtën kohë, GJEDNJ-ja është e organizuar në pesë seksione, ose organe administrative, secila prej të cilave ka një dhomë gjyqësore. Çdo seksion ka një kryetar, një nënkryetar dhe një numër të caktuar gjyqtarësh. Asambleja Parlamentare e Këshillit të Evropës zgjedh 47 gjyqtarët⁸⁰ e Gjykatës në bazë të një listë të kandidatëve që propozohen nga Shtetet Anëtare.

Brenda Gjykatës, gjyqtarët punojnë në katër lloje të ndryshme grupesh, ose “formacionesh gjyqësore”. Kërkesat e pranuar nga Gjykata do të caktohen në një nga këto formacione:

1. Gjyqtar i vetëm: vendos vetëm për pranueshmërinë e kërkesave që janë qartazi të papranueshme bazuar në materialin e paraqitur nga parashtruesi i kërkesës.
2. Komiteti: i përbërë nga 3 gjyqtarë, komiteti vendos për pranueshmërinë e çështjes si dhe për themelin e çështjes, kur rasti ka të bëjë me një çështje të mbuluar nga praktika e unifikuar gjyqësore (vendimi duhet të jetë unanim).
3. Dhoma: e përbërë nga 7 gjyqtarë, dhomat kryesisht vendosin për pranueshmërinë dhe bazueshmërinë e rasteve që ngritin çështje për të cilat nuk është vendosur në mënyrë të përsëritur (vendimi mund të merret nga shumica). Çdo dhomë përfshin Kryetarin e Seksionit dhe “Gjyqtarin kombëtar” (gjyqtarin me shtetësi të vendit ndaj të cilit është paraqitur kërkesa).
4. Dhoma e Madhe: e përbërë nga 17 gjyqtarë, Dhoma e Madhe shqyrton një numër të vogël, të përzgjedhur çështjesh, që ose i janë referuar asaj (sipas ankesës ndaj vendimit të Dhomës) ose prej të cilave Dhoma ka hequr dorë, zakonisht kur rasti ka të bëjë me një çështje të rëndësishme ose të re. Kërkesat nuk drejtohen kurrë drejtpërdrejt në Dhomën e Madhe. Dhoma e Madhe përfshin gjithmonë kryetarin dhe nënkryetarin e Gjykatës, pesë kryetarët e seksioneve dhe gjyqtarin kombëtar.

4.4 Paraqitja e ankesës

Kërkesat në Gjykatën Evropiane të të Drejtave të Njeriut duhet të jenë në përputhje me kërkesat e përshkruara në nenin 47 të Rregullores së Punës të Gjykatës⁸¹. Ankesat duhet të kenë parasysh se Gjykata herë pas herë ndryshon rregullat dhe procedurat e saj; Në vitin 2014, ajo filloi të aplikoj kushte më të rrepta⁸² për ankesat individuale kërkesat për ankesa individuale.

⁸⁰ <https://ijrcenter.org/wp-content/uploads/2020/07/ECtHR-EC-mini-guidefinal-1.pdf>

⁸¹ https://www.echr.coe.int/Documents/Rules_Court_ENG.pdf

⁸² <https://ijrcenter.org/2013/12/16/european-court-of-human-rights-to-begin-implementing-strict-requirements-for-individual-applications-in-2014/>

Për paraqitjen e ankesës, ankuesit duhet të përdorin formularin e kërkesës, i cili është në dispozicion në internet dhe duhet të plotësohet në tërësi⁸³. Kërkesa duhet të shoqërohet me kopje të të gjitha dokumenteve përkatëse, të cilat duhet të dorëzohen me postë.

Një shumicë e konsiderueshme e ankesave të paraqitura në Gjykatë fshihen nga lista ose shpallen të papranueshme, sepse nuk plotësojnë një ose më shumë nga kriteret e pranueshmërisë⁸⁴. Gjykata mund të vendos të mos shqyrtojë një ankesë⁸⁵ që nuk i plotëson të gjitha kushtet⁸⁶.

4.5 Procedurat para Gjykatës

Procedurat para Gjykatës zhvillohen kryesisht me shkrim; seancat publike janë të rralla. Nuk ka asnjë kosto që lidhet me paraqitjen e një ankese, dhe ankuesi (kërkuesi) mund të aplikojë për ndihmë juridike për të mbuluar shpenzimet që lindin më vonë gjatë procedurës.

Përderisa avokati nuk është i domosdoshëm për të paraqitur një ankesë, kërkuesit duhet të kenë përfaqësues pasi që çështja të jetë shpallur e pranueshme, si dhe duhet të përfaqësohen nga avokati në çdo seancë dëgjimore përpara Gjykatës.

Ankesat (kërkesat) në GJEDNJ kalojnë në dy faza: faza e pranueshmërisë dhe faza e bazueshmërisë (themelit të çështjes). Natyra specifike e çështjes do të diktojë shpejtësinë dhe rrjedhën e procedurës. Megjithatë, mund të kalojnë muaj ose vite përpara se kërkuesi të marrë një vendim ose aktgjykim.

4.6 Pranueshmëria

Kur Gjykata pranon një ankesë, Gjykata duhet të përcaktojë nëse ajo i plotëson të gjitha kushtet e pranueshmërisë. Vendimi për pranueshmërinë mund të merret nga gjyqtari i vetëm, nga komiteti prej tre gjyqtarësh ose nga dhoma prej shtatë gjyqtarësh. Në mënyrë që kërkesa të shpallet e pranueshme, duhet të plotësojë kriteret e mëposhtme:

1. Shterimi i mjeteve juridike vendase
2. Afati 4-mujor i aplikimit (pas vendimit përfundimtar të gjyqësorit vendor)
3. Ankesa të jetë kundër një shteti palë të Konventës Evropiane për të Drejtat e Njeriut
4. Kërkuesi duhet të ketë pësuar një dëm të konsiderueshëm.

Nëse kërkesa nuk i plotëson njërin nga këto kushtet, ajo do të shpallet e papranueshme dhe nuk do të merret në shqyrtim. Ndaj vendimit për papranueshmërinë nuk lejohet ankesa. Kërkuesit mund të përdorin listën kontrolluese të pranueshmërisë në faqen e internetit të GJEDNJ-së për të përcaktuar nëse kërkesa e tyre i plotëson kushtet⁸⁷.

⁸³ <https://www.echr.coe.int/Pages/home.aspx?p=applicants/forms&c=>

⁸⁴ https://www.echr.coe.int/Documents/Application_Notes_ENG.pdf

⁸⁵ https://www.echr.coe.int/Documents/Your_Application_ENG.pdf

⁸⁶Shënimet për plotësimin e formularit të kërkesës, dhe Kërkesa juaj në GJEDNJ duhet të lexohen me kujdes përpara se të filloni me paraqitjen e kërkesës

4.7 Themeli i çështjes

Nëse ankesa nuk largohet nga lista ose shpallet e papranueshme në një fazë të hershme, ajo do të caktohet njërit nga pesë seksionet e GJEDNJ-së dhe shteti do të njoftohet në lidhje me ankesën. Në këtë pikë, të dyja palët do të kenë mundësinë të paraqesin vërejtjet në Gjykatë. Këto vëzhgime mund të përmbajnë informacion specifik të kërkuar nga Dhoma ose Kryetari i Seksionit, ose çdo material tjetër që palët përcaktojnë si të rëndësishëm. Dhoma ka mundësinë të shqyrtojë pranueshmërinë dhe themelin e çështjes veçmas ose njëkohësisht, por ajo duhet të njoftojë palët nëse planifikon të shqyrtojë pranueshmërinë dhe themelin e çështjes së bashku.

Kur Dhoma nxjerr aktgjykimin për themelin e çështjes, vendimi bëhet i formës së prerë pas kalimit të periudhës prej tre muajve. Gjatë kësaj periudhe, njëra ose të dyja palët mund të kërkojnë që kërkesa t'i referohet Dhomës së Madhe. Megjithatë, Dhoma e Madhe shqyrton vetëm një numër të kufizuar rastesh të jashtëzakonshme.

Nëse Gjykata e vendos përfundimisht çështjen në favor të kërkuarit, ajo mund të vendos për një kompensim të drejtë (kompensim monetar për dëmin e pësuar) dhe të kërkojë nga shteti të mbulojë shpenzimet e ngritjes së çështjes. Nëse Gjykata konstaton se nuk ka pasur shkelje, atëherë kërkuari nuk mban përgjegjësi për shpenzimet ligjore të shtetit.

Komiteti i Ministrave i Këshillit të Evropës është përgjegjës për zbatimin e vendimeve të Gjykatës. Vendimet e Gjykatës janë të detyrueshme për shtetet, dhe duhet t'i zbatojnë ato në përputhje me rrethanat. Shpesh kjo nënkupton ndryshimin e legjislacionit për të siguruar që shkelja të mos përsëritet. Megjithatë, Gjykata nuk ka kompetencë të anulojë një vendim kombëtar ose të anulojë ligjet kombëtare.

Shembull rasti

Në M'Bala M'Bala kundër Francës, kërkuari ishte një komedian, i dënuar për shprehje të pikëpamjeve negative dhe antisemitike gjatë shfaqjeve të tij live. Ai pretendoi se ky dënim cenonte lirinë e tij të shprehjes. GJEDNJ konstatoi se shprehja e urrejtjes dhe antisemitizmit, si dhe përkrahja e mohimit të Holokaustit nuk bëjnë pjesë në mbrojtjen nga neni 10 i KEDNJ-së. Gjykata gjithashtu konstatoi se kërkuari "është përpjekur ta largojë nenin 10 nga propozimi i tij real, duke përdorur të drejtën e tij të lirisë së shprehjes për qëllime që janë në kundërshtim me frymën e Konventës dhe të cilat, nëse pranoheshin, do të kontribuonin në shkeljen e të drejtave dhe lirive të Konventës". Ankesa e tij u shpall e papranueshme.

4.8 Zgjidhje miqësore

Përpara se të marrë një vendim mbi themelin e çështjes, Gjykata do të përpiqet që të nxit palët të arrijnë marrëveshje për zgjidhje miqësore. Në rast se nuk arrihet marrëveshja për zgjidhje miqësore, Gjykata më pas nxjerr aktgjykim për themelin e çështjes. Në rastet kur Dhoma vendos të nxjerrë një vendim për pranueshmërinë lidhje me aktgjykimin për themelin e çështjes, palët

mund të përfshijnë informata rreth marrëveshjeve miqësore në shqyrtim që i parashtrojnë para Gjykatës.

4.9 Masat e përkohshme

Në raste të jashtëzakonshme, Gjykata mund t'u japë kërkuarve "masa të përkohshme 88", të cilat janë krijuar për të mbrojtur kërkuarët nga dëmtimi i mëtejshëm, ndërkohë që Gjykata vazhdon shqyrtimin e çështjes. Kërkesat për masa të përkohshme pranohen vetëm kur ekziston një rrezik i afërt për një dëm të pariparueshëm si, për shembull, vdekja ose tortura. Ato jepen më shpesh në rastet e ekstradimit dhe dëbimit.

5. Jurisprudenca dhe praktika gjyqësore e GJEDNJ-së

5.1 Të drejtat e njeriut dhe personat me aftësi të kufizuara

Fushat kryesore të jurisprudencës së GJEDNJ-së janë:

- E drejta për jetën
- Ndalimi i torturës, trajtimit çnjerëzor e poshtërues
- Heqja e lirisë për shkak të dëmtimit mendor
- E drejta për respektimin e jetës private dhe familjare
- Kufizimet në aftësinë për të vepruar dhe të drejtën për një gjykim të drejtë
- E drejta e votës
- Përfitimet për shkak të aftësisë së kufizuar dhe të drejtat pronësore

Në mesin e traktateve për të drejtat e njeriut, Konventa Evropiane për të Drejtat e Njeriut (KEDNJ) ka një vend të veçantë në sistemin ligjor të Kosovës dhe, për rrjedhojë, standardet e vendosura dhe interpretimet e GJEDN-së janë shumë të rëndësishme për aktorët e sistemit që mbrojnë të drejtat e personave me aftësi të kufizuara, sipas fushës së tyre të kompetencës. Vendimet e GJEDNJ-së janë drejtpërdrejt të zbatueshme dhe iu referohen vazhdimisht Gjykata Kushtetuese, Gjykata Supreme dhe gjykatat e niveleve të tjera të sistemit gjyqësor të Kosovës për shkak të nenit 22/2 të Kushtetutës, dispozitat e Konventës Evropiane dhe Jurisprudenca e Gjykatës së Strasburgut krijojnë një standard minimal ose një bazë krahasuese për standardet ligjore që Kosova duhet të garantojë në ligj dhe në praktikë në fushën e të drejtave dhe lirive themelore

⁸⁸ https://www.echr.coe.int/Documents/PD_interim_measures_ENG.pdf

për të gjithë individët nën juridiksionin e saj. Sipas kësaj dispozite kushtetuese KEDNJ paraqet një kategori kushtetuese.

Megjithatë, KEDNJ-ja nuk parasheh mbrojtje të veçantë për personat me aftësi të kufizuara. Këto standarde janë zhvilluar nga Gjykata, në bazë të kërkesave të paraqitura për shkelje të të drejtave të njeriut të mbrojtura nga Konventa.

Nga ana tjetër, KDPAK është instrument universal ndërkombëtar dhe *lex specialis*⁸⁹ për të drejtat e personave me aftësi të kufizuara. Vihet re se, që prej hyrjes në fuqi e KDPAK-së, në maj të vitit 2008, GJEDNJ-ja i referohet, në disa raste (shih më poshtë) drejtpërsëdrejti, normave të saj në çështje që përfshijnë persona me aftësi të kufizuara, duke qartësuar kështu se standardet e saj në këtë fushë do të zhvillohen paralelisht dhe do të mbajnë parasysht tendencat më të fundit për mbrojtjen e të drejtave të këtyre njerëzve. Në të njëjtën frymë, sugjerohet që edhe profesionistët e fushës së personave me aftësi të kufizuara, të përditësohen dhe mbajnë parasysht normat e KDPAK-së dhe interpretimet e këtyre normave nga Komiteti për të Drejtat e Personave me Aftësi të Kufizuara⁹⁰.

Pasi që Kosova nuk është ende shtet anëtar i Këshillit të Evropës, nuk ka çështje konkrete për të cilat Gjykata ka vendosur kundër Kosovës. Megjithatë, do të sjellim në diskutim të gjitha rastet përkatëse, madje edhe disa aktgjykime kundër Shqipërisë (*çështjet Dybeku, Grori, Dauti dhe Strazimiri*), kryesisht në kuadër të ndalimit të trajtimit çnjerëzor dhe poshtërujes të personave me aftësi të kufizuara, të cilët vuajnë një dënim penal; dhe në kuadër të procesit të rregullt gjyqësor⁹¹.

Duke marrë parasysht se Kosova ka aplikuar për anëtarësim në Këshillin e Evropës, si dhe rëndësinë e Konventës Evropiane në sistemin kushtetues dhe ligjor vendor, është shumë e rëndësishme të kontribuohet në mbështetjen dhe fuqizimin e ekspertizës profesionale për të drejtat e personave me aftësi të kufizuara, sidomos duke pasur parasysht se zhvillimet e jurisprudencës janë mjaft dinamike, është një domosdoshmëri për përmbushjen e detyrimeve përkatëse kushtetuese⁹².

⁸⁹ Interpretimi ligjor.

⁹⁰ Komiteti përbëhet nga ekspertë të pavarur dhe ka për detyrë të mbikëqyrë përmbushjen e detyrimeve të KDPAK-së nga Shtetet Palë dhe në të njëjtën kohë të interpretojë dispozitat e tij nëpërmjet Komenteve të Përgjithshme. Për më shumë shihni <http://www.ohchr.org/EN/HRBodies/CRPD/Pages/CRPDIndex.aspx>

⁹¹ Shihni më poshtë rastet Grori, Dybeku, Dauti dhe Strazimiri.

⁹² Shih nenin 13 të KDPAK-së

Të drejtat e personave me aftësi të kufizuara, që trajtohen në këtë përmbledhje, përfshijnë, ndër të tjera, të drejtën për jetën, ndalimin e torturës dhe trajtimit çnjerëzor e poshtërues; të drejtën për sigurinë personale dhe lirinë; të drejtën për një proces të rregullt gjyqësor dhe përdorimin e gjykatës, të drejtën për jetë private e familjare; ndalimin e diskriminimit; të drejtën e votës; të drejtën e pronës, etj.

5.2 Praktika gjyqësore e GJEDNJ-së

5.2.1 E drejta për jetën

Detyrimi për të mbrojtur jetën duhet të interpretohet si i vlefshëm në kontekstin e të gjitha aktiviteteve, publike apo private, që mund të rrezikojnë të drejtën e jetës. Kjo vlen edhe për autoritetet, në fushën e arsimit shkollor, të cilët marrin përsipër detyrimin për të mbrojtur shëndetin dhe mirëqenien e nxënësve, veçanërisht të fëmijëve të vegjël, të cilët janë veçanërisht të brishtë dhe nën kontrollin ekskluziv të autoriteteve⁹³.

Praktika gjyqësore Shembulli 1: *Nencheva dhe të tjerët kundër Bullgarisë* 18 qershor 2013⁹⁴

Pesëmbëdhjetë fëmijë dhe të rinj nën moshën 22 vjeçare humbën jetën gjatë dimrit të viteve 1996/97 në një shtëpi përkujdesje shtetërore për fëmijë me probleme të rënda të shëndetit mendor,⁹⁵ në Dzhurkovo të Bullgarisë.

Gjykata e konsideroi këtë çështje si të jashtëzakonshme dhe tragjike dhe nuk pranoi se rruga e vetme në dispozicion të kërkuesve – procesi civil – ishte e mjaftueshme për përmbushjen e detyrimeve shtetërore, në bazë të nenit 2 të Konventës, për respektimin e të drejtës së jetës. Gjykata vlerësoi se shteti nuk kish arritur të përmbushte detyrimin e tij për mbrojtjen e jetës së fëmijëve të cenueshëm, , nën përgjegjësinë e tij dhe se nuk kishte përmbushur detyrimin e tij për të hedhur dritë mbi faktet, përmes një mekanizmi të përshtatshëm procedural.

⁹³ *Ilbeyi Kemaloğlu dhe Meriye Kemaloğlu kundër Turqisë*, nr. 19986/06, par. 35, 10 prill 2012.

⁹⁴ *Nencheva dhe të tjerët kundër Bullgarisë*, 18.06.2013, Nr. 48609/06.

⁹⁵ Në këtë punim do të përdoren termat “persona me probleme ose çrregullime të shëndetit mendor”, ose “aftësi e kufizuar mendore”. Vetë GJEDNJ-ja nuk ka përdorur një terminologji të unifikuar. Ndërkohë, terminologjia e përdorur në versionin shqip të KPDAK-ut është “aftësi e kufizuar mendore”. Ligji për shëndetin mendor, Nr. 44/2012, në nenin 3/2 “përkufizimet”, përdor termin çrregullime të shëndetit mendor.

Standardet themelore të Gjykatës për të drejtën e jetës sipas nenit 2 (përfshi jetën e personave me aftësi të kufizuara) janë:

- Neni 2 u vendos Shteteve detyrimin që jo vetëm të përmbahen nga shkaktimi i vdekjes me "dashje", por edhe të marrin masat e nevojshme për mbrojtjen e jetës së personave nën juridiksionin e tyre⁹⁶.
- Detyrimi i Shtetit për të mbrojtur jetën përfshin edhe detyrimin për të garantuar shërbimin e ndihmës së shpejtë, kur autoritetet informohen se jeta apo shëndeti i një personi është në rrezik për shkak të një aksidenti⁹⁷.
- Shteti ka detyrimin pozitiv për marrjen e masave parandaluese praktike për të mbrojtur një individ ndaj një tjetri, ose në disa rrethana të veçanta, nga vetvetja. Duke qenë se ky është një detyrim pozitiv, duhet të provohet se autoritetet kanë pasur dijeni ose duhej të kishin pasur dijeni në momentin që individi ishte kërcënuar në mënyrë reale dhe të menjëhershme për jetën e tij dhe se, në kuadër të kompetencave të tyre, ata nuk kanë marrë masat, që nga një pikëpamje racionale, do ta kishin shmangur pa dyshim këtë rrezik⁹⁸.
- Në rastin e humbjes së jetëve njerëzore në rrethana në të cilat autoritetet shtetërore mbajnë përgjegjësi, shteti ka detyrimin që të garantojë, përmes të gjitha mjeteve që ka në dispozicion, gjyqësore e të tjera, duke bërë të mundur që kuadri legjislativ e administrativ i hartuar për të mbrojtur të drejtën e jetës, të zbatohet siç duhet dhe duke garantuar dhënien fund dhe ndëshkimin e të gjitha shkeljeve të kësaj të drejte⁹⁹.
- Një sistem gjyqësor efikas, si ai që kërkon neni 2, mund të përfshijë dhe, në disa rrethana, duhet të përfshijë, një mekanizëm penal.
- Nëse cenimi i të drejtës së jetës ose të integritetit fizik nuk është i qëllimshëm, detyrimi pozitiv për vendosjen e një sistemi gjyqësor efikas, sipas nenit 2, nuk kërkon domosdoshmëri në të gjithë rastet një mjet të natyrës penale. Në kontekstin specifik të neglizhencës mjekësore « një detyrim i tillë mund të përmbushet edhe kur sistemi gjyqësor u ofron të interesuarve një mjet para gjykatave civile, më vete, ose bashkërisht me një mjet përpara gjykatave penale, me synimin që të përcaktohet përgjegjësia e mjekëve për çështjen dhe, nëse është rasti, të sigurohet zbatimi i të gjitha sanksioneve

⁹⁶ *McCann dhe të Tjerët*, par. 147, *L.C.B. k. Mbretërisë së Bashkuar*, 9 qershor 1998, par. 36, Përmbledhje 1998III, *Calvelli dhe Ciglio k. Italisë* [DHOMA E MADHE], nr. 32967/96, par. 48, GJEDNJ, 2002I, *Vo k. Francës* [DHOMA E MADHE], nr. 53924/00, par. 88, GJEDNJ, 2004VIII, dhe *Dodov k. Bullgarisë*, nr. 59548/00, par. 79, 17 janar 2008.

⁹⁷ *Furdik k. Sllovakia*, nr. 42994/05, 2 dhjetor 2008.

⁹⁸ *Nancheva*, par. 108.

⁹⁹ *Nancheva*, par. 109.

civile të përshtatshme, si dëmspërblimi dhe botimi i vendimit. Mund të parashikohen edhe masa disiplinore¹⁰⁰.

- Në fushën e shëndetit publik, Shteti duhet të vendosë një kuadër rregullues për spitalet, qoftë publike apo private, që të marrin masa për të siguruar mbrojtjen e jetës së të sëmurëve.
- Shtetet duhet të vendosin njëkohësisht një sistem gjyqësor efikas dhe të pavarur, i cili të jetë në gjendje të përcaktojë shkaqet e vdekjes së një individi, që ndodhet nën përgjegjësinë e personelit mjekësor.
- Neni 2 përmban detyrimin e kryerjes së një hetimi zyrtar nga autoritetet në lëmin e veprimtarive të rrezikshme, nëse vdekja ka ndodhur pas ngjarjeve që kanë qenë nën përgjegjësinë e pushtetit publik¹⁰¹.

Shtetet nuk duhet, në asnjë rast, të lënë pa dënuar sulmet e pajustificuara ndaj të drejtës së jetës për të gjithë individët nën juridiksionin e tyre, përfshi personat me aftësi të kufizuara. Kjo është e nevojshme për të ruajtur besimin e publikut, për të siguruar respektimin e shtetit të së drejtës, si dhe për të parandaluar shfaqjen e tolerancës ndaj akteve të paligjshme apo bashkëpunimin në kryerjen e tyre.

5.2.2 E drejta për të mos iu nënshtuar torturës, trajtimit çnjerëzor ose poshtëruës

Keqtrajtimet nga persona privatë

A mban përgjegjësi shteti, nëse një person me aftësi të kufizuara keqtrajtohet nga persona privatë, qofshin këta edhe fëmijë?

Praktika gjyqësore Shembulli 2: Dordević kundër Kroacisë, 24 korrik 2012.

Gjykata Evropiane për të Drejtat e Njeriut publikoi aktgjykimin e saj në çështjen Dordević kundër Kroacisë (Kërkesa nr. 41526/10), në lidhje me keqtrajtimin dhe ngacmimin e vazhdueshëm prej vitesh nga një grup të rinjsh ndaj një burri me aftësi të kufizuara (Dalibor Dordević) dhe nënës së tij (Radmila Dordević) të cilët jetojnë në Zagreb. Gjykata Evropiane për të Drejtat e Njeriut gjeti se ka shkelje të nenit 3 (ndalimi i trajtimit çnjerëzor dhe poshtëruës), 8 (e drejta për jetën private dhe familjare) dhe 13 (e drejta për një mjet efektiv juridik) për shkak të dështimit të autoriteteve të veprojnë në mënyrë efektive me qëllim që ti japin fund abuzimit.

¹⁰⁰ *Nancheva*, 110; *Calvelli dhe Ciglio*, par. 51.

¹⁰¹ *Nancheva* par. 112.

Gjykata e ka trajtuar këtë pyetje në çështjen Dordević k. Kroacisë dhe është shprehur se, në kuadër të nenit 3, shteti duhet të mbajë përgjegjësi për keqtrajtimin e individëve nga subjektet jo shtetërore. Ky detyrim rrjedh nga neni 1 i Konventës, sipas të cilit Shtetet kanë për detyrë që t'i garantojnë çdo individ brenda juridiksionit të tyre të drejtat dhe liritë e mbrojtura nga Konventa. Kështu p.sh., neni 3, i lexuar së bashku me nenin 1, e detyron shtetin të marrë masa të posaçme për të garantuar, që individët brenda juridiksionit të tij, të mos i nënshtrohen torturës, ose trajtimit çnjerëzor, poshtëruës, apo ndëshkimit, duke përfshirë këtu edhe keqtrajtimet e kryera nga individë privatë¹⁰². Këto masa duhet të garantojnë mbrojtjen efektive, veçanërisht të fëmijëve dhe individëve të tjerë të cenueshëm, duke përfshirë ndërmarrjen e veprimeve të arsyeshme për të parandaluar keqtrajtimin, për të cilin autoritetet kanë pasur ose duhet të kishin pasur dijeni që po ndodhte¹⁰³. Pra, është e dukshme se, që ky detyrim pozitiv të lindë, duhet që autoritetet të dine ose të kenë ditur në kohën kur ngjarja ndodh ekzistencën e një rreziku real të keqtrajtitit ose kryerjen e keqtrajtitit nga persona të tretë ndaj një individ të caktuar dhe të mos kenë marrë asnjë masë efektive, e cila në mënyrë të arsyeshme do ta kishte shmangur rrezikun në fjalë¹⁰⁴. Nëse incidentet e dhunës zgjasin për një periudhë kohe dhe, nëse autoritetet nuk kanë marrë masa të mjaftueshme për të zgjidhur problemin dhe për të parandaluar përsëritjen e tij, ka të ngjarë që Gjykata të gjejë shkelje të nenit 3 të Konventës¹⁰⁵.

Heqja e lirisë së personave me aftësi të kufizuara që vuajnë dënimin penal

Ndalimi i torturës dhe i trajtimeve çnjerëzore e poshtëruese ndaj individëve është një nga vlerat themelore të një shoqërie demokratike. Në kuadrin e mbrojtjes që neni 3 i Konventës siguron për personat me aftësi të kufizuara, të cilëve i kufizohet liria për shkak të ekzekutimit të një dënimi penal, merren në shqyrtim: a) kushtet e heqjes së lirisë; dhe b) sigurimi dhe ofrimi i kujdesit të përshtatshëm shëndetësor.

Standardet themelore të Gjykatës në këtë fushë janë:

¹⁰² Shih *mutatis mutandis*, HLR kundër Francës, 29 prill 1997, par. 40, Raporte 1997-III.

¹⁰³ Shih Dordević kundër Kroacisë nr. 41526/10, 24.7.2012; par. 138 dhe *mutatis mutandis*, Osman kundër Mbretërisë së Bashkuar, 28 tetor 1998, par. 116, Raportet 1998-VIII, dhe E., dhe të tjerët kundër Mbretërisë së Bashkuar, nr. 33218/96, par. 88, 26 nëntor 2002).

¹⁰⁴ Shih Dordević kundër Kroacisë, Nr. 41526/10, 24.7.2012; par. 139.

¹⁰⁵ E njëjta gjë thuhet edhe për detyrimet e autoriteteve shtetërore, bazuar në nenin 8, për mbrojtjen e jetës private dhe marrjen e masave parandaluese për mbrojtjen e personave me aftësi të kufizuara nga ndërhyrja e personave privatë në jetën e tyre personale.

- Ky nen vendos një detyrim pozitiv për shtetin, i cili duhet të garantojë ndalimin e personit në kushte të cilat respektojnë dinjitetin e tij njerëzor; përfshirë garantimin e ndihmës së duhur mjekësore.¹⁰⁶
- Mungesa e kujdesit adekuat mjekësor dhe burgimi i një personi të sëmurë në kushte të papërshtatshme, në parim, mund të jetë në kundërshtim me nenin 3¹⁰⁷. Kujdesi dhe shpeshësia e ofrimit të shërbimeve mjekësore një personi janë dy elementë që merren parasysh për matjen e përputhshmërisë e trajtimit të tij me kërkesat e nenit 3.
- Edhe pse nuk mund të arrihet në përfundimin se ekziston një detyrim i përgjithshëm për të liruar një të burgosur apo për ta transferuar në një spital civil, edhe nëse ky vuan nga një sëmundje veçanërisht e vështirë, ka pasur raste kur Gjykata ka vendosur se nuk përjashtohet që në kushte veçanërisht të rënda, mund të ndodhemi në prani të situatave për trajtimin e të cilave, administrimi i mirë i drejtësisë penale, kërkon marrjen e masave humanitare. Prandaj, në raste përjashtimore, kur gjendja shëndetësore e të burgosurit është absolutisht në mospërputhje me kushtet e vuajtjes së dënimit të tij me heqje lirie, respektimi i nenit 3 mund të kërkojë lirinë e personit sipas disa kushteve të përcaktuara.
- Gjykata kërkon që ambienti i burgut t’u përshtatet, nëse është e nevojshme, nevojave të veçanta të të burgosurit, në mënyrë që ai të vuajë dënimin në kushte që nuk venë në rrezik integritetin e tij moral¹⁰⁸.
- Heqja e lirisë së një personi me aftësi të kufizuara në një vend ku ai nuk mund të lëvizë vetë, veçanërisht kur nuk mund të dalë jashtë qelisë për një kohë të gjatë, përbën një trajtim poshtërues që ndalohet nga neni 3 i Konventës
- Varësia nga ndihma e të burgosurve të tjerë për të shkuar në tualet, për t’u larë, veshur apo zhveshur, mund të konsiderohet poshtëruese¹⁰⁹. Mungesa e provave që të vërtetojnë se autoritetet kanë vepruar me qëllim për ta poshtëruar kërkuesin, nuk e ndryshon këtë përfundim¹¹⁰.

Praktika gjyqësore, Shembulli 3: Grori kundër Shqipërisë, 7 korrik 2009¹¹¹, GJEDNJ-ja bëri disa konstatime të rëndësishme për pretendimin, sipas nenit 3, për kujdes mjekësor të

¹⁰⁶ Arutyunyan kundër Ruisë, 10.01.2012, Nr. 48977/09, par. 70; Shih *Kudła kundër Polonisë* [Dhoma e Madhe], nr. 30210/96, par. 94, GJEDNJ, 2000-XI, dhe *Rivière k. Francë*, nr. 33834/03, par. 62, 11 korrik 2006).

¹⁰⁷ *İlhan kundër Turqisë* [Dhoma e Madhe], nr. 22277/93, par. 87, GJEDNJ, 2000-VII, dhe *Naumenko*, cituar më sipër, par. 112.

¹⁰⁸ *Helhal kundër Francës*, par. 48.

¹⁰⁹ *Helhal kundër Francës*, par. 51.

¹¹⁰ *Helhal kundër Francës*, par. 63

¹¹¹ *Grori kundër Shqipërisë*, 07.07.2009, nr. 25336/04.

papërshtatshëm. Kërkuesi vuante nga një sëmundje shumë e rëndë, sklerozë e shumëfishtë, e cila mund të shkaktojë aftësi të kufizuar ose vdekje. Gjykata e konsideroi si alarmant faktin që vendimin nëse kërkuesi ka nevojë për kontrolle mjekësore shpesh, e merr prokurori dhe jo mjekët. Po ashtu, Gjykata nuk pranoi argumentin që trajtimi mjekësor për personat të cilëve u është hequr liria i kushton shumë buxhetit të shtetit. Mungesa e ndihmës mjekësore në kohën e duhur, së bashku me refuzimin e autoriteteve për t'i dhënë kërkuesit barna mjekësore sipas recetës, shoqëruar me vuajtjet fizike të tij, përbëjnë trajtim poshtërues sipas kuptimit të nenit 3 të Konventës.

Dëbimi i të huajve me aftësi të kufizuara dhe neni 3

Në një sërë çështjesh¹¹² të gjykuara nga GJEDNJ-ja, kërkues të ndryshëm me aftësi të kufizuara, të cilët kanë qenë subjekt i një urdhër dëbimi nga territori i një shteti anëtar në vendin e tyre të origjinës, kanë paraqitur argumentin se kthimi i tyre do të përbente keqtrajtim sipas kuptimit të nenit 3 të Konventës. Në një grup çështjesh,¹¹³ gjykata shqyrtoi kërkesat për kthimin e personave për shkak të refuzimit të kërkesës për azil. Ndërsa në çështje të tjera është shqyrtuar ekstradimi dhe përputhja e tij me nenin 3.¹¹⁴

Në rastin e kthimeve për shkak të refuzimit të kërkesës për azil, Gjykata i është referuar të drejtës ndërkombëtare të konsoliduar dhe të zbatueshme, duke përfshirë këtu edhe Konventën, sipas së cilës Shtetet Palë kanë të drejtë të kontrollojnë hyrjen, qëndrimin dhe dëbimin e të huajve në territorin e tyre. Megjithatë, dëbimi i të huajve nga territori i një shteti palë mund të ngrejë çështje në kuadër të nenit 3 të Konventës dhe të përfshijë përgjegjësinë e shtetit në kuadër të Konventës, kur ekzistojnë rrethana të mjaftueshme që tregojnë se personi në fjalë mund të ndihet i rrezikuar dhe të trajtohet në kundërshtim me nenin 3 të Konventës, në rast kthimi në vendin e tij të origjinës. Në këto rrethana, neni 3 nënkupton detyrimin e shteteve për të mos e dëbuar personin në fjalë¹¹⁵.

Pothuajse i njëjti skenar u përsërit në çështjen Strazimiri kundër Shqipërisë¹¹⁶, ku Gjykata shpalli sërish përgjegjëse qeverinë shqiptare për vënien e kërkuesit, i cili ishte i sëmurë mendërisht, në kushte çnjerëzore me rastin paraburgimit.

¹¹²Shih çështjet *Aswat kundër Mbretërisë së Bashkuar*, 14.04.2013, Nr. 17299/12; *SHH kundër Mbretërisë së Bashkuar*, 29.01.2013, Nr. 60367/10; *Hukić kundër Suedisë*, 27.09.2005, Nr. 17416/05.

¹¹³ *SHH kundër Mbretërisë së Bashkuar dhe Hukić kundër Suedisë*.

¹¹⁴ *Aswat*.

¹¹⁵ *Hukić k. Suedisë* par. 1-2; *HLR kundër Francës*, 29 prill 1997, Raportet e vendimeve dhe vendimeve 1997-III, f. 757, par. 33-34

¹¹⁶ *Strazimiri kundër Shqipërisë*, 21.01.2020, nr. 34602/16.

Gjykata ka theksuar në mënyrë të vazhdueshme se, në kuadër të nenit 3, ekstradimi, dëbimi ose largimi i individëve në shtete të treta ndalon në mënyrë absolute torturën, ose trajtimin çnjerëzor ose poshtëruës dhe se garancitë e këtij neni zbatohen pavarësisht nga natyra e dënueshme e sjelljes së personit në fjalë¹¹⁷. Në kuadër të jurisprudencës së konsoliduar të Gjykatës, të huajt që kthehen apo dëbohen, në parim, nuk mund të pretendojnë të qëndrojnë në territorin e një Shteti Palë për të vazhduar një trajtim mjekësor, të garantuar nga shteti që ka urdhëruar kthimin ose dëbimin. Megjithatë, në raste përjashtimore, vendimi për të dëbuar një kërkues, në kuadër të parimeve humanitare, mund të sjellë shkelje të nenit 3 të Konventës¹¹⁸.

Gjykata nuk mbështet pretendimet sipas nenit 3, të cilat bazohen në argumentin se një person me aftësi të kufizuara, nëse kthehet në vendin e origjinës, do të marrë trajtime më pak të përshtatshme aty, se sa në vendin nga ku do të kthehet¹¹⁹.

Në rastet e ekstradimeve, Gjykata ka zbatuar dhe i referohet të njëjtit test vlerësimi për kushtet e heqjes së lirisë në shtetin pritës, si në rastin e personave që vuajnë dënimin me heqje lirie në burg apo paraburgim. Sipas saj, ka tre elementë të veçantë që duhet të merren në konsideratë në lidhje me përputhshmërinë e kushteve të vuajtjes së dënimit prej kërkuesit: (a) gjendja shëndetësore e tij, (b) përshtatshmëria e ndihmës dhe kujdesit shëndetësor, dhe (c) përshtatshmëria e mbajtjes së kërkuesit në burg, në raport me gjendjen e tij shëndetësore¹²⁰.

5.2.3 Heqja e lirisë për shkak të çrregullimeve të shëndetit mendor

Personat me aftësi të kufizuara mund të privohen nga liria, me vendosjen e tyre në spitale psikiatrike, apo në qendra të përkujdesjes sociale. Në këto raste, Gjykata vlerëson dy aspekte themelore: 1) nëse vendosja në një institucion përkujdesjeje ose spital psikiatrik është heqje e lirisë në kuptim të nenit 5, par. 1; dhe b) nëse kjo heqje e lirisë është në përputhje me kërkesat e nenit 5 të Konventës.

Fjalja e parë e nenit 5, par. 1 parashikon që çdokush ka të drejtën e lirisë e të sigurisë personale dhe kjo fjali duhet të interpretohet se krijon një detyrim pozitiv për shtetin për mbrojtjen e lirisë së të gjithë individëve brenda juridiksionit të tij. Pra, shteti është i detyruar të marrë masa, për të siguruar mbrojtje efektive për personat e cenueshëm, për parandalimin e cenimit të lirisë nga

¹¹⁷ *Ahmed kundër Austrisë*, 17 dhjetor 1996, Raportet e vendimeve dhe aktgjykimeve 1996-VI, f. 2206, par. 38, dhe *Chahal v. Mbretëria e Bashkuar*, 15 nëntor 1996, Raportet 1996-V, f. 1853, par. 73-74

¹¹⁸ *D. kundër Mbretërisë së Bashkuar*, 2 maj 1997, Raportet 1997-II, par. 54

¹¹⁹ *Hukic kundër Suedisë* par. 2

¹²⁰ *Aswat* par.50; *Slavomir Musiał k. Polonia*, nr. 28300/06, par. 87, 20 janar; *Dybeku kundër Shqipërisë*, nr. 41153/06, par. 41, 18 dhjetor 2007.

autoritetet që kanë, ose duhet të kishin dijeni për brishtësinë e këtyre individëve¹²¹. Një nga rastet më të rëndësishme që konsiderohet se ka hedhur themelet për interpretimin e nenit 5 (1) (e) të Konventës dhe shprehjes "persona me probleme të shëndetit mendor" është *Winterwerp kundër Holandës (1979)*. Kjo është gjithashtu një nga çështjet e para që trajton rëndësinë e zbatimit të nenit 5 në rastin e kufizimit të lirisë për personat me probleme të shëndetit mendor.

Në cilat rrethanash konsiderohet se një personi me aftësi të kufizuar, të vendosur në një institucion të përkujdesjes sociale ose spital psikiatrik, i është hequr liria sipas kuptimit të nenit 5, par. 1, të Konventës?

Për të vlerësuar nëse dikujt i është "hequr liria" sipas kuptimit të nenit 5 të Konventës, Gjykata merr parasysh disa kritere që përfshijnë natyrën, kohëzgjatjen dhe mënyrën e zbatimit të masës së shqiptuar¹²². Nocioni i heqjes së lirisë sipas nenit 5, par. 1, nuk përfshin vetëm elementin objektiv të mbylljes së një personi në një hapësirë të kufizuar për një periudhë kohore, e cila mund të jetë e papërfillshme. Vlerësohet se një personi i hiqet liria, nëse nuk ekziston elementi subjektiv, që do të thotë se ai nuk ka pranuar në një mënyrë të vlefshme heqjen e lirisë së tij¹²³.

Në kontekstin e heqjes së lirisë për arsye të problemeve të shëndetit mendor, Gjykata ka konstatuar heqje të lirisë në rrethanat e mëposhtme:

- (a) kur kërkuesi, të cilit i është hequr zotësia për të vepruar dhe që është shtruar në një spital psikiatrik me kërkesë të përfaqësuesit të tij ligjor, është përpjekur, por pa sukses, që të largohet nga spitali¹²⁴;
- (b) kur kërkuesi, fillimisht e ka dhënë pëlqimin për shtrimin në një klinikë, por më pas është përpjekur të largohet prej saj¹²⁵;
- (c) kur kërkuesi është një person madhor, i cili e ka të pamundur të japë pëlqimin e vet për pranimin në një institucion psikiatrik, prej të cilit ai nuk është përpjekur asnjëherë të largohet¹²⁶; dhe
- (d) kur kërkuesi, një person me probleme të shëndetit mendor, është vendosur në një qendër të përkujdesjes sociale, ku ai mbikëqyret në mënyrë të vazhdueshme dhe prej së cilës ai nuk mund të largohet pa leje sa herë që dëshiron¹²⁷.

¹²¹ *Stanev kundër Bullgarisë (Dhoma e Madhe)*, 17.01.2012, Nr. 48977/09, par. 119-120

¹²² *Stanev*, par. 115, *Mihailovs kundër Letonisë*, nr. 35939/10, 22.01. 2013, par. 128

¹²³ *Mihailovs kundër Letonisë*, par. 128; *Storck kundër Gjermanisë*, nr. 61603/00, par. 74

¹²⁴ *Shtukurov*, par. 108.

¹²⁵ *Storck*, i cituar më sipër, par. 76.

¹²⁶ *HL kundër Mbretërisë së Bashkuar*, nr. 45508/99, par. 89-94, GJEDNJ, 2004 -IX

¹²⁷ *Stanev*, par. 124-130

Për sa i përket faktit nëse një institucion apo qendër është një institucion i hapur ose i mbyllur, Gjykata ka theksuar se kjo rrethanë nuk është përcaktuese për çështjen. Një personi konsiderohet se i është hequr liria sipas kuptimit të nenit 5, par. 1, edhe gjatë një periudhe kur ai ose ajo vendoset në një seksion (institucion) të hapur, me hyrje dalje të rregullta, të pashoqëruara në ambientet e spitalit dhe ka mundësi të largohet i pashoqëruar nga spitali¹²⁸. Faktori kyç, që përcakton zbatimin e nenit 5 në një çështje konkrete, është nëse autoritetet drejtuese të qendrës ushtrojnë kontroll tërësor dhe efektiv për trajtimin, kujdesin, qëndrimin dhe lëvizjen e një personi me aftësi të kufizuara.¹²⁹

Standardet e mësipërme janë krijuar nga interpretimi i nenit 5(1)(e) të KEDNJ-së, i cili parashikon mundësinë e kufizimit të ligjshëm të lirisë së personave me probleme të shëndetit mendor.

5.2.4 Jeta private dhe familjare: heqja e të drejtave prindërore

Në shumë çështje që lidhen me të drejtën për jetë private dhe familjare të personave me aftësi të kufizuara, problemi themelor juridik ka qenë heqja e të drejtave të tyre prindërore. Nuk ka dyshim se revokimi i të drejtës prindërore të një prindi dhe vendosja e fëmijës për birësim janë që të dyja masa shumë ekstreme. Madje, masa e fundit sjell shkatërrimin e plotë të marrëdhënies mes prindit dhe fëmijës¹³⁰.

Hapësira e vlerësimit të nevojës për ndërhyrjen e autoriteteve kombëtare varet nga natyra e çështjes dhe serioziteti i interesit të rrezikuar, të tilla si rëndësia e mbrojtjes së një fëmije që gjendet në një situatë në të cilën rrezikohet seriozisht shëndeti ose zhvillimi i tij, si edhe objektivi për të bashkuar sërish familjen sa më shpejt që të jetë e mundur. Gjykata zakonisht vlerëson se autoritetet kanë shumë liri veprimi për të vlerësuar, nëse një fëmijë ka nevojë për t'u marrë në mbrojtje ose jo. Megjithatë, ajo kryen një shqyrtim të rreptë të çdo kufizimi të të drejtave dhe pranisë së prindërve në jetën e fëmijëve të tyre, si edhe të çdo garancie ligjore të parashikuar, për të siguruar një mbrojtje efektive të së drejtës së prindërve dhe fëmijëve në respektim të jetës së tyre familjare.

Standardet e gjykatës në këtë fushë janë si më poshtë:

¹²⁸shih *HL kundër Mbretërisë së Bashkuar*, par. 92

¹²⁹ *DD kundër Lituanisë*, nr. 13469/06, par. 146, 14 shkurt 2012; dhe *Kędzior kundër Polonisë*, nr. 45026/07, par. 57, 16 tetor 2012.

¹³⁰ *AK dhe L. kundër Kroacisë*, 08.01.2013, Nr. 37956/11, par. 60.

- Vendorsja e një fëmije nën mbrojtje, në një ambient më të përshtatshëm për mirëqenien e tij, nuk mund të justifikojë një masë detyruese, e cila urdhëron heqjen e fëmijëve nga kujdesi i prindërve biologjikë. Duhet të ekzistojnë rrethana të tjera, të cilat provojnë “nevojën” e një ndërhyrje të tillë¹³¹.
- Kjo masë nuk mund të arsyetohet as nga fakti që prindërit e fëmijës gjenden në një situatë jo të mirë, e cila mund të përmirësohet, për shembull, përmes ndihmës financiare dhe konsulencës sociale, pa qenë e nevojshme ndërmarrja e masave aq radikale, siç është ndarja e familjes¹³².
- Para se të merret një masë e tillë, autoritetet administrative dhe gjyqësore duhet të marrin masa alternative shtesë për të mbështetur fëmijët apo familjen, përpara se të ndërmarrin hapin ekstrem të ndarjes së tyre nga prindërit.
- Mendimi i fëmijëve duhet dëgjuar nga gjyqtarët.¹³³
- Gjykata zbaton testin e arsyeve relevante dhe të mjaftueshme dhe pavarësisht, hapësirës së vlerësimit të autoriteteve vendase, kjo ndërhyrje duhet të jetë proporcionale me qëllimin e ligjshëm që ajo synon të realizojë.
- Shkelje të nenit 8 rezultojnë në situata kur një person nuk është njoftuar për procedurat e birësimit dhe nuk është dëgjuar në asnjë moment në lidhje me këtë çështje, pasi nuk ka qenë palë në këto procedura dhe nuk ka pasur asnjë të drejtë për të përdorur një mjet ankimimi në kontekst të këtyre procedurave.¹³⁴
- Së fundmi, është e domosdoshme që një prindi t’i jepet një mundësi për të kërkuar revokimin e vendimit për heqjen e të drejtave prindërore, para se fëmija e tij të jepet për birësim.¹³⁵

5.2.5 Heqja e zotësisë për të vepruar dhe garancitë e procesit të rregull

Heqja ose kufizimi i zotësisë së personave me aftësi të kufizuara për të vepruar është një nga çështjet më delikate që lidhet me realizimin e të drejtave të tyre. Heqja e zotësisë për të vepruar mund të shkelë në parim të drejtën e një personi për jetë private, por edhe të drejtën për përdorimin e gjykatës. Gjykata ka çmuar se hapësira e vlerësimit që kanë autoritetet në këtë rast varet nga dy faktorë të rëndësishëm. Së pari, kur masa në shqyrtim ka një efekt vendimtar në autonominë personale të kërkuesit, siç është kufizimi i lirisë përmes vendosjes së tij në një qendër

¹³¹ *Po aty*, par. 67; 69

¹³² *Saviny kundër Ukrainës*, nr. 39948/06, 18.12.2008, par. 50.

¹³³ *Po aty*, par. 75

¹³⁴ *Po aty*, par.77.

¹³⁵ *Po aty*, par. 78.

përkujdesje,¹³⁶ shqyrtohet arsyetimi i autoriteteve shtetërore për ta përligjur këtë masë të rreptë. Së dyti, Gjykata i kushton vëmendje të veçantë *cilësisë* së procedurave të brendshme¹³⁷.

Ekzistenca e një çrregullimi të shëndetit mendor, madje edhe një çrregullim i rëndë, nuk mund të jetë arsyeja e vetme për të justifikuar heqjen e zotësisë për të vepruar.¹³⁸ Në shumicën dërrmuese të rasteve, kur aftësitë e një individi për të vepruar dhe arsyetuar varen nga probleme të shëndetit mendor, gjendja e tij mund të ndryshojë. Për këtë arsye, personave që u është hequr zotësia për të vepruar duhet t'u bëhet një rivlerësim i herë pas hershem. Në mbështetje të këtij standardi, GJEDNJ-ja i referohet kërkesave të nenit 12 (4) të Konventës së OKB-së për të Drejtat e Personave me Aftësi të Kufizuara.

Elemente të procesit të rregullt gjyqësor për heqjen e zotësisë për të vepruar: Mundësia për t'iu drejtuar gjykatës, e drejta për t'u dëgjuar dhe paanësia e ekspertit

E drejta për të pasur mundësi t'i drejtohesh gjykatës është një aspekt shumë i rëndësishëm i autonomisë së personave me aftësi të kufizuara. Në çështjen *Stanev k. Bullgarisë*, Gjykata ka vërejtur se ekziston tashmë një tendencë në nivel evropian për t'u dhënë personave që u është hequr zotësia për të vepruar mundësi të menjëhershme për t'iu drejtuar gjykatës për të kërkuar rikthimin e zotësisë së tyre.¹³⁹

Një aspekt i procedurës së brendshme, që lidhet me të drejtën për t'u thirrur në gjykatë, ka të bëjë me rishikimin e vendimeve të gjykimit për heqjen e zotësisë juridike për të vepruar. Gjykata ka shqyrtuar rastet kur gjykatat vendase kanë refuzuar të kryejnë një vlerësim të ri psikiatrik për kërkuarësit. Në këtë këndvështrim, GJEDNJ ka vendosur në lidhje me të drejtën e garantuar me nenin 6, par. 1, "e drejta për të investuar në gjykatë për të rishikuar heqjen e zotësisë juridike të dikujt për të vepruar, është një nga të drejtat më të rëndësishme të individit në fjalë".¹⁴⁰

Një aspekt i procedurave të brendshme, i lidhur ngushtë me të drejtën për t'iu drejtuar gjykatës, ka të bëjë me kërkesën për rishikimin e vendimeve gjyqësore për heqjen e zotësisë për të vepruar. Gjykata ka shqyrtuar raste kur gjykatat e brendshme kanë refuzuar kryerjen një

¹³⁶ *Lashin kundër Rusisë*, 22.01.2013, Nr. 33117/02, par. 81.

¹³⁷ *Shtukaturov kundër Rusisë*, cituar më lart, par. 91.

¹³⁸ *Shtukaturov*, cituar më lart, par. 94.

¹³⁹ *Lashin*, par. 97.

¹⁴⁰ *Stanev kundër Bullgarisë* [Dhoma e Madhe] nr. 36760/06, par. 241, GJEDNJ, 2012)

ekzaminimi të ri psikiatrik të kërkuesve. Në këtë këndvështrim, GJEDNJ-ja ka vlerësuar se në lidhje me mundësinë për t'iu drejtuar gjykatës në kuadër të nenit 6, par. 1, “e drejta për t’i kërkuar një gjykatë të rishikojë heqjen e zotësisë për të vepruar, është një nga të drejtat më të rëndësishme të individit në fjalë”.¹⁴¹

Kërkuesi ka të drejtë t’i nënshtrohet një rishikimi tërësor të statusit të tij, procedurë e cila në parim duhet të përfshijë një vlerësim të gjendjes së tij nga një mjek tjetër. Në rastet kur vlerësimi i një eksperti pritet të luajë një rol shumë të rëndësishëm në procesin gjyqësor, paanësia e një eksperti të tillë bëhet një nga kriteret më të rëndësishme që duhet marrë në konsideratë. Mungesa e paanësisë mund të sjellë cenim të parimit të barazisë së armëve, të garantuar nga neni 6 i Konventës.¹⁴²

E drejta e personit me aftësi të kufizuara për t’u dëgjuar në seancë në proceset që lidhen me zotësinë e tij për të vepruar, është një tjetër element i procesit të rregullt ligjor. Fakti që një individ nuk ka zotësi të plotë për të vepruar, nuk nënkupton detyrimisht se ai është i paaftë për të kuptuar situatën në të cilën ndodhet.¹⁴³ Gjykata thekson se në raste të tilla, individ i nuk është vetëm një palë e interesuar, por është edhe objekt i vetë shqyrtimit nga gjykata. Ka disa rrethana përjashtimore nga rregulli i përgjithshëm i pjesëmarrjes së individit në këto seanca¹⁴⁴, me kusht që gjykatat e brendshme t’i kenë vlerësuar me shumë kujdes këto rrethana.

Për ilustrim, në çështjen *Lashin k. Rusisë*, gjykata e brendshme ishte shprehur se pjesëmarrja e kërkuesit në seancë do të “dëmtonte shëndetin e tij”, por nuk ishte paraqitur asnjë provë që kjo gjykatë të kishte kërkuar mendimin e një mjeku specialist për këtë çështje, apo të ndonjë faktori tjetër që pengonte paraqitjen e ankuesit personalisht në gjykatë. GJEDNJ-ja vlerësoi se supozimi sipas të cilit, për shkak se një person vuan nga skizofrenia, duhet të përjashtohet nga procedurat gjyqësore, nuk është i mjaftueshëm. Duke iu referuar konkretisht KPDAK-së, Gjykata u kërkoi shteteve që të ndërmarrin masat e duhura dhe rregullimet e nevojshme për të lehtësuar rolin konkret të personave me aftësi të kufizuara në proceset gjyqësore.¹⁴⁵ Garancitë për heqjen e zotësisë për të vepruar zbatohen njësoj edhe kur bëhet fjalë për kufizimin e kësaj zotësie.

¹⁴¹ *Po aty*.

¹⁴² *Lashin kundër Rusisë*, par. 87.

¹⁴³ *Stanev*, par. 130

¹⁴⁴ *Berková kundër Sllovakisë*, nr. 67149/01, par. 138 dhe më pas, 24 mars 2009.

¹⁴⁵ *RP dhe të Tjerët kundër Mbretërisë së Bashkuar*, 09.10.2012, Nr. 38245/08, par. 65-67

Megjithatë, pavarësisht standardeve shumë strikte të përcaktuara nga Gjykata në këtë fushë, ajo ende nuk ndalon heqjen ose kufizimin e zotësisë për të vepruar të personave me aftësi të kufizuara, që është një qëndrim që dallon nga ai i KDPAK-së dhe interpretimi i praktikës gjyqësore të Komitetit të KDPAK-së në lidhje me nenin 12 të Konventës. Megjithatë, këto standarde mund të zhvillohen dhe të ndryshohen në përputhje me KDPAK. Legjislacioni dhe praktikat e disa prej vendeve anëtare të KE-së dhe BE-së tashmë kanë ndryshuar ,ose janë në proces të ndryshimit, si në Letoni, Francë, Gjermani, Suedi, Maltë etj.¹⁴⁶

Praktika gjyqësore Shembulli 4: Më 27 dhjetor 2010, Gjykata Kushtetuese e **Letonisë** vendosi se nenet 358 dhe 364 të Kodit Civil nuk janë në përputhje me Kushtetutën e Letonisë, sepse ato kufizojnë në mënyrë të paarsyeshme të drejtën e një personi për një jetë private, pasi mundësia e vetme për ti hequr personit zotësinë për të vepruar, ishte heqja e plotë e zotësisë së tij për të vepruar. Gjykata e bazoi arsyetimin e saj në detyrimet ndërkombëtare të Letonisë për të drejtat e njeriut dhe vuri në dukje se zotësia e personit për të vepruar duhet të kufizohet vetëm në masën e nevojshme. Gjykata tha gjithashtu se “[...] për të zbatuar nenin 12 të [KDPAK], duhet të bëhen ndryshime në Ligjin Civil, Ligjin për Procedurën Civile dhe Ligjin për Gjykatat e Jetimëve, duke ndaluar kufizimin e plotë të zotësisë për të vepruar, dhe vendosi se normat e kontestuara do të jenë të pavlefshme nga 1 janari 2012. Për rrjedhojë, më 29 nëntor 2012, parlamenti letonez miratoi amendamente të gjera që heqin kujdestarinë plenare dhe futin rishikime në të gjitha aspektet përkatëse të kuadrit kombëtar.¹⁴⁷

5.2.6 E drejta e votës

Heqja ose kufizimi i të drejtës së votës për personat me aftësi të kufizuara është në përgjithësi e lidhur dhe rrjedh nga heqja ose kufizimi i zotësisë për të vepruar, sikurse është rasti në çështjen *Alajos Kiss k. Hungarisë*, e cila është baza e standardeve të GJEDNJ-së të këtij seksioni.

Në analizimin e kufizimeve të së drejtës së votës për personat me aftësi të kufizuara, gjykata zakonisht vlerëson:

- **qëllimin dhe proporcionalitetin e kufizimeve të vendosura.** Neni 3 i Protokollit 1 të KEDNJ-së nuk përcakton shprehimisht kufizimet që mund t'i vendosen të drejtës që garanton ky nen,

¹⁴⁶ Zotësia për të vepruar e personave me aftësi të kufizuara intelektuale, dhe e personave me probleme të shëndetit mendor; Agjencia e Bashkimit Evropian për të Drejtat Themelore, 2013

¹⁴⁷Po aty.

kështu që një gamë e gjerë qëllimesh të ligjshme mund të jenë në përputhje me nenin 3.82 Gjkata ka pranuar se në këtë fushë¹⁴⁸, pushtetit legjislativ kombëtar i lihet një hapësirë e gjerë vlerësimi për të përcaktuar se cilat kufizime të së drejtës së votës mund të justifikohen në kohët moderne dhe nëse kjo ndodh, sa e drejtë është shkalla e kufizimeve. I takon pushtetit legjislativ të vendosë se cila procedurë duhet të hartohet për ta përshtatur të drejtën e votës për personat me aftësi të kufizuara mendore.¹⁴⁹ Gjkata nga ana e saj kontrollon nëse ka prova që vërtetojnë se pushteti legjislativ i ka marrë ndonjëherë parasysh interesat konkurruese, ose e ka vlerësuar ndonjëherë shkallën e kufizimit në fjalë.

- **pengimi absolut për të votuar** i personave me zotësi të pjesshme për të vepruar, pa vlerësuar aftësitë e tyre aktuale, nuk pranohet nga Gjkata se është brenda hapësirës së vlerësimit që gëzon shteti në kufizimin e kësaj të drejte.¹⁵⁰ Për më tepër, nëse një kufizim i të drejtave themelore zbatohet për një grup shoqëror që ka qenë subjekt diskriminimi në të shkuarën, siç janë konkretisht personat që vuajnë nga probleme të shëndetit mendor, shteti do të ketë një hapësirë më të ngushtë vlerësimi për të kufizuar këtë të drejtë dhe duhet të ketë arsye shumë serioze për këtë kufizim. Arsyeja e kësaj qasjeje është se këto grupe të shoqërisë historikisht u janë nënshtruar paragjyqimeve që kanë pasur gjithmonë pasoja negative për ta, duke sjellë përjashtimin social të tyre. Paragjykime të tilla mund të rezultojnë në stereotipi legjislative, të cilat pengojnë vlerësimin individual të kapaciteteve dhe nevojave të këtyre individëve.¹⁵¹
- **Heqja e të drejtës së votës**, pa bërë një vlerësim individual juridik dhe bazuar vetëm në ekzistencën e kujdestarisë së pjesshme të një individi, nuk konsiderohet nga Gjkata se është në përputhje me kufizimet legjitime të së drejtës së votës, duke shkaktuar kështu shkelje të nenit 3 të Protokollit 1 të Konventës.¹⁵² Me fjalë të tjera, trajtimi në mënyrë të njëjtë i personave me aftësi të kufizuara intelektuale ose mendore, sikur të ishin të gjithë pjesë e të njëjtës kategori, do të ishte një klasifikim i diskutueshëm, prandaj kufizimi i të drejtave të tyre, duhet të shqyrtohet me rreptësi.

Në një çështje të ngjashme me Alajos Kiss, Komiteti për të Drejtat e Personave me Aftësi të Kufizuara, në çështjen *Zsolt Bujdosó dhe të Tjerët k. Hungarisë*¹⁵³, shkon përtej vendimit të GJEDNJ-së, vendim i cili lejon vlerësimin individual të çdo personi nga autoritetet shtetërore në lidhje me aftësinë e tij për të votuar. Këtë lejim, të cilin shteti hungarez e bazon duke iu referuar

¹⁴⁸ *Alajos Kiss kundër Hungarisë*, 20.05.2010, Nr. 38832/06, par. 38.

¹⁴⁹ *Po aty*, par. 41.

¹⁵⁰ *Po aty*, par. 42.

¹⁵¹ *Po aty*.

¹⁵² *Po aty*, par. 44.

¹⁵³ *Zsolt Bujdosó dhe të tjerët kundër Hungarisë*, 30 shtator 2013.

rastit te sipërpërmendur të GJEDNJ-së, Komiteti e konsideron si diskriminues në natyrën e vet. Komiteti shkon më tej, duke thënë se vetëm përmes sigurimit të procedurave të përshtatshme, të mundshme për t'u përdorur dhe të lehta për t'u kuptuar, si dhe duke siguruar asistencën e nevojshme gjatë votimit, shteti do të sigurojë që personat me aftësi të kufizuara mendore të hedhin votën e tyre në mënyrë kompetente.

Pra, komiteti shkon përtej GJEDNJ-së, duke thënë se nuk mund të ketë procedura të cilat të vlerësojnë aftësinë për të votuar ose jo të një personi me, ose pa aftësi të kufizuara.

5.2.7 Pensionet e aftësisë së kufizuar dhe e drejta pronësore

Një aspekt interesant i çështjeve të GJEDNJ-së lidhet me pensionet e aftësisë së kufizuar dhe nëse ato krijojnë të drejta pronësore sipas Konventës. Kështu, Gjykata ka vërejtur se derdhja e kontributeve në një fond pensioni, në rrethana të caktuara, mund të krijojë të drejta pronësore, të cilat mund të preken nga mënyra se si shpërndahet fondi.¹⁵⁴ GJEDNJ-ja ka pranuar se të drejtat që rrjedhin nga pagesa e kontributeve të sistemeve të sigurimeve shoqërore janë të drejta materiale për qëllimet e nenit 1 të Protokollit 1.¹⁵⁵ Megjithatë, edhe duke supozuar se neni 1 i Protokollit 1 u garanton përfitime personave që kanë kontribuar në sistemin e sigurimeve shoqërore, kjo e drejtë nuk mund të interpretohet se u krijon individëve të drejtën për pension në një shumë të caktuar.

Një pikë e rëndësishme në vlerësimin e pretendimeve në kuadër të kësaj dispozite është të përcaktohet nëse e drejta e një personi me aftësi të kufizuara, për të nxjerrë përfitime nga skema e sigurimeve shoqërore, është shkelur në një mënyrë të tillë që dëmton thelbin e së drejtës së tij të pensionit. Konkretisht, do të vlerësohen pritshmëritë e ligjshme të personit lidhur me përfitimin e një pensioni për aftësinë e kufizuar.

Në fushën e legjislacionit social, shteti ka një hapësirë të gjerë vlerësimi. Nga çështja *Kjartan Ásmundsson k. Islandës*, mund të arrihet në përfundimin se Gjykata nuk do të kishte gjetur shkelje, në rast se kërkuesi do t'i ishte nënshtruar një rivlerësimi dhe do të kishte pasur një ulje të pensionit të tij dhe jo një ndërprerje të plotë të këtij përfitimi.

¹⁵⁴ *Kjartan Ásmundsson kundër Islandës*, 12.10.2004, nr. 60669/00, par. 39.

¹⁵⁵ *Gaygusuz kundër Austrisë*, 16.09.1996, 1996-IV, f. 1142, par. 39-41

5.3 Të drejtat e njeriut LGBTIQ+

Në nivel evropian, parimi i mosdiskriminimit për shkak të orientimit seksual/identitetit gjinor përmendet në Konventën Evropiane për të Drejtat e Njeriut, Konventën për parandalimin dhe luftimin e dhunës ndaj grave dhe dhunës në familje, praktikën gjyqësore të Gjykatës Evropiane të të drejtat e njeriut, rekomandimet e Komitetit të Ministrave, Komisionerit për të Drejtat e Njeriut dhe organeve të tjera të Këshillit të Evropës.¹⁵⁶

Këto standarde ndërkombëtare dhe rajonale janë të inkorporuara në nivelin kombëtar të mbrojtjes ligjore përmes Kushtetutës së Kosovës.¹⁵⁷ Për më tepër, parimi i mosdiskriminimit për shkak të orientimit seksual përmendet në Kushtetutën e Kosovës¹⁵⁸ dhe Ligjin për Mbrojtjen nga Diskriminimi i referohet edhe orientimit seksual ashtu edhe identitetit gjinor në veçanti si karakteristikë e mbrojtur nga diskriminimi.¹⁵⁹

5.3.1 Jurisprudenca e GJEDNJ

Jurisprudenca ndërkombëtare për të drejtat e njeriut dhe legjislacioni kombëtar njeh disa forma të diskriminimit, të gjitha këto janë të rëndësishme për avancimin e mbrojtjes nga diskriminimi i personave LGBTIQ+.

- **Diskriminimi i drejtpërdrejtë** konsiderohet se ndodh kur një person trajtohet në mënyrë më pak të favorshme sesa që trajtohet, ka qenë i trajtuar ose do të trajtohet një person tjetër, në një situatë të krahasueshme, sipas bazës së orientimit seksual ose identitetit gjinor.¹⁶⁰

Praktika gjyqësore Shembulli 1 : Stoyanova kundër Bullgarisë, 14 qershor 2021

Ky rast kishte të bënte me vrasjen homofobike të djalit 26-vjeçar të kërkueses. Sulmuesit e tij, nxënës të shkollës së mesme, e kishin veçuar atë për ta sulmuar, ngase mendonin se ai dukej si homoseksual. Sulmuesit ishin shpallur fajtorë për vrasje të rëndë, por iu shqiptuan dënime që

¹⁵⁶Gjykata Evropiane e të Drejtave të Njeriut konfirmoi në vitin 1999 se orientimi seksual është një bazë diskriminimi e mbuluar nga neni 14 i Konventës; Komiteti i Ministrave të Këshillit të Evropës miratoi një Rekomandim për masat për të luftuar diskriminimin në bazë të orientimit seksual ose identitetit gjinor; Neni 21.1 i Kartës së të Drejtave Themelore të Bashkimit Evropian.

¹⁵⁷Neni 22, Kushtetuta e Republikës së Kosovës.

¹⁵⁸Neni 24, *Po aty*.

¹⁵⁹Neni 1, Ligji Nr. 05/L -021 për Mbrojtjen nga Diskriminimi.

¹⁶⁰Neni 4, *Po aty*.

ishin nën minimumin ligjor, pasi gjykatat morën parasysh faktorët lehtësues, si mosha e tyre e re dhe evidencat e pastra penale. Kërkuësja pretendoi se përgjigja ligjore e autoriteteve bullgare ndaj motivit homofobik që qëndron në themel të vrasjes së djalit të saj ka qenë joadekuate – në veçanti, për shkak të mungesës së dispozitave ligjore që e bëjnë një motiv të tillë një faktor rëndues për veprën penale të vrasjes.

Gjykata vlerësoi se kishte pasur shkelje të nenit 14 (ndalimi i diskriminimit) marrë së bashku me nenin 2 (e drejta për jetën) të Konventës, duke konstatuar se, pavarësisht konstatimit të përcaktuar qartë se arsyeja e sulmit ndaj djalit të kërkuësës kishte qenë urrejtja e autorëve ndaj homoseksualëve, nuk kishte pasur pasoja të prekshme juridike në gjykatat bullgare. Sipas mendimit të Gjykatës, kjo ishte kryesisht për shkak të faktit se kodi penal nuk i kishte pajisur gjykatat në mënyrë adekuate për t'u përgjigjur, dhe jo për shkak të mënyrës në të cilën ato e kishin trajtuar çështjen. Gjykata vuri në dukje, në veçanti, se sipas Kodit Penal Bullgar, vrasja e motivuar nga urrejtja ndaj viktimës për shkak të orientimit seksual real ose të supozuar të tij/saj, nuk rëndojë ose trajtohet ndryshe si një vepër më e rëndë. Për më tepër, në bazë të nenit 46 (forca detyruese dhe ekzekutimi i vendimeve) të Konventës, Gjykata dha një tregues se si shkelja e Konventës në çështjen e kërkuësës, e cili buronte nga përmbajtja e kodit penal përkatës bullgar, siç interpretohet dhe zbatohet nga gjykatat bullgare, mund të shmanget në të ardhmen. Në këtë drejtim, Gjykata vëri në dukje se Bullgaria duhet të sigurojë që sulmet e dhunshme (në veçanti, ato që rezultojnë në vdekjen e viktimës) të motivuara nga urrejtja ndaj orientimit seksual real ose të perceptuar të viktimës, të trajtohen, në një farë mënyre, si më të rënda në kuptim të kodit penal.

- **Diskriminimi i tërthortë** konsiderohet kur, një dispozitë, kriter apo praktikë e paanshme në dukje e vë, e ka vënë apo ta vë personin në pozitë të pabarabartë krahasuar me të tjerët, sipas orientimit të tij/saj seksual/identitetit gjinor, përveç në rastet kur dispozita, praktika apo kriteri i tillë mund të arsyetohet në pikëpamje objektive me një qëllim legjitim, dhe mjetet për arritjen e qëllimit janë të përshtatshme dhe domosdoshme.¹⁶¹

Praktika gjyqësore, Shembulli 2: Sabalić k. Kroacisë, 14 janar 2021

Kërkuësja, e cila ishte sulmuar fizikisht në një lokal nga një burrë pasi i bëri të ditur atij orientimin e saj seksual, u ankua veçanërisht për mungesën e një përgjigjeje të duhur procedurale të autoriteteve vendase ndaj një akti dhune nga një palë private e motivuar nga orientimi i saj seksual.

¹⁶¹ *Po aty.*

Gjykata u shpreh se kishte pasur shkelje të nenit 3 (ndalimi i trajtimit çnjerëzor ose poshtëruës) në lidhje me nenin 14 (ndalimi i diskriminimit) të Konventës. Ajo gjeti, në veçanti, se procedura për kundërvajtje ndaj agresorit të kërkueses nuk e kishte adresuar elementin e krimit të urrejtjes të veprës penale, dhe kishte rezultuar me një gjobë qesharake. Këto mangësi ishin bërë një defekt thelbësor në procedurë. Prandaj, do të ishte e arsyeshme që autoritetet të përfundonin ose anulonin procedurën për kundërvajtje dhe të kthenin çështjen në rishqyrtim, në vend se të refuzonin ankesën penale të ankueses mbi bazën e të drejtës për të mos u gjykuar dy herë për të njëjtën çështje.

- **Nxitja për të diskriminuar** ndalohet kur përbën nxitje të urrejtjes për shkak të orientimit seksual ose identitetit gjinor ose për shkak të bazave të tjera të mbrojtura, dhe kur ajo bëhet me dashje.¹⁶²

Shembull nga Praktika gjyqësore 3: Oganezova kundër Armenisë 17 maj 2022

Ky rast kishte të bënte me një fushatë agresive homofobike ndaj kërkueses, një anëtare e mirënjohur e komunitetit të lesbikeve, homoseksualëve, biseksualëve dhe transgjitorëve (LGBT) në Armeni, duke përfshirë një sulm me zjarrvënie në maj 2012 në lokalitetin në Yerevan, që ajo e drejtonte dhe e kishte në bashkëpronësi.

Gjykata gjeti se kishte shkelje të nenit 3 (ndalimi i trajtimit çnjerëzor ose poshtëruës) në lidhje me nenin 14 (ndalimi i diskriminimit) të Konventës, duke konstatuar se autoritetet armene nuk kishin ofruar mbrojtjen e duhur për kërkuesen nga sulmet homofobike dhe gjuha e urrejtjes, dhe nuk kishin kryer një hetim të duhur për keqtrajtimin e motivuar nga urrejtja ndaj saj, duke përfshirë sulmin me zjarrvënie në klub dhe sulmet homofobike pasuese.

- **Viktimizimi** konsiderohet diskriminim mbi bazën e orientimit seksual ose identitetit gjinor, dhe ndodh kur personi përjeton pasoja negative si reagim ndaj ankimit apo mos-ankimit (procedurave të filluara) apo veprimeve me qëllim të zbatimit të parimit të trajtimit të barabartë, ose në rastet kur personi i tillë ofron informacione, dëshmi apo ndihmë në lidhje me ankesën ose procedurën në rast të diskriminimit.

Ky rast kishte të bënte me ndërprerjen e shfaqjes së një filmi për të drejtat e LGBT (lesbiqueve, homoseksualëve, biseksualëve dhe transgjitorëve) nga një grup që bënte thirrje për abuzim homofobik, dhe dështimin e pretenduar të autoriteteve vendase për të ofruar mbrojtje për kërkuesit—një organizatë joqeveritare për të drejtat LGBT, dhe pesë individë privatë që kishin marrur pjesë në shfaqje - nga abuzimi verbal homofobik dhe kërcënimet, dhe dështimin për të kryer një hetim efektiv pasues për ankesën e kërkuesve.

¹⁶²Po aty.

Gjykata gjeti se kishte shkelje të nenit 14 (ndalimi i diskriminimit) të Konventës, në lidhje me nenin 8 (e drejta për respektimin e jetës private dhe familjare) në raport me kërkuetit individualë, duke konstatuar se autoritetet rumune kishin dështuar të përmbushin detyrimin e tyre pozitiv për të hetuar në mënyrë efektive nëse abuzimi verbal i drejtuar ndaj kërkuetve individualë përbënte vepër penale të motivuar nga homofobia. Në këtë mënyrë, autoritetet kishin shfaqur njëanshmërinë e tyre ndaj anëtarëve të komunitetit LGBT. Gjykata gjithashtu u shpreh se, në këtë çështje, kishte shkelje të nenit 14 në lidhje me nenin 11 (liria e tubimit dhe organizimit) të Konventës, duke konstatuar se autoritetet nuk kishin siguruar që ngjarja në fjalë (e cila ishte organizuar nga shoqata kërkuete dhe me pjesëmarrjen e kërkuetve individualë) të mund të zhvillohej në mënyrë paqësore, duke i përmbajtur mjaftueshëm demonstruesit homofobikë.

- **Diskriminimi në bazë të Asociimit** konsiderohet diskriminim mbi bazën e orientimit seksual ose identitetit gjinor, duke shënjestruar personat që nuk i përkasin një grupi të caktuar, por janë palë të treta që asociohen me ato grupe.¹⁶³

Praktika gjyqësore Shembulli 4: Grupi Mbështetës i Iniciativave të Grave dhe të tjerët kundër Gjeorgjisë, 16 dhjetor 2021

Kërkuetit në këtë çështje ishin 35 shtetas gjeorgjian dhe dy organizata joqeveritare, të themeluara për promovimin dhe mbrojtjen e të drejtave të personave lezbike, homoseksualë, biseksualë dhe transgjinorë (LGBT) në Gjeorgji. Rasti kishte të bënte me një sulm nga një turmë ndaj demonstruesve LGBT, më 17 maj 2013 – në Ditën Ndërkombëtare Kundër Homofobisë – në qendër të Tbilisit.

Gjykata gjeti se kishte shkelje të nenit 3 (ndalimi i trajtimit çnjerëzor ose poshtëruës) në lidhje me nenin 14 (ndalimi i diskriminimit) të Konventës, si për shkak të dështimit të autoriteteve për të mbrojtur demonstruesit paqësorë nga agresioni homofobik dhe transfobik, ashtu edhe për shkak të hetimit joadekuat që pasoi. Ai gjeti në veçanti se autoritetet nuk kishin marrë masa për të mbrojtur protestuesit LGBT nga turma, pavarësisht se ishin të vetëdijshëm për rreziqet që lidhen me ngjarjen. Për më tepër, kishte prova, përkatësisht pamje video nga gazetarë të pavarur, për mbyllje sysh nga ana e autoriteteve ndaj akteve të dhunës dhe paragjyqimeve themelore. Në të vërtetë, Gjykata nuk mund të përjashtonte mundësinë që shkalla e paprecedentë e dhunës të ishte ndikuar nga dështimi i autoriteteve për të kryer një hetim me kohë dhe objektiv mbi sulmet ndaj komunitetit LGBT gjatë ngjarjes së një viti më parë, e cila ishte gjithashtu temë e një çështjeje para Gjykatës ku u konstatuan shkelje të Konventës (shih, më lart, Identoba dhe të tjerët kundër Gjeorgjisë). Gjykata gjithashtu u shpreh se në këtë çështje kishte shkelje të nenit 11 (liria e organizimit) të Konventës në lidhje me nenin 14, duke konstatuar se autoritetet nuk e kanë vënë kurse si prioritet të tyre marrjen e masave efektive për mbrojtjen e kërkuetve. Ata nuk kishin vlerësuar burimet e nevojshme në fazën e planifikimit të ngjarjes dhe e kishin kufizuar rolin e tyre në hartimin e planit të shpërndarjes.

¹⁶³*Po aty.*

- **Diskriminimi në bazë të perceptimit** konsiderohet diskriminim për shkak të orientimit seksual ose barazisë gjinore me vendosjen në objektiv jo të personave që i përkasin komuniteteve LGBTIQ+, por personave të tretë që perceptohen se i përkasin komuniteteve LGBTIQ+.¹⁶⁴

Praktika gjyqësore Shembulli 5 : Stoyanova k. Bullgarisë 14 qershor 20221 (më lart).

- **Diskriminimi i shumëfishtë** ndodh kur diskriminimi është i bazuar në çfarëdo kombinimi të bazave të mbuluara me ligj.¹⁶⁵ Do të thotë se diskriminimi i bazuar në orientimin seksual ose identitetin gjinor është i lidhur pazgjidhshmërisht me faktorë të tjerë, ose mund të ndikohet nga faktorë të tjerë. Në shumicën e rasteve të shkeljeve të të drejtave të LGBTIQ+, ekziston një ndërveprim kompleks midis orientimit seksual, identitetit gjinor dhe elementëve të tjerë të identitetit, siç janë, por pa u kufizuar në: raca/etnia, statusi/gjuha/origjina kombëtare indigjene, statusi i migrantit apo refugjatit; personat e zhvendosur brenda vendit, feja ose besimi, mosha, shëndeti (p.sh. statusi HIV), aftësia e kufizuar etj.

5.3.2 Kodi Penal i Kosovës – Praktika gjyqësore

Kodi penal i Kosovës sanksionon përdorimin e gjuhës për nxitje të urrejtjes. Kodi Penal i cili mbulon periudhën deri më 14 prill 2019¹⁶⁶ në nenin 147 parasheh se kushdo që nxit dhe përhap urrejtje, përçarje ose mosdurim midis grupeve kombëtare, racore, fetare, etnike apo grupeve të tjera të tilla që jetojnë në Republikën e Kosovës, në mënyrë e cila mund të prishë rendin publik dënohet me gjobë ose me burgim deri në 5 vjet. Pësha e dënimit për një vepër penale të tillë rritet në rastet kur vepra kryhet:

- në mënyrë sistematike ose nga personi duke keqpërdoruri pozitën apo autorizimet e tij (dënohet me burgim prej 1 deri në 8 vjet);
- përmes shtrëngimit, rrezikimit të sigurisë, përqeshjes së simboleve kombëtare, racore, etnike apo fetare, duke dëmtuar pasurinë e personit tjetër ose duke përdhosur monumentet (dënohet me burgim prej 1 deri në 8 vjet); dhe
- në mënyrë sistematike ose duke keqpërdorur pozitën apo autorizimet e tij, ose shkakton trazira, dhunë ose pasoja të tjera të rënda (dënohet me burgim prej 2-10 vjet).

¹⁶⁴Po aty .

¹⁶⁵ Po aty.

¹⁶⁶Kodi Nr. 04/L-082

Kodi Penal parashihte rrethana rënduese për t'u marrë parasysh nga gjykatat. Ato përfshinin përkatësinë etnike ose kombëtare, kombësinë, gjuhën, besimin fetar ose mungesën e besimit fetar, ngjyrën, gjininë, orientimin seksual ose afërsinë me personat me karakteristikat e lartpërmendura¹⁶⁷. Të njëjtat rrethana rënduese përfshihen edhe në lidhje me shkatërrimin ose dëmtimin e pasurisë¹⁶⁸.

Kodi Penal i Kosovës i ndryshuar (prill 2019) ¹⁶⁹ ofron mbrojtje më të madhe në lidhje me gjuhën e urrejtjes dhe krimet e urrejtjes. Neni 141 për nxitje të përçarjes dhe mosdurimit përfshin orientimin seksual dhe identitetin gjinor si baza të qarta të mbrojtura, ndërkohë që përcakton karakteristika të tjera personale si mundësi ose baza të tjera të paspecifikuara. Shkalla e dënimit për vepra penale të tilla mbetet e njëjtë si në Kodin Penal të mëparshëm - deri në 5 vjet burgim. Dënimi në varësi të peshës së veprave penale sipas këtij neni mbetet i njëjtë si në Kodin Penal të mëparshëm.

Rrethanat rënduese, të ngjashme me Kodin Penal të mëparshëm, me shtimin e identitetit gjinor, janë përshkruar në një sërë nene që korrespondojnë me vepra penale të ndryshme si vrasje e rëndë ¹⁷⁰, sulm¹⁷¹, lëndim i lehtë trupor¹⁷², lëndim i rëndë trupor¹⁷³, shkatërrim ose dëmtim i pasurisë¹⁷⁴.

Shkelja e statusit të barabartë të shtetasve dhe banorëve është penalizuar edhe me Kodin Penal aktual ¹⁷⁵. Mohimi ose kufizimi i të drejtave të përcaktuara me Kushtetutë, ose me marrëveshje të ratifikuara ndërkombëtare, dënohet me burgim deri në 3 vjet. Kufizimi i të drejtës së shprehjes së lirë të pjesëtarit të një bashkësie etnike, fetare ose gjuhësore, dhe mohimi i përdorimit të gjuhës dhe shkrimit të tij, dënohet me burgim deri në 1 vit. Pesha e dënimit rritet kur veprat penale kryhen nga persona zyrtar me keqpërdorim të pozitës ose autorizimeve të tij.

Praktika gjyqësore Shembulli 6: Gjykata Themelore Ferizaj - 26 shtator 2016

Ky rast ka të bëjë me një sulm ndaj një punonjësi (RN) të një OJQ-je e cila përfaqëson komunitetin LGBT, ndërsa punonte në komunitet duke shpërndarë prezervativë dhe sende të tjera. RN pretendoi se ai ishte abuzuar verbalisht për shkak të punës që bënte dhe orientimit të tij real apo të perceptuar seksual, dhe se ishte sulmuar fizikisht nga dy persona FL dhe AQ. Prokuroria inicio

¹⁶⁷Neni 74 (2), Kodi Penal i Kosovës

¹⁶⁸Neni 333(4), Po aty

¹⁶⁹Kodi Nr. 06/L-074

¹⁷⁰Neni 173 (1.10) Kodi Penal i Kosovës, Ligji Nr. 06/L-074.

¹⁷¹Neni 184 (3), Po aty.

¹⁷²Neni 185 (3), Po aty.

¹⁷³Neni 186 (4), Po aty.

¹⁷⁴Neni 321 (4), Po aty.

¹⁷⁵Neni 190, Po aty.

procedurën ndaj FL dhe AQ për shtytje (neni 147(1) i Kodit Penal) dhe bashkëkryerje (neni 31 i Kodit Penal) dhe sulm (neni 187 i Kodit Penal) dhe bashkëkryerje (neni 31 i Kodit Penal).

Gjatë procedurës, të dy të pandehurit i mohuan akuzat. Viktima përfaqësohej veçmas në procedurë. Në bazë të provave të paraqitura, gjykata pranoi se:

- FL i kërkoi AQ që t'i bashkohej atij në sulmin ndaj RN-s; dhe një kolegu tjetër, për të cilët ai tha se ishin "gej". Pati një debat të shkurtër mes të dyve, por ata u nisën aty ku ishte RN.
- FL iu afrua RN-së dhe i tha "gej, a ke ardhur të shpërndash prezervativë" dhe më pas e goditi me grusht në fytyrë. AQ ishte në afërsi.
- RN arriti të largohej dhe i tregoi kolegut të tij BZ për atë që ndodhi. RN dhe BZ shkuan në një restorant lokal, ku u ndoqën nga FL dhe FQ dhe ku FL vazhdoi me abuzime verbale ndaj RN dhe BZ, pas së cilës rasti u raportua në polici.
- FL mohoi të kishte sulmuar RN, ndërsa AQ konfirmoi se FL kishte folur për sulmin ndaj RN dhe kishte vazhduar ta bënte këtë.
- provat mjekësore treguan se RN ishte sulmuar fizikisht dhe kishte pësuar lëndime.
- u dorëzuan video incizimet nga kamerat e sigurisë që tregonin sulmin.
- viktima dëshmoi se është sulmuar fizikisht dhe abuzuar verbalisht për shkak të orientimit të tij real ose të perceptuar seksual.
- BZ dëshmoi se FL vazhdoi t'i abuzonte verbalisht në restorant.

Në bazë të provave, Gjykata refuzoi mbrojtjen e FL dhe AQ pasi nuk ishin në përputhje me provat. Megjithatë, Gjykata vendosi, sipas detyrës zyrtare, që të akuzuarit t'i gjykojë për lëndim të lehtë trupor (neni 188 i Kodit Penal) dhe për bashkëkryerje (neni 31), e jo për sulm. Për më tepër, Gjykata theksoi se kishte marrë parasysh nenin 73 (rregullat e përgjithshme për matjen e dënimit) dhe 74 (rregullat e përgjithshme për zbutjen ose ashpërsimin e dënimeve). Gjykata gjeti se FL ishte fajtor për shtytje dhe lëndim të lehtë trupor, dhe u dënua me 4 muaj dhe 2 muaj burg respektivisht. Ndërsa AQ u shpall fajtor vetëm për shkak të lëndimit të lehtë trupor dhe u dënua me burgim në kohëzgjatje prej 4 muajve, i cili dënim nuk do të ekzekutohet, nëse brenda periudhës prej 1 viti, i njëjti nuk kryen vepër tjetër penale.

5.4 Të drejtat e njeriut të romëve dhe udhëtarëve

Në Evropë, romët dhe udhëtarët ¹⁷⁶ vuajtën nga një diskriminim i përhapur në formën e antigjipsizimit, gjë që bëri që Gjykata Evropiane t'i konsideronte romët një lloj specifik të minoritetit të kërcënuar dhe të cenueshëm. Nevojitet mbrojtje dhe konsideratë e veçantë duke marrë parasysh nevojat e tyre dhe stilit e ndryshëm të jetesës, të cilat duhet të pasqyrohen në kuadrin rregullator përkatës dhe në procesin e vendimmarrjes. Për shembull, është e rëndësishme të theksohet Rekomandimi i Komitetit të Ministrave për shtetet anëtare për përmirësimin e qasjes në drejtësi, për romët dhe udhëtarët në Evropë.¹⁷⁷ Gjykata thekson qartë se “Duke rikujtuar se qasja në drejtësi është një aspekt i qenësishëm i shtetit të së drejtës dhe një kërkesë themelore e çdo shoqërie demokratike, dhe se e drejta për qasje në drejtësi dhe për gjykim të drejtë garantohet me nenin 6 të Konventës, dhe se ajo duhet të sigurohet për të gjithë pa diskriminim, në përputhje me nenin 14 të Konventës”.¹⁷⁸

Për më tepër, Gjykata vuri në dukje gjithashtu konsensusin ndërkombëtar në zhvillim që shtetet anëtare të Këshillit të Evropës duhet të respektojnë nevojat e veçanta të romëve, duke përfshirë të gjitha pakicat. Kjo nënkupton një detyrim për mbrojtjen e sigurisë, identitetit dhe stilit të tyre të jetesës, jo vetëm për t'i mbrojtur interesat e vetë pakicave, por edhe për të ruajtur diversitetin kulturor me vlerë për të gjithë komunitetin.

Në përputhje me parimet e mësipërme, shtetet anëtare kanë ndërmarrë një sërë masash të përgjithshme dhe individuale në kuadër të ekzekutimit të vendimeve të Gjykatës Evropiane, të cilat kanë të bëjnë me qasjen në drejtësi, të drejtën për respektimin e jetës private dhe familjare, duke përfshirë çështjet që lidhen me sterilizimin e detyruar të grave rome, mbrojtjen nga krimet e urrejtjes dhe të drejtat e strehimit, mbrojtjen e pronës dhe të drejtën për arsimim.

¹⁷⁶Termet “Romë dhe Udhëtarë ” po përdoren në Këshillin e Europës për të përfshirë diversitetin e gjerë të grupeve të mbuluara nga puna e Këshillit të Europës në këtë fushë: nga njëra anë a) Romë, Sinti/Manush, Calé , Kaale , Romanichals , Boyash / Rudari ; b) Egjiptianët e Ballkanit (egjiptianët dhe ashkalitë); c) Grupet lindore (Dom, Lom dhe Abdal); dhe, nga ana tjetër, grupe të tilla si Udhëtarët, Yenish, dhe popullatat e përcaktuara nën termin administrativ "Gens du voyage", si dhe personat që e identifikojnë veten si Ciganë.

¹⁷⁷ Rekomandimi CM/Rec(2017)10 i Komitetit të Ministrave për shtetet anëtare për përmirësimin e qasjes në drejtësi për romët dhe udhëtarët në Evropë (Miratuar nga Komiteti i Ministrave më 17 tetor 2017 në takimin e 1297-të të Zëvendës Ministrave) është në dispozicion në:

https://search.coe.int/cm/Pages/result_details.aspx?ObjectId=090000168075f2aa

¹⁷⁸Po aty

5.5. Praktika gjyqësore

Praktika gjyqësore të cilës do t'i referohet kjo Përmbledhje ka të bëjë me temat në vijim:

- Qasja në drejtësi
- E drejta për respektimin e jetës private dhe familjare
- Mbrojtja e pronës
- E drejta për arsimim

5.5.1 Qasja në drejtësi

Sipas kuadrit ligjor të BE-së dhe GJEDNJ-së, **qasja në drejtësi dhe ndalimi i diskriminimit** mund të lidhen nga dy këndvështrime:

- a) Qasja në drejtësi në rastet e diskriminimit** i referohet mundësisë së përdorimit të mjetit juridik në situata ku individët diskriminohen.
- b) Qasja jodiskriminuese në drejtësi** i referohet barrierave ndaj drejtësisë me të cilat përballen persona të caktuar, pavarësisht nëse kanë qenë viktima të diskriminimit. Kjo do të thotë se sigurimi i qasjes efikase dhe efektive në drejtësi për të gjithë kërkon që sistemi i drejtësisë të organizohet në atë mënyrë që askujt mos t'i pengohet **qasja në drejtësi për arsye fizike, gjuhësore, financiare, apo të tjera**. Për shembull, barrierat financiare për personat që nuk kanë mjete të mjaftueshme për të inicuar procedura gjyqësore mund të zgjidhen nëpërmjet sistemit të ndihmës juridike.¹⁷⁹

Praktika gjyqësore Shembulli 1: BGR kundër Paraskeva Todorova 2, 25 qershor 2010¹⁸⁰

Kërkuesja, Paraskeva Todorova, një shtetase bullgare me origjinë rome, e lindur në vitin 1952, u akuzua për përvetësim me mashtrim të parave dhe bizhuterive në vitin 2005. Për shkak të disa rrethanave lehtësuese, përfshirë edhe gjendjen e saj shëndetësore, prokuroria rekomandoi dënim me kusht. Megjithatë, në maj të vitit 2006, Gjykata e Qarkut në Plovdiv e shpalli kërkuesen fajtoresh dhe i shqiptoi dënim me burg në kohëzgjatje prej 3 vite.

¹⁷⁹Manuali i ligjit evropian për mosdiskriminimin botimi 2018, Agjencia e Bashkimit Evropian për të Drejtat Themelore në dispozicion në https://www.echr.coe.int/Documents/Handbook_non_discr_iaw_ENG.pdf

¹⁸⁰ (37193/07) Aktgjykimi përfundimtar më 25/06/2010 Rezoluta përfundimtare CM/ ResDH (2016)156

Në vendimin e saj, Gjykata e Qarkut iu referua origjinës rome të zonjës Todorova dhe refuzoi propozimin për dënim me kusht, duke deklaruar se kjo krijon në përshtypje të mosndëshkimit, veçanërisht tek anëtarët e grupeve minoritare “për të cilët dënimi me kusht nuk është dënim” Vendimi i Gjykatës së Qarkut në Plovdiv u konfirmuar nga Gjykata Rajonale në Plovdiv, në tetor të vitit 2009, e cila "plotësisht u pajtua" me refuzimin e dënimit me kusht.

Para kësaj, në qershor 2007, Gjykata e Lartë e Kasacionit (KSK) konfirmoi dënimin dhe refuzoi të urdhëronte rishqyrtimin ose mundësinë e modifikimit të dënimit. Edhe pse Gjykata e Lartë pranoi se kërkuesja i plotësonte kushtet për dënim me kusht, ajo konsideroi se dënimi me burgim ishte i arsyeshëm, në mënyrë që të shmanget ndjenja e mosndëshkimit, veçanërisht në mesin e grupeve të pakicave etnike.

Kërkuesja paraqiti ankesë në Gjykatën Evropiane të të Drejtave të Njeriut (GJEDNJ) më 9 gusht 2007. Argumenti ligjor që ajo solli para asaj Gjykate ishte se gjykatat bullgare e kishin diskriminuar atë në bazë të përkatësisë së saj etnike. Ndonëse i plotësonte të gjitha kushtet për dënim me kusht, ajo u dënua me burgim për shkak se i takonte komunitetit minoritar.

Qeveria pretendoi se përkatësia e saj etnike nuk kishte asnjë ndikim në shqiptimin e dënimit, dhe se shqiptimi i dënimit në bazë të ligjit kombëtar ka për qëllim t’i parandaloj personat e tjerë nga kryerja e veprave penale, si dhe të parandaloj përsëritjen e veprës penale. Sipas Qeverisë, një dënim me kusht do të shkaktonte një ndjenjë mosndëshkimi tek të gjithë pjesëtarët e shoqërisë.¹⁸¹

GJEDNJ kritikoi refuzimin diskriminues nga gjykata vendase për pezullimin e ekzekutimit të dënimit me burgim të kërkueses, dhe kërkoi nga Qeveria të arsyetonte trajtimin e ndryshëm, përndryshe, do të konsiderohet se është shkelur neni 14 i Konventës (ndalimi i diskriminimit). Tani e tutje, Prokurori i Përgjithshëm kërkoi rihapjen e procedurës, në përgjigje të sugjerimit të Gjykatës se rihapja do të ishte masa më e përshtatshme individuale.

Si rrjedhojë, implikimet në nivel të juridiksionit vendas ishin si më poshtë:

¹⁸¹Përmbledhja e çështjes mund të gjendet në Equalright Trust, në dispozicion në <https://www.equalrightstrust.org/ertdocumentbank/case%20summary%20Paraskeva%20Todorova%20vs%20Bulgaria.pdf>

- Në prill të vitit 2011, Gjykata e Lartë e Kasacionit (KKS), anuloi aktgjykimin e formës së prerë në çështjen e kërkuases, duke iu referuar nenit 46 të Konventës.
- GJK bëri një vlerësim të ri të situatës së kërkuases dhe ndryshoi dënimin e saj, duke gjetur se ajo kishte plotësuar kushtet dënim me kusht në kohëzgjatje prej tre vitesh. Ajo vlerësoi, ndër të tjera, se refuzimi i kërkesës së prokurorit për dënim me kusht nga gjykatat e mëparshme vendase ishte një “shkelje e dukshme e parimit të trajtimit të barabartë dhe ndalimit të diskriminimit”.
- Gjykata vendosi për kompensimin e dëmit në bazë të Ligjit për Përgjegjësinë e Shtetit për Dëmin, të vitit 1988. Sipas autoriteteve, procedurat që pasuan për kompensimin i siguruan kërkuases kompensimin e duhur për periudhën e vuajtjes efektive të dënimit në burg.

Praktika gjyqësore Shembulli 2: KH dhe të tjerët kundër Republikës Sllovaqe, 6 nëntor 2009¹⁸²

Kërkueset në Gjykatën Evropiane të të Drejtave të Njeriut janë tetë gra rome, të cilat kanë marrë trajtim gjinekologjik dhe obstetrik në Sllovaki, dhe të cilave iu është shkëlur e drejta të bënin kopje të kartelave të tyre mjekësore.

Kartelat mjekësore ishin prova të domosdoshme për t'i ndihmuar ato të paraqesin në mënyrë efektive çështjen e tyre para gjykatave vendase në Sllovaki, pasi që pas trajtimit, të tetë gratë nuk arritën të mbesin përsëri shtatzënë. Përfaqësuesit e paditësve ishin avokatë nga Qendra për të Drejtat Civile dhe të Njeriut dhe ata kërkuan të merrnin kartelat mjekësore dhe të gjitha dokumentet tjera të nënshkruara nga tetë gratë. Megjithatë, në vitin 2002 Ministria e Shëndetësisë ua mohoi qasjen, duke deklaruar se përfaqësuesit ligjorë, sipas Ligjit për Kujdesin Shëndetësor 1994, nënkuptojnë vetëm prindërit e fëmijëve të mitur ose përfaqësuesit e atyre të cilëve iu është hequr zotësia për të vepruar.

Në vitin 2003, paditësit paditën spitalet. Megjithatë, Gjykata e Qarkut, Rajonale dhe Kushtetuese në Sllovaki, përcaktuan se ato nuk kishin të drejtë të bëjnë kopje të kartelave mjekësore, dhe se nuk kishte shkelje të të drejtave sipas Kushtetutës ose Konventës Evropiane për të Drejtat e Njeriut (KEDNJ).

¹⁸²SVK / KH dhe të tjerët (32881/04) Aktgjykimi përfundimtar më 06/11/2009 Rezoluta përfundimtare CM/ ResDH (2012)56

Gjatë shqyrtimit të çështjes, Gjykata Evropiane konstatoi se të drejtat e mbrojtura me nenin 8 të KEDNJ-së (e drejta për jetën private dhe familjare) duhet të jenë praktike dhe efektive. Prandaj, qasja në dosjet që përmbajnë të dhënat personale duhet të lejohet.

Për më tepër, sipas nenit 6.1 të Konventës Evropiane, që konfirmon të drejtën për tu dëgjuar nga një gjykatë, Gjykata konstatoi se kufizimi i qasjes në dosje sipas Ligjit për Kujdesin Shëndetësor të vitit 1994, krijoi një barrë joproporcionale për individin në përpjekjen për të zhvilluar një çështje efektive për procedurë gjyqësore dhe për këtë arsye gjeti shkelje të nenit 6.1.

Në këtë rast, Gjykata u shpreh unanimisht se kishte pasur shkelje të nenit 8 të Konventës, të cilin e përcakton si më poshtë:

“1. Gjithkush ka të drejtën e respektimit të jetës private dhe familjare, ...

“2. Nuk do të ketë asnjë ndërhyrje nga autoritetet publik në ushtrimin e kësaj të drejte, përveçse kur është në përputhje me ligjin dhe është e domosdoshme në një shoqëri demokratike në interes të sigurisë kombëtare, sigurisë publike ose mirëqenies ekonomike të vendit, për parandalimin e trazirave ose krimit, për mbrojtjen e shëndetit ose moralit, apo për mbrojtjen e të drejtave dhe lirive të të tjerëve.”

Gjithashtu, me shumicë prej gjashtë votash, Gjykata gjithashtu gjeti se ka pasur shkelje të nenit 6.1, i cili parasheh:

“Në përcaktimin e të drejtave dhe detyrimeve të tij civile ... çdokush ka të drejtë për një ... seancë dëgjimore ... nga [një] ... gjykatë ...”¹⁸³

Së fundi, pasojat e këtij aktgjykimi në nivel vendor ishin se Ligji i ri për Kujdesin Shëndetësor, i vitit 2004, autorizonte shprehimisht pacientët, ose personat e autorizuar prej tyre që të bëjnë kopje të kartelave mjekësore për të parandaluar përsëritjen e shkeljeve të tilla. Sipas ligjit të ri, shtatë kërkueset mund të bënin fotokopje të dosjeve të tyre, dhe ajo të cilës ia kishin humbur kartelën mjekësore mund të kërkonte dëmshpërblim në gjykatat vendase me pretendim për trajtim të pakujdesshëm të kartelës së saj mjekësore.

¹⁸³Rezoluta CM/ ResDH (2012)56[1] Ekzekutimi i vendimit të Gjykatës Evropiane për të Drejtat e Njeriut KH dhe të tjerët kundër Republikës Sllovaqe <https://hudoc.exec.coe.int/eng#%7B%22EXEIdentifier%22:%5B%22001-109742%22%7D>

5.5.2 E drejta për respektimin e jetës private dhe familjare

Praktika gjyqësore Shembulli 3: Tri raste kundër Republikës Sllovake¹⁸⁴

Ndërmjet viteve 1999 dhe 2002, tre raste të sterilizimit të detyruar të grave rome ndodhën në Sllovaki, pavarësisht nga masat e duhura mbrojtëse në lidhje me shëndetin riprodhues të grave rome.

Gjatë asaj periudhe, ligji në fuqi ishte Rregullorja e Sterilizimit të vitit 1972 dhe Ligji për Kujdesin Shëndetësor 1994, i cili kërkonte pëlqimin e pacientit përpara ndërhyrjes mjekësore. Megjithatë, këto dispozita nuk ofronin mbrojtjen e duhur.

Në veçanti, ato lejuan të krijohet një situatë në të cilën një ndërhyrje e një natyre veçanërisht serioze u zhvillua pa pëlqimin e informuar të kërkuesit, siç përcaktohet në Konventën për të Drejtat e Njeriut dhe Biomjekësinë, për të cilën Sllovakia kishte detyrim të zbatimit në kohën përkatëse.

Më 8 nëntor 2011, Gjykata Evropiane për të Drejtat e Njeriut (GJEDNJ) gjeti se sterilizimi i detyruar i kërkueses rome në një spital publik përbën shkelje të ligjit ndërkombëtar për të drejtat e njeriut.

GJEDNJ-ja gjeti në mënyrë specifike se Republika Sllovake, nëpërmjet veprimeve të punonjësve të spitalit, ka shkelur nenet 3, 8 dhe 12 të Konventës për Mbrojtjen e të Drejtave të Njeriut dhe Lirive Themelore (Konventa). Gjykata u përqendrua kryesisht në mosrespektimin nga ana e Sllovakisë e nenit 3 për ndalimin e torturës dhe trajtimit çnjerëzor ose poshtëruës, dhe nenit 8 për të drejtën për jetë private dhe familjare.

Para çështjes VC kundër Sllovakisë, GJEDNJ nuk kishte njohur sterilizimin e detyruar si shkelje të të drejtave të njeriut, megjithëse gjykatat e tjera ndërkombëtare e kishin bërë këtë. Organizata të ndryshme për të drejtat e njeriut në mbarë botën e mirëpritën këtë vendim, si hapin e parë në adresimin e mijëra raporteve për sterilizim të detyruar të grave rome në Evropën Qendrore dhe Lindore. Ky vendim shqyrtoi më tej të drejtat riprodhuese të romëve në përgjithësi, sfidoi praktikat raciste që ndalonin qasjen e romëve në përkujdesje shëndetësore, dhe cenonin të drejtën e tyre për dinjitet dhe autonomi personale.

Për më tepër, si përgjigje, autoritetet sllovake miratuan Ligjin për Kujdesin Shëndetësor 2004, i cili hyri në fuqi më 1 janar 2005. Ky ligj rregullon në detaje dhënien e informacionit për pacientët

¹⁸⁴VK / VC, NB dhe IG dhe të tjerë (18968/07, 29518/10, 15966/04)

dhe pëlqimin e tyre të informuar, ku seksioni 40 i tij përcakton parakushtet për sterilizimin. Këto përfshijnë një kërkesë me shkrim dhe pëlqim me shkrim pas informimit paraprak në lidhje me, ndër të tjera, metodat alternative të kontracesionit, prindërimin e planifikuar dhe pasojat mjekësore të sterilizimit. Asnjë sterilizim nuk mund të kryhet deri në të paktën tridhjetë ditë pas dhënies së pëlqimit të informuar.

Gjithashtu, në vitin 2013, u miratua një rregullore e re për të siguruar që kërkesa për pëlqim të kuptohet në mënyrë uniforme nga të gjitha institucionet shëndetësore, dhe të standardizojë sjelljen e profesionistëve shëndetësorë.

5.5.3 Mbrojtja e pronës

Praktika gjyqësore Shembulli 4: Munoz Diaz kundër Spanjës¹⁸⁵

Në çështjen e znj. Maria Luisa Munoz Diaz kundër Spanjës, autoritetet spanjolle refuzuan të njihnin martesën e saj sipas traditave dhe zakoneve romë e cila ishte e lidhur në vitin 1971; megjithatë, martesë u njoh nga komuniteti i tyre dhe kishte efektet normale sociale të martesës.

Prandaj, pas vdekjes së burrit të saj, autoritetet refuzuan t'ia njihnin të drejtën për pension, pavarësisht se i shoqi kishte paguar kontributet sociale për më shumë se nëntëmbëdhjetë vite, ata kishin jetuar së bashku që nga viti 1971, kishin gjashtë fëmijë dhe kishin marrë statusin "familjes së madhe".

Kërkuesja paraqiti kërkesë në Gjykatën e Punës, e cila ia njohu efektet civile të martesës së vitit 1971, si dhe të drejtën për pension. Megjithatë, Instituti Kombëtar i Sigurimeve Shoqërore (IKSS) paraqiti ankesë në Gjykatën e Lartë të Drejtësisë në Madrid, e cila e anuloi vendimin e Gjykatës së Punës. Gjykata vendosi se neni 49 i Kodit Civil kërkon që "për të prodhuar efekte civile... [martesë duhet]... të lidhet me ceremoni civile ose fetare". Gjykata gjeti se martesë romë e kërkueses nuk plotësonte kushtet e Kodit Civil, por, përkundrazi, përfaqësonte një marrëveshje bashkëjetese dhe binte jashtë fushëveprimit të Ligjit të Përgjithshëm për Sigurimet Shoqërore.

Si pasojë, kërkuesi paraqiti një ankesë për mbrojtje kushtetuese të drejtave themelore në Gjykatën Kushtetuese, duke u mbështetur në parimin e mosdiskriminimit (neni 14 i Kushtetutës spanjolle) në bazë të racës dhe statusit social. Gjykata e hodhi poshtë ankesën duke thënë se në lidhje me pretendimin për diskriminim në bazë të racës, gjykata konstatoi se mundësia ligjore e

¹⁸⁵ESP / Muñoz Díaz (49151/07)

lidhjes së martesës në formë civile ishte "neutrale nga pikëpamja racore ose etnike", dhe si e tillë nuk kishte pasur diskriminim. Në lidhje me diskriminimin në bazë të statusit social, gjykata vendosi që kufizimi i disponueshmërisë së pensionit familjar për bashkëshortët e martuar ishte një ushtrim i arsyeshëm i diskrecionit nga legjislativi.

Më 8 dhjetor 2009, Gjykata Evropiane për të Drejtat e Njeriut (GJEDNJ) gjeti se Spanja kishte shkelur nenin 14 (ndalimi i diskriminimit) të Konventës Evropiane për të Drejtat e Njeriut në lidhje me nenin 1 të Protokollit 1 të Konventës (e drejta e gëzimit paqësor të pasurisë).

Gjykata përsëriti gjetjen e saj se ndalimi i diskriminimit sipas nenit 14, përfshin të drejtat sipas Konventës dhe Protokolleve, ashtu edhe të drejtat që përfshihen në fushëveprimin e çdo neni të Konventës që shteti ka vendosur vullnetarisht të sigurojë. Për më tepër, ajo përsëriti qëndrimin e saj se legjislacioni që parashikon pagesën e kontributeve sociale, duhet të konsiderohet si gjenerim i një interesi pronësor sipas nenit 1 të Protokollit 1.

Gjykata vuri në dukje se ndërsa në vitin 1971, kur kërkuesja kishte lidhur martesë, në Spanjë njiheshin vetëm martesat fetare, dhe se martesat civile ishin e lejueshme vetëm në rastet e apostazisë, ligji ishte ndryshuar më pas. Ajo vuri re se që nga viti 1981, martesat civile ishin në dispozicion pa dallim dhe se nuk kishte asnjë kërkesë për të deklaruar bindjet fetare ose për t'i përkatur një grupi kulturor, gjuhësor, etnik ose ndonjë grupi tjetër. Së fundi, ai vuri në dukje se ndërsa forma të caktuara fetare të martesës njihen në bazë të marrëveshjeve me shtetin, ky dallim nuk e ndalon apo pengon martesën civile për personat e besimeve apo etnive të tjera.

Gjykata gjeti se fakti që martesat romë nuk kishte efekte civile nuk përbënte diskriminim sipas nenit 14.

Gjykata arriti në përfundimin se mirëbesimi i kërkueses, i konfirmuar nga veprimet e shtetit për njohjen e martesës së saj në kontekste të tjera, i dha asaj një pritje legjitime për të drejtën për pension familjar.

Gjykata konstatoi se ishte joproporcionale që shteti të refuzonte të njihnte efektet civile të martesës në vlerësimin e të drejtës për pension familjar. Ajo konstatoi se refuzimi i shtetit për të njohur martesën në bazë të mirëbesimit ishte në kundërshtim me njohjen e martesës për qëllime të pensionit familjar në raste të tjera, dhe përbënte trajtim diskriminues në kuptim të nenit 14.

Gjykata u shpreh, me shumicë 6 me 1, se kishte pasur shkelje të nenit 14 të Konventës, në lidhje me nenin 1 të Protokollit 1.

Për të parandaluar shkelje të ngjashme në të ardhmen, autoritetet spanjolle miratuan ligjin nr. 40/2007, i cili ka hyrë në fuqi që nga 1 janari 2007, dispozita plotësuese 3 e së cilës njeh të drejtën e pensionit të të vejave (pensioni kthyes) në rastin kur përfituesi bënte një jetë të vazhdueshme së bashku, të paktën gjashtë vjet para vdekjes së këtij të fundit. Për më tepër, u shtua një dispozitë ligjore kalimtare për t'i mundësuar personave, për të cilët konsiderohej se nuk kishin të drejtë në pension, të aplikojnë për pension brenda 12 muajve pas hyrjes në fuqi të ligjit.

5.5.4 E drejta për arsimim

Praktika gjyqësore Shembulli 5: Oršuš dhe të tjerët kundër Kroacisë¹⁸⁶

Ankuesit ishin 15 shtetas kroatë të përkatësisë etnike rome, të cilët ndiqnin klasa të veçanta, të përbëra vetëm nga nxënës romë, në shkollat e tyre fillore përkatëse. Kurrikula që mësohej në klasat të përbëra vetëm nga romët mund të reduktohej deri në 30% në krahasim me kurrikulën e rregullt. Përqindja e fëmijëve romë në klasat e ulëta supozohet se varioje nga 33% në 75%. Në kërkesën e tyre në Gjykatën Evropiane për të Drejtat e Njeriut (GJEDNJ), ankuesit pretenduan se atyre u ishte thënë se duhej të linin shkollën në moshën 15 vjeçare, duke paraqitur statistika që tregonin se vetëm 16% e fëmijëve romë të moshës 15 vjeçare kanë përfunduar arsimin fillor krahasuar me 91% të popullsisë së përgjithshme të shkollave fillore, dhe se shkalla e braktisjes së shkollës nga nxënësit romë ishte 84%, që ishte 9.3 herë më e lartë se ajo në popullatën e përgjithshme.

Kërkuesit ngritën një padi në gjykatat komunale dhe kushtetuese të Kroacisë, duke u ankuar se situata përbënte diskriminim racor në shkelje të të drejtave të tyre për arsimim dhe liri nga trajtimi çnjerëzor dhe poshtëruës, dhe se kjo u kishte shkaktuar atyre dëme emocionale dhe psikologjike. Si gjykatat komunale ashtu edhe ato kushtetuese hodhën poshtë pretendimet, duke favorizuar argumentin se segregacioni ishte një masë e ligjshme për të zgjidhur problemin të njohjes së pamjaftueshme të gjuhës kroate nga fëmijët romë.

 HUMAN RIGHTS
ACADEMY OF JUSTICE

¹⁸⁶CRO / Oršuš dhe të tjerët (15766/03)

Në vitin 2010, Gjykata për të Drejtat e Njeriut kritikoi vendosjen diskriminuuese dhe të pajustificuar të fëmijëve romë në klasa të përbëra vetëm nga romët, për shkak të supozimit të njohjes së pamjaftueshme të gjuhës kroate nga ana e tyre.

Si kundërpërgjigje, në vitin 2010, autoritetet shfuqizuan klasat “vetëm për romët” duke ndryshuar ligjin që rregullon arsimin fillor dhe të mesëm. Ndryshimet mundësonin qasje në arsimin e rregullt për fëmijët romë, të cilët tani ndjekin kurrikulën e rregullt dhe të plotë në klasa të përziera. Për të siguruar që fëmijët romë të ndjekin edukimin dhe arsimimin parashkollor, janë marrë një sërë masash, duke përfshirë vijueshmërinë e detyrueshme në kopsht dhe në nivel parashkollor për të gjithë fëmijët nën moshën shtatë vjeç. Për më tepër, u morën masa për të ndihmuar fëmijët romë që të arrijnë një nivel adekuat të zotërimit të gjuhës kroate, duke përfshirë futjen e testimit të gjuhës sipas kritereve objektive, përpara se të regjistrohen në shkolla fillore, i cili zbatohet për të gjithë fëmijët që nuk janë folës amtare të gjuhës kroate, pavarësisht nga përkatësia e tyre etnike.

Në vitin 2011, Ministria e Mirëqenies Sociale dhe Familjes zhvilloi aktivitete trajnuese për ngritjen e kapaciteteve të shërbimeve sociale, për adresimin e problemit të vijueshmërisë së dobët në shkolla. Gjithashtu, ndihma në mësimdhënie është rritur në arsimin fillor.

Nga viti 2014, tekstet shkollore dhe ushqimi falas për fëmijët e familjeve që përfitojnë ndihmë sociale subvencionohen nga Ministria e Shkencës dhe Arsimit.

Në përgjithësi, në vitin 2012, u krijua një Strategji Kombëtare për Përfshirjen e Romëve 2013-2020, me qëllim të rritjes së cilësisë dhe efikasitetit të arsimit të fëmijëve romë, dhe të rritjes së numrit të fëmijëve romë në të gjitha nivelet e arsimit, në përputhje me Rekomandimin e KM (2009)⁴ lidhur me arsimimin e romëve dhe udhëtarëve në Evropë.



EUKOJUST
European Union/Kosovo
Justice Sector Programme